



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 11 DHE 12 TETOR 2016**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 11. I 12. OKTOBRA 2016. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar me rastin e arrestimit të drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, z. Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë

Dnevni red

1. Parlamentarne rasprave povodom hapšenja Direktora Policije Kosova u regiji Mitrovice, g-din Nehat Thaçi, od strane vlasti Srbije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës me kërkesë të 45 deputetëve, me një pikë të rendit të ditës të vetme:

1. Debat parlamentar me rastin e arrestimit të drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, z. Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë

Të nderuar kolegë,

Ju njoftoj se deputeti Gëzim Kelmendi, i mbështetur edhe nga 44 deputetë tjerë të grupeve të ndryshme parlamentare, mbështetur në nenin 69.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për seancë të jashtëzakonshme lidhur me arrestimin e drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, zoti Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë.

E ftoj deputetin Gëzim Kelmendi që në emër të parashtruesit të kërkesës për debat të marrë fjalën. Urdhëro, i nderuar deputet, fjala për ju.

I nderuar deputet, në rregull jemi deri këtu për arsye se jemi vetëm në debat. Në moment kur votojmë, pastaj e thërrasim kuorumin.

Urdhëro i nderuar deputet Gëzim Kelmendi, ndërkohë më lejoni të nderuar kolegë në emrin tim dhe tuajin të përshëndes edhe prindin e zotit Nehat Thaçi, të cilin e kemi të pranishëm në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar prind i drejtorit të Policisë Rajonale, Nehat Thaçi,

Më lejoni që në fillim t'i falënderoj deputetët nënshkrues për këtë iniciativë dhe njëherësh të falënderoj edhe kryetarin e Kuvendit dhe Kryesinë që ka mundësuar mbajtjen e kësaj seance të jashtëzakonshme.

Në orët e hershme të mëngjesit të ditës së enjte, më 29 shtator 2016, në pikën kufitare Kosovë-Serbi është arrestuar drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, Nehat Thaçi.

Arrestimi i tij është bërë në mënyrë të jashtëligjshme dhe jolegale. Ashtu siç jemi të njoftuar, aktakuza e ngarkon atë për vepër penale të dëbimit të një familjeje serbe gjatë periudhës së luftës në Kosovë të vitit '99 në rajonin e Lipjanit.

Aktualisht, drejtori i Policisë, Nehat Thaçi, është i burgosur në Burgun e Nishit dhe i është caktuar masa e paraburgimit prej 30 ditësh.

Më 10 tetor, konkretisht ditën e djeshme, ka dalë para Prokurorisë për krim të organizuar në Beograd, ku i është lexuar aktakuza për veprën penale, me të cilën e ngarkon drejtorin e Policisë Rajonale të Kosovës, por i njëjti e ka mohuar në mënyrë kategorike këtë aktakuzë.

Kujtojmë se arrestimi i drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, Nehat Thaçi, nuk është i pari, por dyshojmë të mos jetë as i fundit. Ne si Kuvend i Kosovës jemi të bashkuar në mënyrë unanime që ta mbrojmë të drejtën, lirinë e qytetarëve dhe lëvizjen e tyre.

Ne shpresojmë që ky arrestim i tij të jetë i fundit dhe e dimë që nuk është i pari. Pse nuk është i pari?

Bazuar në fletarrestimet e lëshuara nga Serbia, janë ndaluar më herët edhe dy figura të larta të Republikës së Kosovës, konkretisht dy ish-kryeministra, ish kryeministri Haradinaj dhe ish-kryeministri Çeku.

Arrestimet kanë vazhduar në vazhdimësi, e veçanërisht është atakuar Diaspora shqiptare, të cilët gjatë udhëtimit të tyre për në Kosovë janë ndaluar dhe janë arrestuar me të njëjtën aktakuzë për pjesëmarrjen terrorizëm, kryesisht gjatë fundviteve të '90-ta dhe për pjesëmarrje në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Arrestimet gjithashtu i kanë goditur edhe bashkatdhetarët tanë të cilët jetojnë në Diasporë. Rasti më i freskët është ai në Zvicër, ku me kërkesë të autoriteteve serbe janë arrestuar dy bashkatdhetarët tanë që jetojnë në Zvicër me akuzën për pjesëmarrje në terrorizëm, konkretisht si pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kështu që ne, të nderuar deputetë, edhe sot e 17 vjet pasluftës po përballemi me një agresion dhe me një fushatë denigruese nga Qeveria e Serbisë ndaj qytetarëve tanë, në përgjithësi, dhe veçanërisht ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në veçanti.

Heshtja e institucioneve më të larta shtetërore të vendit tonë, duke filluar nga Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë dhe ia ka dhënë komoditetin Qeverisë së Serbisë që ata në mënyrë mjaftë komode të merren me arrestimin e pjesëtarëve tanë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe qytetarëve tjerë të Republikës së Kosovës.

Kosova dhe Serbia pa dyshim si dy vende, si dy shtete fqinja, duhet të bashkë punojnë në luftën kundër krimit të organizuar, kundër korrupsionit, duhet të bashkëpunojnë edhe kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe tregtisë me substanca narkotike, shqetësime këto të ngrehura edhe nga raportet ndërkombëtare. Por, përkundrazi, Qeveria e Serbisë nuk bashkëpunon fare në këtë drejtim me Kosovën. Ajo vazhdon me persekutimin, arrestimin dhe ndalimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ne si Kuvend i Kosovës jemi institucioni më i lartë në Republikën e Kosovës. Duhet t'ia japim një mesazh të qartë dhe të fortë Qeverisë së Serbisë, se nuk do të lejojmë që askush të fyejë dhe të lëndojë dinjitetin e bijve dhe bijave tona, ushtrisë tonë çlirimtare dhe shtetit të Kosovës, në përgjithësi.

Të mos harrojmë Beogradi se ne jemi viktimë dhe regjimi i atëhershëm i Serbisë është agresori. Ne kemi rreth 20 mijë të vrarë në luftën e fundit, kemi mbi 12 mijë gra të dhunuara, kemi mbi njëmijë të zhdukur që ende nuk janë kthyer dhe kemi një terrorizëm dhe gjenocid të ushtruar e të paparë në fundvitet të '90-ta ndaj popullatës së Kosovës. Dhe, Beogradi vazhdon të na arrestojë.

Unë po pyes ku jemi ne? Ku janë bijtë dhe bijat tona? Pse kemi heshtur? Mendoj që ka ardhur momenti i fundit që ne si Kuvend, si institucioni më i lartë i Republikës së Kosovës t'i themi Qeverisë së Serbisë se është mjaft. Është mjaft. Definitivisht ka kaluar çdo normë etike, morale dhe njerëzore me këto arrestime të pakufishme, të pajustificueshme dhe pa të drejta.

Kosova është shtet sovran dhe i pavarur. Kosova nuk e do luftën. Kosova nuk e do dhunën. Kosova nuk e harron të kaluarën, por Kosova e do dhe duhet ta mbrojë qytetarin e saj.

Në kërkesën që ia kam dërguar Kryesisë së Kuvendit, bashkuar me nënshkrimin e 44 deputetëve të tjerë, kam propozuar që në fund të këtij debati parlamentar të dalim me një rezolutë, e përbërë nga rekomandimet, por si propozues i kësaj seance të jashtëzakonshme ndiej një obligim moral që së paku brenda kësaj rezolute, e cila do të hartohet në fund të këtij debati parlamentar, të propozoj një rekomandim, pastaj pa dyshim që do të marrim edhe rekomandime më të mira nga ju, nga grupet parlamentare, rekomandime më produktive.

Unë propozoj që rekomandimi i parë brenda kësaj rezolute të jetë ndërprerja e menjëhershme e dialogut në Bruksel me Qeverinë e Serbisë.

(Reagime nga salla)

Pse po reagoni ashtu? Tash do ta shihni që jeni të penduar që reagoni ashtu!

Sot, më 11 tetor, ministri i Qeverisë së Serbisë, i Energjisë dhe i Minierave, ka kërkuar ndërprerjen e dialogut me Kosovën me të vetmin pretekst pse Kuvendi ditë më parë e ka miratuar Projektligjin për “Trepçën”. Do të thotë, ata bënë të kërkojnë ndërprerjen e dialogut, e ne nuk bëmë! Përkundrazi, ne kemi shumë më shumë arsye që ta kërkojmë ndërprerjen e dialogut me Serbinë dhe kusht për të vazhduar ky dialog janë dy prime bazë.

Lirimi i menjëhershëm i drejtorit rajonal të Policisë së Kosovës, Nehat Thaçi, dhe e dyta zhvlerësimi i të gjitha aktakuzave dhe fletarresteve të ngrehura për qytetarët e Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me luftën e fundit në Kosovë dhe në fundvitet e ‘90-ta.

Të nderuar deputetë,

Jemi të pastër, të pafajshëm dhe të drejtë në kuptim të plotë të fjalës shtet sovran dhe i pavarur. Vetëm kështu mund ta mbrojmë qytetarin tonë, mund ta mbrojmë luftën tonë të ndershme për liri, mund ta mbrojmë shtetin e Kosovës.

Ju falënderoj edhe një herë për mbështetjen që keni dhënë dhe pres e mirëpres rekomandimet tuaja që të dalë një rezolutë produktive dhe e fuqishme në mbrojtje të vendit dhe të qytetarëve tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar deputet! Tani fjalën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Duke pasur parasysh se nuk kam asnjë paraqitje në emër të grupeve parlamentare, unë i kam emrat e shumë deputetëve, kisha pasur dëshirë, kur grupet parlamentar, PDK-ja në këtë rast, ta ngrejë dorën kush flet në emër të grupit, pastaj LDK-ja. Do të shkojmë me radhë në bazë të partive politike.

Nga Partia Demokratike e Kosovës, kryetari i Grupit Parlamentar, zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër, zëvendëskryeministër, anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Edhe ky debat që është iniciuar sot përbën një nga sfidat tona, na imponohen çështjet që në kushte dhe rrethana normale nuk do të kishim pasur nevojë.

Por, është mirë që sot këtë debat, të iniciuar nga zoti Kelmendi dhe disa deputetë tjerë ta shndërrojmë në një përpjekje shtesë, në një favor për lirimin sa më të shpejtë të Nehat Thaçit. Besoj dhe shpresoj që kjo që do të bëjmë sot të hyjë në funksion të lirimit të tij, të angazhimit më të madh të të gjitha institucioneve dhe të mos shndërrohet në një debat për interesa më të ngushta, ose për agjenda më të ngushta politike, për çka jam i bindur se do të shkojë veçse drejt.

Sipas informacioneve që ne i kemi tashmë, pas luftës, Prokuroria dhe gjykatat në Serbi kanë filluar hetime dhe kanë shpallur gjykime për shumë qytetarë të Republikës së Kosovës me akuza për krime ndaj popullatës civile serbe.

Pra, siç u tha edhe nga deputeti, ky nuk është rasti i parë. Ka edhe disa raste ose shumë raste të tjera dhe shpresojmë që ky të jetë rasti i fundit.

Për një kohë ka pasur informacione se kanë pushuar këto fletareste dhe sipas të gjitha gjasave kjo është bërë për shkak të një presioni ndërkombëtar, që i është bërë Qeverisë serbe, dhe prapë kemi arrestime të reja, prapë kemi aktivizim të këtyre fletarresteve. Sipas informacioneve diku në korrik 2016, pothuajse tashmë çdo qytetar i Republikës së Kosovës mund të jetë i rrezikuar, ose thënë ndryshe askush nuk është i sigurt të udhëtojë nëpër Serbi.

Çka duhet të bëjnë institucionet tona? Mendoj që duhet një aktivitet më i shtuar më energjik i Ekzekutivit tonë, i institucioneve përgjegjëse. Mendoj që duhet ta trajtojnë çdo aktivitet nëpërmjet mundësive tyre, e sidomos me Brukselin. A duhet të shtrohet kjo çështje në Bruksel, ose në procesin e dialogut? Unë mendoj që duhet të ndodhë lirimi i tij, që të mos ketë nevojë, porse duhet ta kemi parasysh faktin që shumë qytetarë tashmë lëvizin më lirshëm nëpër Serbi për faktin se është arritur ose janë realizua disa marrëveshje që kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë të qytetarëve të të dyja vendeve.

Pra, duhet të qartësohen këto dy pozicione dhe Brukseli duhet të jetë i njoftuar për gjithçka që ka të bëjë me pengimin e qytetarëve në lirinë e lëvizjeve në dy vende.

Por, lirimi ose arrestimi i Nehat Thaçit nuk ka të bëjë vetëm me një qytetar të rëndomtë. Në fakt, arrestimi i tij duhet të trajtohet si një kidnapim klasik. Mendoj që kjo duhet të dihet. Ai është arrestuar, është kidnapuar dhe pa asnjë lloj paralajmërimi, duke pasur parasysh që një polic ka mundur edhe të ketë informacione nëse është apo jo në një listë fletarresti ose i përndjekur nga institucionet, ose i informuar nga organet serbe nëpërmjet institucioneve ndërkombëtare.

Ne si Parti Demokratike e shfrytëzojmë rastin t'u bëjmë thirrje institucioneve tona të Ekzekutivit që t'i shtojnë me urgjencë aktivitetet e tyre nëpërmjet partnerëve e institucioneve përgjegjëse që të kërkohej sa më shpejt lirimi i zotit Thaçi dhe po ashtu kërkojmë nga institucionet që të bëjnë edhe më shumë për anëtarësimin e Policisë sonë në institucionet e sigurisë ndërkombëtare, në Interpol, Europol e të tjera, në mënyrë që ta kemi në njëfarë mënyre një siguri më të madhe për informacionet dhe për aktivitetet që mund të bëhen për luftimin e krimit dhe të mos na ndodhë pastaj që me Serbinë të na përsëriten rastet e njëjta sikur ky dhe raste të tjera.

Po ashtu, kërkojmë edhe një bashkëpunim më të madh, u bëjmë thirrje institucioneve edhe të regjionit, e veçanërisht të Serbisë, që të shtojnë aktivitetet e bashkëpunimit me Policinë e

Kosovës për menaxhimin e integruar të kufirit dhe për detyrimet që dalin nga pakoja e Brukselit, për detyrimet që dalin nga Komisioni Evropian në procesin e integrimi dhe liberalizimit të vizave dhe të mos bëjnë aktivitete të njëanshme, të cilat veçse e pengojnë procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet nesh dhe e pengojnë po ashtu edhe të njëjtën gjë të qytetarët tjerë joshqiptarë në Kosovë.

Kjo nuk është që është në politikën e institucioneve të Kosovës, por kjo nxitje mund të bëhet vetvetiu nga vetë reagimet që mund të ndodhin në Kosovë.

Pra, duhet të bëjmë të gjithë bashkërisht dhe ne po ashtu si Parti Demokratike do të kujdesemi që një rezolutë ose një dokument i përbashkët i harmonizuar ndërmjet partive politike të dalë nga ky debat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Pajaziti!

Ndërkohë fjalën e ka zoti Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Sigurisht që edhe ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e dënojmë këtë akt të papranueshëm të organeve policore dhe shtetërore serbe si një akt i cili nuk i kontribuon normalizimit të raporteve dhe raporteve në përgjithësi ndërmjet fqinjësh.

Ne si grup parlamentar normalisht e përkrahim angazhimin dhe kërkojmë që të shtohet edhe më tej ky angazhim i organeve tona shtetërore, organeve që janë kompetente të Republikës së Kosovës në drejtim të asaj që zoti Thaçi sa më parë të kthehet në Kosovë. Po ashtu, është kërkesë dhe ka qenë edhe më herët dhe do të jetë në vazhdimësi, përderisa ka veprime të tilla të shtetit serb, që të njëjtit t'i ndalin veprime të tilla dhe këto organe tona shtetërore dhe task-forca e krijuar nga ato ta bëjnë punën e tyre dhe secili nga fushëveprimtaria e vetë ta jap kontributin në mënyrë që sa më shpejt që të jetë e mundur të zgjidhet ky rast i papranueshëm dhe për ne sigurisht i paligjshëm i organeve shtetërore serbe.

Po ashtu, ne e shfrytëzojmë rastin që të kërkojmë nga bashkësia ndërkombëtare që edhe ata ta shtojnë tryshinë ndaj Beogradit dhe t'i ndërpresin këto veprime tërësisht të papranueshme dhe joligjore dhe që nuk i kontribuojnë aspak frymës së mirëkuptimit dhe vullnetit të dëshirës, veçmas nga Kosova, që të ketë stabilizim të raporteve tona si dy shtete të pavarura.

Sigurisht që ne si grup parlamentar, meqenëse ka shumë të lajmëruar, unë po shoh nga kolegë deputetë, nuk do të marr shumë kohë, do ta japim kontributin tonë që në fund të debatit të ketë harmonizim të rekomandimeve, në mënyrë që ato pastaj të votohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Lëvizja “Vetëvendosje”, zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të Kuvendit,
Komandantin e Policisë për rajonin e Mitrovicës, zotin Nehat Thaçin, Serbia e arrestoi para 13 ditëve.

Në Qeverinë e Kosovës, arrestimi i tij shkaktoi një heshtje të plotë. Në çdo vend normal të botës, kur arrestohet një qytetar i thjeshtë për shkaqe politike, Qeveria menjëherë reagon dhe mobilizohet, e lëre më në rastin e Nehat Thaçit, meqë u arrestua një zyrtar i lartë i Policisë së Republikës së Kosovës.

Faktikisht, Serbia na e ka arrestuar njeriun e tretë për nga hierarkia në Policinë e Republikës së Kosovës. Ai është komandat rajonal i Policisë.

Një javë prej kur po mbahet ai në paraburgim, përfaqësuesi i Zyrës së Kosovës në Serbi shkoi dhe e vizitoi Nehat Thaçin. Ishte shumë vonë. Pra, një javë ditë pasi u arrestua ai, ishte reagimi i parë i shtetit të Kosovës. Kurse këtu në Kosovë brenda ministrat dhe zyrtarët qeveritarë e vetmja që deklarorin ishte shprehja e famshme, që zakonisht tregon që nuk je duke bërë asgjë, e që është “jemi duke punuar shumë në këtë drejtim”.

Forma e reagimit për Nehat Thaçin ishte një vajtim përgjërues për bashkësinë ndërkombëtare, më shumë duke kërkuar ndihmë, ashtu që bashkësisë ndërkombëtare në njëfarë forme t’i vijë gjynah për ne dhe të reagojë.

Kjo politika e gjynahit që po e aplikon Qeveria jonë është me të vërtetë joproduktive dhe e papranueshme. E portretizon shtetin e Kosovës sikur një entitet i cili nuk mund t’i kryejë asnjërin prej punëve të veta. Ky është gabim.

Serbia me çdo veprim të saj po na jep argumente të mjaftueshme për të aplikuar reciprocitet. Kurse Qeveria jonë, pas çdo veprimi të Serbisë, sheh arsye të mëtutjeshme për dialog, për kompromise. Prandaj, veprimeve të Serbisë, Qeveria jonë i kundërpërgjigjet me nënshtrim, me mirëkuptim dhe me relativizim të agresionit të saj që e aplikon në Kosovë. Ky është pozicion shumë inferior, që e ka Qeveria jonë karshi Serbisë.

Kurse kryeministri Mustafa e vendosi një person, i cili qysh e thotë një fjalë e urtë popullore “as macen nuk mund ta largojë prej përshehi”, e lëre më diçka tjetër. As qeveritë e mëparshme nuk kanë qenë fort ndryshe.

Po më kujtohet kur Serbia na i arrestoi ata dy policët, para katër vjetëve, Bajram Rexhepi si ministër i Punëve të Brendshme dilte dhe thoshte që ky është një akt qyqar i Serbisë. Ndërkohë vetë nuk bënte asgjë dhe e luste bashkësinë ndërkombëtare për të na ndihmuar, sepse vetë nuk mund të bënte asgjë.

Tash dua t'i ndaj me ju disa momente, disa veprime që i ka bërë shteti i Serbisë dhe strukturat e Serbisë në veri prej momentit kur ne i kemi filluar negociatat me Serbinë. Kjo ka qenë në mars të vitit 2011. Prej asaj kohe, dëgjoni se çfarë ka ndodhur në raport me Serbinë dhe çfarë kanë bërë strukturat e Serbisë edhe në Kosovë, por edhe shteti i Serbisë.

Katër muaj pasi filluan negociatat me Serbinë për fqinjësi të mirë dhe për normalizim të marrëdhënieve, pikërisht strukturat e Serbisë e vranë Enver Zymberin. Pra, katër muaj pasi i kemi filluar negociatat për t'i përmirësuar marrëdhëniet, ata na kanë vranë Enver Zymberin.

Qeveria jonë nuk u mbush mend. Një vit më vonë, 2012, strukturat e Serbisë në veri të Mitrovicës e vranë Selver Haradinaj. Qëllimi ishte që t'ia vrisnin krejt familjen, por fati e deshi që të vritej Selver Haradinaj, fatkeqësisht edhe disa anëtarë të familjes së tij të plagoseshin.

Po atë vit, 2012, Serbia i arrestoi Shukri Binakun dhe Sami Beqirin brenda territorit të Republikës së Kosovës. Këta janë dy polic të Kosovës, të cilët Serbia i trajtoi dhe i paraqiti në mënyrë poshtëruese.

Një vit më pas, 2013, strukturat e Serbisë e vranë pjesëtarin e EULEX-it, pjesëtarin lituanes të EULEX-it, kurse një vit më vonë, 2014, me kërkesë të Serbisë në Zvicër u arrestuan dy veteranë të UÇK-së, Albert Spahiu dhe Genc Zogaj.

Po atë kohë, strukturat kriminale të Serbisë u dolën në pritë me qëllim për t'i vranë tre vëllezërit Brahimi në Leposaviq. E vranë Ardianin, kurse dy vëllezërit e tij, Albertin dhe Albionin, i plagosën rëndë. Sërish asnjë i kapur, asnjë kriminel i kapur prej të gjitha këtyre rasteve që i thashë. Kriminelët janë të lirë, ose në Serbi, ose diku në veri të Kosovës, dhe përgjatë gjithë kësaj kohe kanë vazhduar negociatat me Serbinë, përgjatë gjithë kësaj kohe, sa i përmenda këto veprime të Serbisë edhe strukturave të saj brenda shtetit të Kosovës, dhe asnjë vërejtje prej Qeverisë së Kosovës. Asnjë pakënaqësi. Asnjë kushtëzim i dialogut me Serbinë!

Në gusht të këtij viti, tash para 2-3 muajve, Serbia e arrestoi bashkatdhetarin tonë, Xhavit Kolgeci, për shembull, nga Theranda, sërish asgjë nga Qeveria.

Dhe, është po kjo Serbi që Qeveria jonë e trajton si fqinj të mirë dhe që po i ndreq marrëdhëniet me të, që e arrestoi para dy javësh komandantin e Policisë të rajonit të Mitrovicës, Nehat Thaçin. Domethënë kjo nuk është e rastësishme. Kjo vjen në konsistencë me të gjitha veprimet e Serbisë

që i ka kundër Republikës së Kosovës që përgjatë gjithë kësaj kohe, Qeveria e Kosovës vetëm i mbyll sytë dhe thotë në mënyrë të pajustificueshme që dialogu megjithatë duhet të vazhdojë.

Edhe sa veprime të tilla duhet të ndodhin që kjo Qeveria jonë, e papërgjegjshme, ta kuptojë se Serbia nuk përmirësohet në këtë mënyrë dhe duke i bërë kompromise?

Ky është momenti vendimtar për ta rikonsideruar në tërësi dhe në themel konceptin e dialogut me Serbinë.

Koncepti i dialogut me Serbinë, që Qeveria jonë e ka aplikuar, krejt çka bën është t'ia lehtësojë Serbisë mosnjohjen e Kosovës.

Prej fusnotës e targave e deri te “Zajednica” e te Telekomit, të gjitha këto janë modalitetet për t'i akomoduar strukturat e Beogradit dhe për t'ia mundësuar operimin më të lehtë dhe të papenguar brenda Republikës së Kosovës. Ky kurs duhet të ndërrojë radikalisht nëpërmjet një pakoje të masave që Serbisë duhet t'ia bëjnë të pamundshëm funksionimin brenda Republikës së Kosovës. Dhe, ky është momenti i duhur. Tash, pas arrestimit të Nehat Thaçit, unë mendoj që është momenti i duhur.

Në rastin e Nehat Thaçit janë shpërfaqur dy dobësi të Qeverisë së Kosovës.

E para dobësi është që unë dua ta shtroj në formë të pyetjes: A e ka ditur ministri i Punëve të Brendshme, këtu e paskemi ministrin e Punëve të Brendshme, a ka qenë i informuar për udhëtimin e komandantit rajonal të Policisë? Nëse nuk ka qenë, unë po them shumë keq, e nëse nuk ka qenë, atëherë si është e mundshme ta dijë që ka për udhëtuar nëpër Serbi dhe të mos e dijë që është i akuzuar dhe që në momentin që këmba e tij shkel në territorin e Serbisë, ky do të arrestohet automatikisht?

E dyta dobësi e Qeverisë së Kosovës, qysh është e mundshme 17 vjet pas çlirimit të Kosovës dhe 8 vjet pas pavarësisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës të mos e posedojë një listë të të gjithë të akuzuarve, listë kjo që do të tregonte që në momentin e parë që i bini nga Serbia ju do të kishit për t'u arrestuar. Qysh nuk e posedon Qeveria e Kosovës një listë të tillë?

Kjo tregon në njëfarë mënyre se në çfarë niveli të përgatitjes është Qeveria e Republikës së Kosovës. Një listë të thjeshtë, e marrtë drejt, me 100 emra, me 200 emra! Nuk po di sa emra të të gjithë të akuzuarve prej presidentit të Kosovës e të gjithë atyre që në Serbi kanë aktakuza nëpër gjykata, e deri te ushtarët më të thjeshtë, pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, janë çka po di unë 150, 200, 300, sa do që të jenë, Qeveria ta ketë në dorë atë listë edhe ta publikojë. Por, ne për çdo vit, duke qenë që Qeveria nuk e ka atë listë, edhe të gjitha ato bisedime me

Serbinë! Shikoni, vetëm një gjë është dashur ta bënte Qeveria e Kosovës në bisedime me Serbinë.

Në momentin e parë kur i ka filluar bisedimet me Serbinë veç është dashur ta kërkojë atë listë e ta marrë, edhe ditën e mirë. U kryen negociatat, u kryen bisedimet. E dimë që po na trajtoni si armiq, e dimë çka jemi për juve, vetëm pse kemi qenë luftëtarë të lirisë përfundojmë nëpër burgje. Ditën e mirë, u kryen negociatat! Ti po më trajton si armik, qysh mund të bisedojmë?! Në momentin e parë ta arreston kryeministrin, presidentin, ministrat, kushto që ka qenë në UÇK. Kjo është e papranueshme. E kjo tregon edhe çfarë Qeverie e kemi, në fund të fundit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Pal Lekaj. Le të bëhet gati zoti Zafir Berisha, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma për Kosovën”.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht më duhet të them se kjo seancë, veç e jashtëzakonshme nuk është, ndryshe mund t’i themi si të doni. E jashtëzakonshme do të mund të quhej nëse një e tillë do të mbahej me ditën kur ka ndodhur arrestimi i drejtorit të Policisë për rajonin e Mitrovicës, Nehat Thaçi. Apo jo, më falni se atë ishte duke na bindur kryeministri i Kosovës se si është gjithçka në rregull me pjesën veriore. Për t’ia ndihmua ministres së Dialogut që veç dialog nuk po bën, ndryshe veriu veç më i egër po bëhet.

Për t’u kthyer në temën e seancës, qëndrimi ynë është se: Bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që kishin filluar si teknike, e më pas dolën të jenë politike prodhuan shumë dokumente me inicialet e vendosura, në to herë nga ishte kryeministri i Serbisë, Ivica Daçiç, dhe ish-kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, herë nga Isa Mustafa e Vuçiq, e herë nga Edita Tahiri e Gjuriqi, të njohura për publikun me emra nga më të ndryshmit, herë si marrëveshje për normalizim marrëdhëniesh, e herë si marrëveshje që do të ndikojnë në jetën e qytetarëve të të dyja shteteve tona. Herë marrëveshje që de facto nxjerrin në dritë njohjen reciproke ndërmjet dy vendeve tona, e herë kështu, e herë ashtu, por asnjëherë nuk janë shikuar me syrin kritik për ta nxjerrë më të mirën nga këto negociata, por vetëm keni hedhur firma kuturu.

Edhe sot insistojmë të dimë, i nderuar kryeministër, për të pagjeturit a keni biseduar ndonjëherë, për pensionistët a keni biseduar ndonjëherë, për mundësinë e njohjes së pesë vendeve të Bashkimit Evropian, a e keni kushtëzuar dialogun? Po për njohjen reciproke të vendeve tona ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, a keni pasur guxim të flisni? Për marrëveshjen e diplomave universitare, çfarë po bëhet me to? Po për lirinë e lëvizjes së qytetarëve të Kosovës në Serbi, apo

anasjelltas, çka u bë, se i keni proklamuar shumë, por dihet edhe me rastin e fundit të arrestimit të drejtorit të Policisë rajonale të Mitrovicës.

Prefiksi apo kodi telefonik i Kosovës, patët thënë se nuk ktheheni nga Brukseli pa e arritur këtë marrëveshje. Ku është marrëveshja? Po, librat kadastralë të Kosovës ku janë? Policia në veri ende nuk e ka komunikimin e mirëfilltë në mes zinxhirit komandues.

Po me komunat e dala nga zgjedhjet lokale, e të cilat funksionojnë paralelisht ende, më shumë sipas rregullave të Serbisë sesa të Kosovës.

Po Gjyqësori, ende s'janë dekretuar gjykatës e prokurorë për atë pjesë.

Marrëveshja për Asociacionin e Komunave me shumicë serbe në Kosovë, e cila aq keq ka qenë, se prodhoi konflikt politik të nivelit institucional në Kosovë.

A na tregoni për të arriturat në gjithë këtë megalomani dialoguese, apo tregojë qytetarëve sa para keni harxhuar për sorollatjet tuaja në emër të këtyre të arriturave, që askush nuk i njeh.

Përkritazi me këto marrëveshje që s'u arritën kurrë, sepse derisa nuk zbatohen janë sikur nuk janë arritur fare, qytetarët kanë sfida ende, si në aspektin emocional, moral, politik, ekonomik, financiar, e po ashtu edhe teknik, sepse u nxjerr shumë probleme në realizimin e nevojave të tyre.

Apo ta marrim marrëveshjen për sigurinë e automjeteve, të cilën negociatorja e hekurt Edita Tahiri e kishte emërtuar si urë lidhëse e qytetarëve, apo shteteve. E çka jo tjetër, qysh di.

Zonja e marrëveshjeve t'i arsyetojë teorikisht di mirë. Përkundër orvatjeve për t'i shituar si marrëveshje që i zgjidhin problemet, realiteti na tregon krejt të kundërtën. Shtetasit e Republikës së Kosovës edhe sot nuk ndihen të sigurt me të kaluarën në territorin e Serbisë.

Viktimë e këtyre marrëveshjeve dhe deklaratave të ministres ndoshta ka rënë edhe drejtori i Policisë rajonale, zoti Nehat Thaçi.

Kjo Qeveri, ose më mirë thënë, ministrja e ngarkuar për Dialog, të gjitha marrëveshjet i ka quajtur historike, por këto marrëveshje, sikur edhe kjo Qeveri, më shumë u shkon t'u themi sfiduese sesa historike për vendin tonë.

Asnjëherë në këto negociata s'keni folur për të zhdukurit, për drejtësinë që nuk u bë kurrë, për të gjitha ato viktima të shkaktuara nga regjimi i Serbisë. Po ashtu, s'folët kurrë as për pensionet që i mban peng Serbia, ajo është djersë e baballarëve dhe njerëzve të Kosovës.

Pra, këto bisedime historike mund të cilësohen vetëm nga pala serbe e Kosovës. Më së miri u shkon t'u thuhet marrëveshje të dhembshme për shtetin dhe qytetarët e saj.

Sipas agjendës evropiane të Serbisë, Qeveria jonë shumë mirë është duke i realizuar bisedimet, por për Kosovën asnjë marrëveshje nuk dha ndonjë rezultat për afrimin tonë me Bashkimin Evropian, por edhe për sigurinë fizike të qytetarëve, e as të zyrtarëve të Kosovës.

Rasti i fundit për të cilin është thirrur edhe kjo seancë e jashtëzakonshme e tregon më së miri praktikën e këtyre marrëveshjeve.

Keni nënshkruar marrëveshje me Serbinë që nuk janë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Keni nënshkruar marrëveshje me dy fytyra. Rasti i Asociacionit, një krijesë etnikisht serbe, aspak në frymën multietnike të Kosovës, që e kemi proklamuar prej dekadash.

Pra, marrëveshje krejtësisht izoluese për pakicën serbe dhe dezintegruese për Kosovën.

Keni nënshkruar marrëveshje që bien ndesh edhe me demokracinë, të cilën e synon vendi ynë. Dëmi kryesor që po sjellin këto marrëveshje është se Kosova në sytë e botës po vazhdon të proklamohet si multietnike dhe e integruar, por kështu nuk është brenda saj.

Konform kësaj, këto marrëveshje të dala nga dialogu i Brukselit nuk shkojnë sipas planit të synuar në normalizimin e raporteve Kosovë-Serbi. Ajo që është më e keqja në gjithë këtë histori, më mirë thënë në këtë histori, është mungesa e përgjithësisë nga ana e qeverisjes për të reflektuar me dorëheqje pas shkeljeve kushtetuese, të bëra në këto marrëveshje.

Ky lloj i bisedimeve duhet përmbillet sa më parë. Zbatimi i marrëveshjeve të arritura deri më tani nga bisedimet e Brukselit do të duhej të ishin prioritetet, edhe të Kosovës, edhe të Serbisë, përpara se të nënshkruhen të tjerat.

Vetëm zbatimi i tyre në praktikë, e jo me ligjërata moralizuese, është matësi më i mirë i të arriturave.

Qytetarët e Kosovës po vuajnë derisa interpretohen në dy fytyra, e me dy qëllime këto marrëveshje, e derisa gjithçka bëhet për konsum politik mbi parimin e respektimit të marrëveshjeve, Serbia të arriturat praktike po i konverton me taktika politike, duke i dhënë hapësirë dykuptimësisë po përfiton në raport me BE-në, po ashtu edhe në raport me Kosovën, e ne çka po përfitojmë? Vetëm tensionim e sabotim.

Kosova nuk duhet të ngelë në Serbi, por të kalojë në aksion duke insistuar me qëllimin e këtij dialogu të pakohë.

Përfundimi i bisedimeve, zbatimi i marrëveshjeve të arritura dhe konkludimi i një dokumenti të njohjes së ndërsjellë të jetë shpejt faza finale e maratonës së bisedimeve që po zgjat kaq vite. Kjo gjë do t'ua mbyllte gojën sorollatësve paramilitarë të skenës politike serbe, që vijnë e lëshojnë deklarata nxitëse në Kosovë, e do t'u bëhej me dije se nuk guxojnë të arrestojnë qytetarë për teket e veta, duke e nënçmuar Kushtetutën dhe shtetin e Kosovës në çdo rast e mundësi, të mos ngarkohen qytetarët tanë nga keqpërdorimi i bisedimeve politike nga këta skenaristë të politikës ditore, si të ne në Republikën e Kosovës, ashtu edhe në Beograd.

Përfundimisht, vazhdimi i këtyre bisedimeve, ku të arriturat e tij teorike nuk po zbatohen, është i kotë nga fillimi në fund dhe shteti i Kosovës duhet të marrë një qëndrim të prerë në lidhje me këto bisedime.

Qeveria e Kosovës duhet të pranojë publikisht, të kërkojë falje e të japë përgjegjësi që kanë dështuar, që të mos dështojë shteti i Kosovës si pasojë e dialoguesve dhe Qeverisë së përgjumur.

Nga se qeveritë e dialoguesit shkojnë e vijnë, kurse Republika e Kosovës do të ekzistojë edhe më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha, fjala është për ju, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma për Kosovën”. Ndërkohë zoti Qerim Bajrami bëhet gati në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë çështja ka qenë e qartë, e cila do të diskutohet në këtë seancë, unë po mendoj se pas iniciuesit është dashur edhe Qeveria të thotë diçka, por Qeveria siç ka heshtur që nga dita e arrestimit të zotit Thaçi, po vazhdon ende të heshtë.

Në fakt, ne duhet të jemi edhe kritikë, edhe vetëkritikë

Kritikë në raport me Serbinë, por vetëkritikë në raport me vetveten dhe institucionet tona.

Serbia është ajo që ka qenë dhe edhe Qeveria aktuale është vazhdimësi e qeverive të mëhershme shoviniste të Serbisë. Për të mos thënë se aktorët e Qeverisë në Serbi dhe politikëbërësit atje janë ata që kanë bërë krime dhe gjenocid në Kosovë, ose zëvendësit e asaj Qeverie. Kështu që ne para se të hidhërohemi me Serbinë duhet të hidhërohemi me vetveten, kur them me vetveten e kam fjalën me Qeverinë fillimisht, pastaj edhe me Kuvendin.

Kosova gabimin më të madh trashanik është që Serbinë e ka bërë partner në bisedime për çështje të brendshme të Kosovës. Me bisedimet që ka filluar me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar në Bruksel pa kurrfarë kushti.

Dhe, natyrisht kur i kemi filluar ato bisedime, që një nga kushtet ka mundur të jetë edhe çështja të cilën po e trajtojmë, nuk do të kishim ardhur në këtë situatë që jemi.

Bisedimet që u thanë edhe këtu nga parafolësit, të cilët fillimisht janë proklamuar si teknike, kanë qenë më shumë se politike.

Serbia është bërë partner në zgjidhjen e shumë problematikave me të cilat përballet shoqëria jonë dhe kjo është me fajin e personave përgjegjës në institucionet e Kosovës.

Kjo që ka ndodhur edhe do të ndodhë edhe nesër, edhe pasnesër, sepse kemi institucione ashtu të papërgjegjshme, që nuk e respektojnë as vetveten, as edhe këtë Kuvend. Pra, këtë unë do ta argumentoj me fakte.

Në fakt, po ndalem edhe pak te Serbia. Serbia, ju e dini se Kosovën me kushtetutë e parasheh provincë të saj. Nëse nuk është kështu, urdhëroni më thoni edhe më bindni, jo veç sa për të thënë.

Dhe, sjellja me zotin Thaçi, nëse e kemi parasysh këtë që e thashë, ajo është duke u sjellë me një qytetar të saj, sipas politikës së Serbisë. Nëse nuk është kështu urdhëroni ma thoni të kundërtën.

Gabimin më të madh që ne e kemi bërë është që jemi futur të bisedojmë, t'i relaksojmë marrëdhëniet me Serbinë. Serbia si shtet gjenocidal, jo veç në raport me Kosovën, por edhe me vendet tjera të rajonit, nuk është ndëshkuar dhe përkundrazi duke e përkëdhelur dhe duke u treguar si institucione servile të atij shteti, ne besa e kemi bërë edhe faktor në rajon. Shumë çështje tash lidhen me Serbinë, jo më me Kosovën. Këta që kanë qenë në Bruksel para disa ditësh e dinë se në cilën agjendë është tash për tash Kosova, sepse Serbia është ajo që ka qenë, luan me dy karta. Në kohën kur bisedon me Evropën luan me kartën e Rusisë dhe anasjelltas. Dhe, faktikisht, duke mos vepruar konform përgjegjësisë që kemi kushtetuese, institucionale dhe ligjore në raport me këto zhvillime politike në rajon, ne jemi në gjendjen që jemi.

Unë po mendoj se ky Kuvend ka nxjerrë një rekomandim, ka nxjerrë besa edhe rezolutë dhe çdo gjë që flitet për ta nxjerrë në këtë rast unë mendoj se është humbje kohës, siç është humbje kohe edhe ajo task forca e cila u programua para disa ditësh, sepse asgjë nuk ka bërë, ajo është vetëm për të fituar kohë.

Ne e kemi pasur në komision ministren e Dialogut, nuk ka thënë asgjë, besa ka ikur edhe e ka gjuajtur topin te ministri i Jashtëm edhe ky iku, se e ka ditur që dua ta pyes.

Ministri i Jashtëm, e kemi pasur në raport në komision, nuk ka thënë asgjë. Tallje që u bëhet çështjeve tepër të rëndësishme dhe jetike për vendin, sepse është në pyetje një nga zyrtarët e lartë të shtetit të Kosovës dhe për të mos ndodhur kjo, nëse ka diçka të thotë nga ajo. Ok-ej!

Zoti Isa Mustafa mund edhe të qeshni, por njëri nga përgjegjësit jeni ju. Po e di që nuk mërzhitesh, nuk është problem, veç unë po dua të them që jeni përgjegjës, sepse ju nuk e respektoni shtetin, nuk e respektoni Parlamentin.

Ky Parlament, vitin e kaluar, më 19 qershor, e ka nxjerrë një rezolutë, sepse e kemi pasur një rast të ngjashëm, të përafërt në Slloveni me zotin Haradinaj, i cili ka qenë i ndaluar si rezultat i aktakuzave të Serbisë dhe regjimit fashist të Milosheviqit, dhe në atë rezolutë, në pikën 2, u fol këtu për rezolutat, të cilat do të jenë fjalë goje, thuhet se Qeveria e Kosovës kërkoi urgjentisht nga Brukseli pastrimin e menjëhershëm të listave, respektivisht fletarrestimeve të lëshuara nga Serbia në raport me qytetarët e Kosovës, ish-ushtarë të UÇK-së, e kështu me radhë.

Çfarë ka bërë Qeveria? Asgjë nuk ka bërë! Ne do të nxjerrim përsëri rezolutë dhe do ta presim zyrtarin e radhës, apo qytetarin e radhës? Kjo është thjesht një muhabet për mos të mos e përmendur atë zhargonin që qytetarët e njohin që e përdorim në Prizren “mabet ollsën”, a po zoti Hamiti?

Unë mendoj se ne duhet t’i kthehemi vërtet shtetit dhe institucioneve, ose të shkojmë në shtëpi, dhe të themi “burra nuk jam i aftë dhe po shkoj në shtëpi”.

Ne nuk mund të fshehemi si zonja Edita Tahiri, “kemi folur me Brukselin, me miqtë ndërkombëtarë”. Ky është kamuflim për mospunën, për mosveprimin në raport me përgjegjësitë që i kanë institucionet.

Mua më vjen keq, është këtu edhe prindi i zotit Thaçi, por ja që ky është Parlamenti i Kosovës, i cili shpeshherë ka të drejtë, por e ka një organ i cili duhet t’i japë llogari këtij Parlamenti dhe këtij shteti që e pa sesi qeshet dhe thotë “punë e madhe”.

Domethënë ky është serioziteti i këtij institucioni, për të cilën ne, mendoj në rast se duhet të merret seriozisht, duhet marrë një rezolutë a rekomandime se si të sillet Qeveria. Natyrisht se pajtohemi me atë që u përmend, që duhet urgjentisht të ndërpriten bisedimet, bile janë zgjatur shumë.

Edita Tahirit unë i kam thënë edhe në takim para dy ditësh është dashur menjëherë atë natë t’i hipë aeroplanit e të vijë në Prishtinë, se është fjala për një njeri me rëndësi të peshës së veçantë, i sigurisë së lartë, i cili ka pasur qasje në shumë informacione sekrete të shtetit dhe është shumë

normale që çdo lëvizje e njerëzve të nivelit të tij është dashur të jetë me llupë e përcjellë nga mekanizmat tjerë të shtetit që këta zyrtarët pas meje i dinë.

Dhe, ne, në rast se lejojmë këso veprime, domethënë ne e nënçmojmë shtetin dhe perspektivën e këtij vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Qerim Bajrami, urdhëro!

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani poslanici,

Poštovani premijeru, ministri,

Poštovani građani Kosova,

Poštovani članovi porodice gospodina Nehata Tačija,

Ponoviću ono što sam rekao i na Komisiji za spoljne poslove i na Komisiji za unutrašnje poslove da smo i mi razočarani i da tražimo momentalno oslobođenje gospodina Nehata Tačija, direktora Regionalne policije u Mitrovici.

Ovaj akt ispred državnih organa Republike Srbije vjerovatno nije ni u kom slučaju slučajan akt, on je smišljen i on je učinjen da bi se isprovocirala situacija i da bi se verovatno prekinuo dijalog u Briselu.

Da posetimo da slični akti ispred Vlasti Republike Srbije se već provode unutar nekoliko meseci, a nedavno je bio i organiziran referendum u takozvanoj Republici Srpskoj u Bosnoj i Hercegovini, koji je svakako rukovodstvo u Beogradu moglo da spreči da je hteo.

U svakom slučaju, nama ovde treba mudra odluka i uz sav pritisak izvrših organa vlasti koji će biti sproveden u narodnom periodu, treba nam takođe da podsetim jaki oslonac i na međunarodnu zajednicu, u ovom slučaju, i na Kancelariju Evropske unije i na Američkom ambasadu, i na ambasade Kvinte da bih ta gospoda isposlovala što prije pritisak na Vlasti Republike Srbije i da bih gospodin Nehat Tači što prije bio oslobođen.

Nemojmo zaboraviti da je čovjek u zatvoru, optužen verovatno nepravедno i da će on biti navodno suđen i tako dalje.

Dakle trebamo raditi sve da preko Međunarodne zajednice gospodin Nehat Tači osloboditi. Zašto ovo kažem?

Vjerovatno naših ministri i naš premijer ne iznose situaciju, ali veoma često kod nekih poseta ovde od strane visokih dužnosti Republike Srbije imao pritisak od strane Međunarodne zajednice da oni dobiju da se slobodno kreću po Kosovu.

Evo prilike Međunarodnoj zajednici da to isto primeni taj reciprocitet, bilo po znacima navoda ili bez znake navoda i prema Vlasti Republike Srbije, i da na njima izvrši pritisak da se gospodin Nehat Taçi što prije oslobodi i bude što prije u okviru u svojoj porodici da nastavi svoj dužnost. Hvala vam i daćemo puni doprinos u rezoluciji, odnosno zaključcima koje će ova Skupština da usvoji.

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar zoti Bajrami! Tani, pas përfundimit të diskutimeve nga grupet parlamentare, përfaqësuesi i Qeverisë, i nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa, fjala për ju.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Tash ne po ballafaqohemi me situata mjaft të pakëndshme dhe mjaft problematike në Kosovë me rastin e arrestimit dhe burgosjes së njerëzve nga Kosova që ndërlidhet në këtë rastin e fundit dhe me arrestimin dhe mbajtjen në arrest të qytetarit tonë Nehat Thaçi, nga pushteti serb, që ne konsiderojmë që është një akt politik dhe nuk është në harmoni me vullnetin e Kosovës për të ecur përpara në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Zoti Nehat Thaçi është qytetar i Republikës së Kosovës. Udhëtimi i tij përmes Serbisë, sipas informatave që kam unë si kryeministër, nuk ka qenë udhëtim zyrtar dhe nuk ka qenë në cilësinë e zyrtarit të Policisë së Republikës së Kosovës. Ka qenë udhëtim privat dhe ai ka udhëtuar si qytetar i Republikës së Kosovës.

Mirëpo, janë totalisht të papranueshme sjelljet e Serbisë në arrestimin dhe mbajtjen e qytetarëve tanë dhe nën akuzat që atyre u vihen për vepra të cilat nuk i kanë bërë, sepse ne kemi kërkuar nga Serbia, nëpërmjet ministrive tona, Ministrisë së Drejtësisë dhe autoriteteve ndërkombëtare, nëpërmjet zëvendëskryeministrit Kuçi, si dhe nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, që zoti Thaçi të kthehet në Kosovë, ndërkaq për të gjitha dyshimet që i vihen atij organet e Republikës së Kosovës do të ndërmarrin masa sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, sepse nuk ka asnjë arsye që Serbia të ndërhyjë në punët e brendshme të Republikës së Kosovës dhe t'i mbajë peng qytetarët e Republikës së Kosovës.

Unë ju siguroj se edhe Ministria e Drejtësisë, edhe e Punëve të Brendshme, edhe Punëve të Jashtme, por edhe zëvendëskryeministri Kuçi, i kanë ndërmarrë veprimet e tyre, i kemi njoftuar edhe faktorët ndërkombëtarë, kemi kërkuar edhe nga Brukseli që ata të bëjnë presion, në mënyrë që zoti Thaçi të kthehet në Kosovë dhe do të vazhdojmë që t'i bëjmë këto veprime dhe këto punë.

Mirëpo, po ashtu dëshiroj të theksoj se ne po ballafaqohemi me një situatë mjaft të pavolitshme, sepse Serbia në vazhdimësi po i freskon dhe po i zgjeron listat e njerëzve tanë për të cilët kërkon që të bëhet arrestimi i tyre nga Interpoli dhe organet tjera dhe meqenëse ne si shtet nuk kemi

qasje në të dhënat e Interpolit, sepse nuk jemi anëtar të Interpolit, as Europolit, ne pastaj nuk kemi informata se cilët qytetarë të Republikës së Kosovës janë të rrezikuar nga listët e tilla dhe nga veprimet e tilla.

Ne kemi kërkuar në Bruksel që të parandalohen këto lista, që Serbia të heqë dorë nga akuzat që i bën ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, ose që ne të njoftohemi nga organet ndërkombëtare lidhur me listat për qytetarët tanë, sepse është e vërtetë që kështu ka ndodhur edhe me zotin Haradinaj, kështu mund të ndodhë edhe me personalitete tjera të Kosovës, për arsye se ne nuk kemi qasje dhe për arsye se Serbia po vepron, edhe përkundër asaj që ne po bëjmë përpjekje të normalizimit të marrëdhënieve, po vepron në të kundërtën e këtij normalizimi.

Mirëpo, po ashtu dëshiroj si kryeministër të them para jush se kushtëzimi i lirimit të zotit Nehat Thaçi me procesin e dialogut nuk është në interes të Republikës së Kosovës, është në interes të individëve në Serbi, të cilët veprojnë kështu, sepse ata e kanë iniciuar para nesh këtë çështje dhe po ashtu dëshiroj të ju them se edhe iniciuesit e seancave të tilla të nënshkrimeve do të ishte mirë që t'i njoftojnë deputetët në fillim kur ia japin listën për t'u nënshkruar se cilat janë rezolutat për të cilat ata angazhohen dhe jo që tekstin e rezolutës ta japin këtu, ndërkaq deputetët tanë të nënshkruajnë në blanko.

Ne në Qeveri konsiderojmë se duhet të vazhdojmë me procesin e dialogut, se ne kemi shumë probleme të pazgjidhura me Serbinë, e kemi akoma problemin e veriut pa e zgjidhur, e kemi akoma problemin e proceseve integruese evropiane të cilat na kushtëzohen me vazhdimin e dialogut, e kemi ligjin që e ka aprovuar ky Kuvend me 2/3 e votave për ratifikim të marrëveshjes së parë dhe ka marrë detyrime për vazhdimin e dialogut dhe askund në ligj nuk është theksuar që ne kur të duam e ndërpresim dialogun, kur të na provokojë Serbia për ndërprerje, sepse Serbisë i konvenon, në të vërtetë njerëzve nga Serbia u konvenon kjo punë.

E kemi po ashtu edhe Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim, e cila kushtëzohet me vazhdimin edhe implementimin e dialogut.

Pra, janë procese të cilat ne duhet t'i vazhdojmë në të mirë të Republikës së Kosovës, por ne duhet të kërkojmë nga faktori ndërkombëtar dhe nga institucionet e Serbisë që ato me çdo kusht ta lirojnë zotin Nehat Thaçi, që ai të kthehet në Kosovë dhe për çdo gjë pastaj përgjegjësinë ta marrin institucionet e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim edhe me faktorët ndërkombëtarë, edhe me EULEX-in, i cili është këtu i pranishëm në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër! Tani fjala është për ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, zoti Enver Hoxhaj.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër, kolegë nga Qeveria,

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Po e vazhdoj aty ku e la kryeministri Mustafa. Që nga dita kur zoti Nehat Thaçi është ndaluar dhe fillimisht është ndaluar në pikën kufitare në Konçul, në orën 8:00 të mbrëmjes, më 29 shtator, ne jemi marrë intensivisht si Ministri e Punëve të Jashtme dhe si Qeveri e Kosovës dhe mund të ju them që edhe nëse sot dikush është ndaluar në një vend të caktuar të botës, edhe në rajon dhe na ndodh në baza ditore edhe në rajon, kemi informata, ne merremi intensivisht me raste të tilla.

Dallimi është Qeveria nuk bën deklaratë, por bën përpjekje që t'i ndihmoj rastet e caktuara, të jenë pranë qytetarëve të Kosovës në mënyrë aktive për secilin rast.

Disa raste të cilat u përmendën, që janë arrestuar edhe nga Serbia, por të cilat janë arrestuar edhe nga vendet tjera të rajonit, të cilat do të duhej të ktheheshin në Serbi, edhe nga vendet e Bashkimit Evropian, të cilat do të duhej të dorëzoheshin në Serbi por edhe nga vendet në Evropë që nuk janë anëtarë të Bashkimit Evropian që u përmendë, unë mund ta lexoj një listë të gjatë, kam qenë pjesë dhe jam pjesë e punës sonë në baza ditore, se ne nuk e mbrojmë vetëm interesin shtetëror, por e mbrojmë edhe interesin e çdo qytetari, veç e veç. Mbrojtja e interesit të qytetarit është e barabartë me mbrojtje të interesit shtetëror.

Kur është ndaluar zoti Nehat Thaçi, ne kemi pasur informatë që ai do të lirohet ditën e nesërme. Atë ditë kur Gjykata e Lartë në Nish e ka pranuar, ne kemi pritur që ai do të lirohet ditën e nesërme dhe për ne nga ajo ditë e deri në ditën e sotme e dimë që pretendimet të cilat i ka Serbia, e të cilat janë të motivuara politikisht, absolutisht nuk kanë të bëjnë me zotin Nehat Thaçi.

Po ashtu, shefi i Zyrës sonë atje, ambasadori Valdet Sadiku, ka qenë në kontakt dhe është në kontakt me zotin Thaçi. Unë e kam një informatë edhe para gjysmë ore se si është gjendja edhe fizike, edhe shëndetësore e zotit Thaçi, sikur që kemi marrë në ditën e parë se si është gjendja e tij shëndetësore.

Kur e kemi parë që është vendosur masa e paraburgimit prej 30 ditësh, ne atëherë e kemi kuptuar që arrestimi ka qenë i menduar, arrestimi ka qenë i planifikuar dhe e kemi parë që rasti ka kaluar në një fazë tjetër. Sikurse prej 10 tetorit, kur zoti Thaçi është dërguar nga Gjykata e Lartë në Nish në Prokurori në Beograd, ky rast e ka marrë një dimension tjetër.

Çfarë kem bërë deri më tash?

Nën udhëheqjen e kryeministrit Mustafa kemi pasur disa takime, kemi ndarë punët dhe nuk kemi lënë guri pa lëvizur, aq sa mundur të lëvizim edhe ndërkombëtarisht si shtet i vogël me qëllim që ta lirojmë zotin Thaçi. Edhe zëvendëskryeministri Kuçi, edhe ministri Hyseni, edhe ministrja e Drejtësisë, Hoxha, edhe unë si ministër i Jashtëm kemi pasur koordinim ditor dhe kemi koordinim ditor. Kemi dërguar nota verbale, kemi dërguar shkresa të ndryshme, memorandume të ndryshme, telefonata të ndryshme, dikush e ka ngrehur në Bruksel, dikush edhe në Bruksel edhe përtej Brukselit, kudo që kemi mundur, me qëllim që të lirohet sa më shpejt, sikurse që Zyra jonë e Ndërlidhjes është pranë tij.

Akti i ndalimit dhe akti i arrestimit natyrisht që kanë qenë dhe për ne është i paligjshëm.

Çdo pretendim që ka Serbia nuk qëndron dhe mund të ju them që ai edhe në të kaluarën ka udhëtuar nëpërmjet Serbisë së bashku me familjen e tij, e pse pikërisht tash ndodh arrestimi i tij? Por, çfarë e tha edhe kryeministri Mustafa, Serbia e ka rritur numrin apo e ka aktivizuar një numër të madh të akuzave ndaj qytetarëve të Kosovës, të cilët edhe në rajon, disa prej tyre, edhe kanë mundur të lirohen pa zhurmë, pa dalë në media. Janë ballafaquar me akuza të cilat i ka ngrehur Serbia nga korriku i këtij viti. Natyrisht që ne nuk jemi anëtar të Interpolit dhe nuk e dimë se kush është në këtë listë të akuzave.

Si konkluzion, ne do të merremi intensivisht derisa të lirohet zoti Thaçi. Por, kur flasim për dialogun dhe për këtë ngjarje, natyrisht që ne nuk kemi një dialog për shkak të naivitetit apo mungesës së vizionit. Ne e dimë që Serbia ka ushtruar dhunë politike dhe politikë të dhunshme të planifikuar në raport me Kosovën gjatë një shekulli. Ne e dimë që në të kaluarën e ka parë armik popullin e Kosovës, sot e sheh çdo qytetar të saj dhe shtetin e Kosovës, këtë punë e dimë, nuk është që s'e dimë, ma merr mendja që çdokush e di dhe nuk ka nevojë këtu për dije shumë të thellë gjeopolitike.

Por, çfarë po ndodh muajve të fundit është që Serbia e ka rritur gamën e provokimeve. Kryeministri Vuçiq ka mbajtur gjashtë orë fjalim kur është mandatuar si mandatar dhe programi i tij qeverisës është me një qasje kolonialiste dhe raciste në raport me Kosovën, që për neve si qeveri është e papranueshme dhe do të bëjmë çdo gjë që realisht të ketë program të tij sikurse programet e tjera të bëjmë që të mos zbatohen dhe të dështojnë.

Por, përtej debateve që ne mund t'i kemi në Kuvend dhe ne jemi të gatshëm që të japim llogari para jush. Mua më duhet t'ju them një gjë kështu shumë miqësisht. Ka dallime ndërkombëtarisht mes asaj a promovon një politikë të jashtme si diskurs të fortë gjuhësor, apo ka dallime, a promovon një politikë e cila ka qëllime të matshme dhe parime të caktuara.

Ne në rastin e zotit Thaçi jemi marrë me qëllime të matshme, se si brenda mundësive tona ta lirojmë sa më shpejt. Për diskurs ka vend kur ne secili prej nesh ka mundësi që ta tregojë veten.

Po nuk është që ka pasur heshtje, nuk është që s'jemi marrë me rastin dhe nuk është që s'merremi me raste të ndryshme, të cilat ndodhin në baza ditore, duke e pasur parasysh sot një rast tjetër me të cilën ne merremi si Qeveri e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Zonja ministre e Drejtësisë, Dhurata Hoxha.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: Të nderuar deputetë,

I nderuar baba i zotit Nehat Thaçi,

Nënkolonel Nehat Thaçi është ndaluar nga organet serbe më 29 shtator 2016, në territorin e Serbisë.

Ai është ndaluar mbi bazën e akuzës se ka kryer veprë penale të terrorizimit në korrik të vitit 1999, si dhe në janar 2000 në Lipjan. Akuza daton qysh nga viti 2010, por nuk është komunikuar asnjëherë te organet e Republikës së Kosovës. Menjëherë Ministria për Punë të Jashtme, Ministria për Punë të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë, në bashkërendimin e zyrës së zëvendëskryeministrit të parë dhe në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, janë dakorduar për të dërguar notë formale drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Serbisë me kërkesën për lirimin e menjëhershëm të nënkolonel Thaçit.

Në shkresë është argumentuar se Serbia nuk ka juridiksion mbi veprat penale, kinse të kryera në territorin e Republikës së Kosovës. Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, në vitin 2008, ky juridiksion mbi territorin e Kosovës ushtrohet ekskluzivisht nga organet e Republikës së Kosovës. Nota e dërguar u referohet edhe procedurave të dakorduara ndërmjet Kosovës dhe Serbisë lidhur me bashkëpunimin juridik të datës 7 tetor 2015, ku kemi kërkuar nga Ministria e Drejtësisë së Serbisë që të bartë lëndën e nënkolonel Thaçit te organet e Republikës së Kosovës.

Në rast se ka bazë dhe dëshmi se nënkolonel Thaçi, si shtetas i Republikës së Kosovës, ka kryer ndonjë veprë, atëherë kuptohet organet e Republikës së Kosovës do të fillojnë procedurat përkatëse. Mirëpo, si e tillë kjo kërkesë e Serbisë dhe kjo ndalesë e Serbisë është joligjore. Nota është dërguar nga Ministria e Drejtësisë përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Zyrës ndërlidhëse të Republikës së Kosovës në Beograd.

Kjo është nota e parë që dërgohet drejtpërdrejt përmes kanaleve diplomatike pa kaluar nëpërmjet Zyrës së Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian dhe kjo letër mund t'u bëhet edhe publike edhe juve, nëse kërkohet. Duhet theksuar se Ministria e Drejtësisë, në bashkërendim me Zyrën e zëvendëskryeministrit të parë, është konsultuar edhe me Zyrën e përfaqësuesit special, të cilët kanë refuzuar të përfshihen në komunikimin dypalësh ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këtë rast konkret, pasi që nuk është rast tipik i bashkëpunimit juridik të ndërsjellë, por komunikim i karakterit diplomatik.

Ministria e Punëve të Jashtme ka konfirmuar që nota është dorëzuar në Ministrinë e Drejtësisë më 7 tetor 2016. Por, deri më tani nuk ka ndonjë përgjigje nga pala serbe. Shkresa e Ministrisë së Drejtësisë është dërguar për njoftim edhe te Përfaqësuesi Special, po si e theksoi edhe ministri i Punëve të Jashtme, edhe te të gjithë aktorët dhe partnerët tanë ndërkombëtarë.

Sipas informacioneve të fundit nga Ministria e Punëve të Jashtme, është mbajtur seanca dëgjimore në prokurorinë serbe për krim të organizuar, ku sipas avokatëve të nënkolonel Thaçit janë konstatuar një numër i shkeljeve ligjore lidhur me ndalimin e nënkolonel Thaçit. Ministria e Drejtësisë është në bashkëpunim dhe bashkërendim të vazhdueshëm me Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila ka rolin kryesor në sensibilizimin e faktorit ndërkombëtar për rastin e nënkolonel Thaçit, si dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me Zyrën e zëvendëskryeministrit të Parë dhe Zyrën e Kryeministrit.

Dua të theksoj se Ministria e Drejtësisë në tre muajt e fundit ka ngritur një numër shqetësimesh në drejtim të Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian lidhur me qasjen e Serbisë në kuadër të bashkëpunimit juridik të ndërsjellë. Po ashtu, Ministria e Drejtësisë ka marrë qëndrim parimor se nuk do të ketë bashkëpunim juridik me Serbinë për rastet kur Serbia ka filluar procedura penale kundër shtetasve të Republikës së Kosovës për vepra penale kinse të kryera në territorin e Kosovës.

Ministria e Drejtësisë, po ashtu, kundërshton çdo formë tjetër të juridiksionit të Serbisë, përfshirë mbi bazën e parimit të juridiksionit universal, ku akuzohen shtetas të Republikës së Kosovës për vepra të kryera në Kosovë. Çdo kërkesë e Serbisë për bashkëpunim në këtë drejtim është refuzuar nga Ministria e Drejtësisë dhe do të refuzohet edhe në të ardhmen.

Po ashtu, kemi marrë qëndrim parimor se do të kërkojmë ekstradimin e çdo shtetasi të Republikës së Kosovës, i cili ndalohet nga një shtet tjetër mbi bazën e akuzave të ngritura të Serbisë për vepra penale të kryera në Kosovë dhe ekstradimin i të cilit kërkohet nga Serbia.

Pra, si Ministri e Drejtësisë do të bëjmë gjithçka që është e mundur për të evituar ekstradimin e një shtetasi të Republikës së Kosovës për në Serbi dhe do të ndërmarrim të gjitha veprimet e nevojshme, në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit dhe Policinë e Kosovës, që shtetasi i Republikës së Kosovës të gjykohet vetëm në Kosovë për vepra të kryera në Kosovë, nëse, kuptohet, për këtë ka dëshmi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri i Brendshëm, Skënder Hyseni, e ka fjalën.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues,
Të nderuar deputetë,
I nderuar zoti Rrahim Thaçi, baba i Nehat Thaçit,

Zoti kryeministër,
Të nderuar ministra,

U thanë po thuaj të gjitha ato që do të mund të thuheshin edhe nga kryeministri, edhe nga ministri Hoxhaj dhe ministrja Sadiku. Arrestimi i zotit Nehat Thaçi është absolutisht i papranueshëm dhe preteksti është inekzistent. Duke u përpjekur që të mos përsëris asnjë nga ato që tashmë u thanë, do të provoj të adresoj disa nga shqetësimet që u ngritën.

U tha se që nga dita e arrestimit ka pasur heshtje të plotë, por e them me përgjegjësi që nga momenti i arrestimit është vënë në lëvizje ky grup i përbërë nga zëvendëskryeministri Kuçi, ministri Hoxhaj, ministrja Sadiku dhe ministri i Brendshëm, në prani të kryeministrit Mustafa. Dhe janë bërë veprime të duhura dhe koordinime të duhura që zotit Nehat Thaçi t'i mundësohet lirimi sa më i shpejtë dhe zotit Nehat Thaçi të mos i vështirësohet gjendja edhe ashtu e vështirë në paraburgim në Serbi.

Ne kemi aplikuar për Interpol dhe shpresojmë shpejt se do të ndodhë anëtarësimi, ndërkohë që u përmend Europoli, dua t'i njoftoj edhe deputetët edhe qytetarët se nuk mund të ketë anëtarësim në Europol gjithnjë përderisa Kosova nuk është anëtare e Bashkimit Evropian. Ishte një pyetje specifike, nëse ministri i Brendshëm ka qenë i njoftuar se zoti Thaçi do të udhëtojë nëpër Serbi. Përgjigja është "jo" dhe më lejoni që ta specifikoj përgjigjen më tej.

Zoti Thaçi në kohën ku ka udhëtuar ka qenë në pushim të aprovuar nga eprorët e tij të Policisë së Kosovës dhe po e citoj raportin e Policisë së Kosovës, po citoj po ashtu pjesë nga raporti i Policisë së Kosovës: "Vendimi i Nehat Thaçit për të udhëtuar përmes Serbisë nuk është diskutuar me eprorët përgjegjës të Policisë së Kosovës". Këtë po e them vetëm për hir të sqarimit edhe të deputetëve, edhe opinionit të gjerë.

Ndërkohë që dua të theksoj po ashtu që Kosova është shtet demokratik dhe në kohën e tyre të lirë shteti nuk përzihet se ku dhe çfarë udhëtimesh bëjnë qytetarët e saj. Ndërkohë që si mësim i nxjerrë nga kjo, ky rast shumë i keq dhe i papranueshëm, Policia e Kosovës menjëherë të nesërmen ka nxjerrë udhëzim të veçantë për pjesëtarët e Policisë së Kosovës që të mos përdorin rrugë përmes territorit të Serbisë për të shkuar në Perëndim.

U tha këtu pak më herët nga ministri Hoxhaj që sipas njoftimeve që kemi marrë nga ambasadori Sadiku dhe sipas informacioneve që kanë dalë gjatë seancës dëgjimore në Gjykatën e Serbisë dhe sipas deklaratës së avokatit, zoti Nehat Thaçi ka udhëtuar edhe më parë nëpër territorin e Republikës së Serbisë, mirëpo nuk ka ndodhur asnjëherë arrestimi dhe ministri Hoxhaj me të drejtë e shtroi dilemën dhe pyetjen pse mu tash. Pse mu në këtë kohë? Dhe kësaj pyetje duhet t'i japim përgjigje të pjekur, ashtu siç e ka dhënë Qeveria e Kosovës gjatë ditëve të kaluar.

Çdo ditë në koordinim të plotë me kryeministrin, zëvendëskryeministrin dhe tre ministra dhe me ambasadorin tonë në Beograd, në mënyrë që Nehat Thaçi ta kthejmë në Kosovë të familja sa më shpejt dhe jemi përkujdesur dhe do të vazhdojmë të përkujdesemi që me asnjë deklaram publik të mos ia vështirësojmë situatën, gjendjen edhe ashtu të rëndë zotit Nehat Thaçi në burgjet e Serbisë dhe para gjykatës serbe.

Nuk do të rrezikojmë të deklarojmë ne diçka që shkon ndesh në deklaramet që mund t'i bëjë atje vetë zoti Thaçi. Prandaj, këtë pikë unë do të kërkoja mirëkuptimin tuaj me qëllim që t'i ndihmojmë Nehat Thaçit, e jo ta ngarkojmë edhe më shumë gjendjen e tij, edhe ashtu të rëndë në burgjet e Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Fjalëne ka Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Më lejoni që fillimisht të shpreh edhe unë indinjatën e thellë lidhur me arrestimin arbitrar dhe të kundërligjshëm nga ana e autoriteteve serbe të nënkolonelit Nehat Thaçi. Mendoj që është tërësisht e papranueshme mënyra dhe forma se si autoritetet serbe për interesa krejtësisht politike të ngritin tensione dhe të minojnë procesin e dialogimit dhe të përmirësimit të raporteve ndër fqinjësore ndërmjet dy shteteve.

Është po ashtu padrejtësi dhe krejtësisht e pamoralshme dhe në kundërshtim me të gjitha normat ndërkombëtare që qytetarët e Republikës së Kosovës të persekutohen dhe të ndiqen penalisht për veprat që, në fakt, zyrtarët serbë duhet të përgjigjeshin për veprat e tyre barbare dhe çnjerëzore që kanë kryer gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Zoti Nehat Thaçi po ndiqet duke u bazuar në një deklaratë krejt të pavërtetë, të fabrikuar dhe pa asnjë provë të vetme me nga një kallëzim penal i një individi pesë vjet pasi ka mbaruar lufta në Kosovë.

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Që 16 vjet pasluftës ne ende kemi plagë të hapura, kemi ende shumë të pagjetur dhe ende nuk dihet fati i tyre. Kemi shumë nëna e gra të dhunuara, për të cilat ende kriminelët serbë nuk janë dënuar. Këto janë krime të vërteta dhe janë fakte të pamohuara, të cilat i kanë kryer ata që sot po thirrën për vendosje të drejtësisë duke fabrikuar akuza tërësisht të pabaza dhe të pavërteta.

Në fakt, kjo që sot ata po pretendojnë nuk ka të bëjë aspak me drejtësi, por tendenca e tyre është që të barazohet krimi me viktimën, agresori me të pushtuarin dhe gjithashtu, tendencë për të shmangu vëmendjen nga procesi i dialogimit, prej të cilit Kosova për çdo ditë e më shumë po shënon përparim dhe po e rikthen të drejtën e saj në ekonomi, në energjetikë, në telekomunikim dhe në të gjitha këto asete shtetërore që Serbia padrejtësisht i ka plaçkitur dhe po i mban me forcë pezull, duke vazhduar përpjekjet që me politikat që i takojnë të kaluarës të vënë në pikëpyetje përpjekjet e Republikës së Kosovës dhe të bashkësisë ndërkombëtare për të promovuar paqen dhe për të promovuar stabilitetin në rajon.

Të nderuar kolegë deputetë,

Këtë javë një pjesë e kolegëve të mi deputetë dhe deputete, si dhe përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë qenë të ftuar që të marrin pjesë në Forumin e gjashtë për Siguri në Beograd, ku do të ishim pjesë e panelit për të promovuar sigurinë dhe paqen në rajon, mirëpo në këtë rast të gjithë kolegët e mi në mënyrë unanime kanë refuzuar pjesëmarrjen në këtë panel, duke dëshmuar edhe njëherë që kur janë në pyetje interesat shtetërore dhe nacionale, ne gjithmonë do të jemi një dhe në këtë mënyrë i kemi dhënë një përgjigje Serbisë, që ajo po vazhdon të jetë faktor destabiliteti në rajon dhe ka qenë vetëm një mesazh i vogël, por mjaft domethënës se me këto veprime të zyrtarëve shtetërorë edhe ai bashkëpunim fragjil që deri tani ka arritur të bëhet po vihet në rrezik në të gjitha fushat e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Po ashtu, u tha edhe nga ministri i Jashtëm dhe ministrja e Drejtësisë, unë dua që të potencoj edhe angazhimin e madh të institucioneve të vendit që kanë ndërmarrë masat, përmes të cilave është kërkuar lirimi i menjëhershëm i zotit Thaçi dhe kthimi i tij në Kosovë. Ne kemi qenë si anëtarë të Komisionit për Politikë të Jashtme në konsulta të përhershme me ministrin e Jashtëm, po ashtu edhe me ambasadorin tonë, me zotin Valdet Sadiku, i cili ka bërë një punë të shkëlqyer në këtë rast. Ka pasur takim dhe koordinim të gjithë aktorëve në mënyrë që të sigurohet që zoti Thaçi të kthehet në Kosovë.

Komisioni për Politikë të Jashtme para disa ditësh ka mbajtur një takim dhe unanimisht si anëtarë të komisionit kemi lëshuar një deklaratë, duke kërkuar lirimin e menjëhershëm të zotit Thaçi dhe duke kërkuar nga faktori ndërkombëtar që të bëjë presionin e tij për lirimin e tij. Po ashtu, unë shfrytëzoj rastin që nga ky Kuvend të ftoj autoritetet e Serbisë që menjëherë dhe pa asnjë kusht të lirojnë qytetarin dhe zyrtarin e Republikës së Kosovës, zotin Nehat Thaçi, në mënyrë që ai t'i kthehet familjes dhe detyrës që e pret. Por, gjithashtu ftoj partnerët ndërkombëtarë, sidomos Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që të bëjnë presion ndaj autoriteteve serbe, që të bëjnë lirimin e menjëhershëm të zotit Thaçi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues,

I nderuar zoti kryeministër,

Ministra, kolegë deputetë,

Unë fillimisht do të shërbehem me një shembull që ka të bëjë me luftën në mes të Britanisë së Madhe dhe Argjentinës për ujdhesat e Folklandit, në pranverën e vitit 1982.

Për të thënë shumica e analistëve politikë ushtarakë e konsiderojnë si një ndër luftërat më profesionale në historinë e njerëzimit. Lufta ishte çështje e dy ushtrive nacionale, pa ndikime të drejtpërdrejta në sigurinë dhe jetën e qytetarëve civilë. Trajtimi i robërve të luftës ishte korrekt dhe sipas konventave ndërkombëtare, po ashtu nuk u përdorën mjete dhe masa të ndaluar me konventa ndërkombëtare.

Kjo qasje profesionale u mundësoi të dy qeverive që shumë shpejt t'i ripërtërijnë marrëdhëniet diplomatike. Kurse sot, delegacionet e dy ushtrive së bashku bëjnë homazhe në vendet ku humbën jetën mbi 900 ushtarë dhe gjithsej 3 civilë. Tek ne është një realitet tjetër, dhe pas 17 vjetëve plagët e luftës janë ende të freskëta. Në Kosovë, në periudhën '98-'99, ndodhën shumë vrasje të civilëve, dëbime të popullatës, dhunime, djegie, plaçkitje dhe shkatërime të vendbanimeve dhe ekonomive, ekzekutime të robërve të luftës, e tjera.

Me një fjalë, Serbia në Kosovë ushtroi terrorizëm shtetëror dhe krime të panumërta të luftës. Kërkim-falja për tërë atë urrejtje ndaj shqiptarëve dhe gjenocid ndaj tyre nuk u dëgjua kurrë nga autoritetet e Serbisë dhe as që mendohet të bëhet, sado që të njëjtit liderë serbë, përgjegjës për krime në atë kohë, sot e luajnë rolin e të moderuarit.

Sidoqoftë, ne nuk kemi forcë që ata t'i bindim që ishin okupues, terrorizues dhe në fund humbës. Por, ne kemi forcë që të jetojmë me dinjitet, në qoftë se si komb dhe si shtet reagojmë me racionalitet, fakte dhe argumente kundrejt të gjitha situatave provokuese të nisura nga Beogradi. Ne nuk duhet të heshtim në mbrojtje të të gjithë qytetarëve që u vunë në shërbim të luftës çlirimtare, e që të gjithë në sytë e Serbisë janë terroristë. Ne nuk bën të heshtim kur policët tanë në detyrë apo punë private tërhiqen zvarrë dhe arrestohen duke i paraqitur si terroristë dhe kriminelë.

Në këto situata sprovohen qëndrueshmëria dhe serioziteti i institucioneve të Kosovës për të mbrojtur qytetarët e vet kudo që ata janë, brenda apo jashtë Kosovës. Po të njëjtat institucione, e posaçërisht ato të drejtësisë, duhet të punojnë që t'i sjellin të gjithë kriminelët e luftës para organeve të drejtësisë. Derisa qytetarët tanë arrestohen brenda Kosovës dhe jashtë saj, me urdhër arrest të Serbisë, kriminelët e Serbisë pa asnjë problem mund të hyjnë dhe të dalin nga Kosova.

Është koha e fundit që bota të kuptojë drejtë fizionominë e krimeve të bëra në Kosovë. Por, në qoftë se ne heshtim dhe nuk veprojmë, atëherë do të jemi vetë fajtorë për mohimin e historisë, kurse mohimi i historisë do të thotë mungesë e kulturës së shtetndërtimit. Uroj që rezoluta e

miratuar në Parlament në përgjithësi do të ngritë nivelin e përgjegjësisë të të gjitha institucioneve të Kosovës, e në veçanti task forcës së Qeverisë për çështjen e Nehat Thaçit t'i mundësojë veprime racionale. Kurse, qytetarët do të jenë mirënjohës për veprimet e shtetit në mbrojtje të qytetarëve të saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Në fakt, nuk është hera e parë që ne kemi kërkuar që Qeveria të japë sqarime se çfarë po ndodh me oficerin e Policisë, nënkolonel Thaçin, e njëkohësisht edhe me veteranin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për kohën përderisa ai ndodhet në duart e një policie armike. Nuk është thjesht një polici e Evropës, e cila ka ndaluar për një vepër të caktuar.

Po ashtu, edhe nuk është hera parë që nga e njëjta polici dhe nga i njëjti shtet kemi të arrestuar edhe qytetarë të Republikës së Kosovës, e në mesin e tyre edhe zyrtarë të policisë. Nuk do të duhej të ishte, të konsiderohet e njëjtë siç u tha këtu rasti edhe me fletë arrestet ndërkombëtare që Serbia ka deponuar në Interpol dhe disa prej shteteve nganjëherë herë pas herë edhe i kanë zbatuar ato, siç është rasti i arrestimit apo ndaljes së ish-kryeministrave tonë, njëri prej tyre është edhe këtu deputetë tani, por nuk është e njëjtë, sepse këta nuk ishin fajtorë që Serbia i kërkonte. Pra, këta u arrestuan ose u ndaluan në Slloveni, Hungari e Bullgari, varësisht prej rasteve veç e veç.

Normalisht, dorën në zemër nuk kemi se si të mos e bëjmë një pyetje se pse u ndodh zoti Nehat Thaçi atje, jo që ta bëjmë përgjegjës, por nuk do të duhej të ndodhte kështu, në radhë të parë. Edhe aq më tepër kur dihet që Serbia po vazhdon akoma të jetë e njëjta sikur atëherë kur Nehat Thaçi ka qenë ushtar dhe ka luftuar kundër saj sikur në kohën e Milosheviqit.

Serbia nuk ka ndryshuar, edhe pse ne do të donim ta ndryshonim. E aq më tepër kur po del që paska qenë pamjaftueshëm i informuar ose i painformuar lidhur me faktin që kërkohet apo nuk kërkohet nga Serbia. Dorën në zemër, unë kurrë duke qenë veteran i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk do t'i besoja Serbisë edhe sikur ta realizonte amnistinë e përgjithshme tani. Pra, edhe në rastin e kundërt nuk do të duhej t'i besoj Serbisë, pa le më kur një gjë të tillë nuk e ka bërë asnjëherë.

Nuk është, thashë, hera e parë, për shkak se ka ndodhur edhe arrestimi i dy policëve në rrethana krejt të tjera, për arsye krejt të tjera, në fshatin Dumnicë të Besianës. Unë sinqerisht pres që shpejt të kthehet Nehat Thaçi në Kosovë, por kurrë nuk do të doja që ta bëjë të njëjtën gjë Nehat Thaçi siç kanë bërë dy policët, të cilët nuk më kujtohen emrat, kur janë kthyer nga Serbia me rastin e lirit të tyre. Nëse ju kujtohet, ata në vend që të shprehin reagimin e tyre dhe kundërshtimin e tyre për atë çfarë ka ndodhur, u deklarorin që kanë kaluar mirë atje. Pres që të

mos e thotë një gjë të tillë Nehat Thaçi kur të kthehet dhe ta pasqyrojë realitetin çfarë ka ndodhur atje.

Por, ndonëse kjo situatë ndoshta në pamje të parë mund të duket edhe sikur e vonuar, për këtë seancë po flas, ose sikur nuk mund ta zgjidhë situatën, ka një zgjidhje, vërtet ka një zgjidhje, nëse doni e keni këtu. Zgjidhja quhet “reciprocitet”, në çdo fushë, edhe në fushën e ekonomisë, edhe në fushën e sigurisë, edhe në rrafshin diplomatik, e politik e për çka do Serbia. Pra, thjesht reciprocitet. Madje, në ditët aktuale kemi një rast shumë të mirë. Është një zyrtar i Qeverisë së Serbisë, i cili po vazhdon në vazhdimësi ta sfidojë Republikën e Kosovës, Policinë e Kosovës, ligjet e Kosovës, Kushtetutën e saj, quhet Marko Gjuriq, arrestojeni.

Fillojeni këtu reciprocitetin, arrestojeni një njeri i cili po shkel Kushtetutën, ligjet dhe po sfidon Policinë e Kosovës, duke e deklaruar që Policia e Kosovës nuk mund ta arrestojë atë edhe kur ai vjen në Kosovë pa leje. Po ashtu, ky do të ishte hapi i parë dhe fillimi më i mirë i normalizimit të raporteve me Serbinë. Thirrësi i kësaj seance ndoshta po kërkon që ta kushtëzojë Qeveria e Kosovës Qeverinë e Serbisë me bisedime. Ka 13 ditë që nuk i dëgjohet zëri Qeverisë së Kosovës sa e përmendi kushtëzimin për bisedime, të gjithë vluan. Këtu reagojnë menjëherë, sa thatë që t’i kushtëzojnë bisedimet, kjo ishte një reagim spontan këtu në sallë.

Pra, që 13 ditë heshtën, sa u përmend ndalja e bisedimeve, këta reagues. Por, të mos harrojmë, një shtet i cili nuk mund të arrestojë një shtetas të huaj që vjen në Kosovë dhe e shkel Kushtetutën e këtij vendi nuk mund ta lirojë qytetarin e vet jashtë territorit të këtij vendi. Harrojeni! Një shtet i cili nuk mund ta ndalë asnjë kamion që futet nga Serbia në Kosovë, kërkojmë ne që këta ta lirojnë Nehat Thaçin nga paraburgimi.

Pra, duket që nënkoloneli i policisë ka bërë një gabim kur u ka besuar Edita Tahirit e Hashim Thaçit, kur thoshin që i kemi marrëdhëniet e mira me Serbinë. Ky është demanti më i madh, pra arrestimi i tij, fatkeqësia e tij, është demanti më i madh i qeveritarëve të Kosovës. Në fund, edhe ne shprehim keqardhjen tonë që nënkolonel Thaçi është i arrestuar dhe gjendet në pozita të vështira në dhomat e paraburgimit.

Ne kemi kujtesën e freskët, shumë prej deputetëve po i shoh këtu, të cilat në rrethana të tjera dhe më të vështira kanë qenë robër lufte, të arrestuar atje. Këta e dinë më së miri se si kalohet në duart e një policie armike. Shpresoj që tashmë zoti Nehat Thaçi të ketë mundësinë e parë që të kthehet në Kosovë, e pas kthimit të tij në Kosovë, normalisht që Qeveria e Kosovës duhet të japë përgjegjësi përse nuk e ka informuar vartësin e vet që është i rrezikuar në Qeverinë e Serbisë.

Ministri i Brendshëm e përmendi një fakt që këta nuk kanë qenë të njoftuar, por të mos harrojmë se ekziston një protokoll i brendshëm kur çdo oficer policie, e aq më tepër një oficer i lartë, siç është një nënkolonel, i cili ka një përgjegjësi të caktuar, duhet ta informojë njësinë e vet,

komandën, për kohën e daljes nga shteti, për destinacionin dhe për vendkalimin. Nëse nuk ka bërë një gjë të tillë, duhet ta bëjnë të tjerët, e atëherë më tepër kur bëhet fjalë për kalim në Republikën e Serbisë, i cili shtet po vazhdon të sillet njëjtë ndaj shqiptarëve të Kosovës, ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës siç është sjellë dikur paraardhësi i tij, Milosheviqi.

Prandaj, sot e kemi rastin që të tregojmë që jemi shtet, të tregojmë reciprocitet edhe në fushën e sigurisë me Serbinë.

KRYESUESI: Fjalën e ka Bali Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesues,
Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,
Arrestimi i një zyrtari të lartë të Policisë së Kosovës nga shteti fqinj, Serbia, është ilustrim më i freskët i ashtuquajtur normalizim i marrëdhënies në mes të dy vendeve.

Dhjetëra fletë arreste të lëshuara nga autoritetet serbe dhe Interpoli janë në qarkullim, ku të kërkuarit janë shqiptarët e Kosovës, qytetarë të zakonshëm, e deri te personalitetet e njohura për publikun. Drejtori Rajonal i Policisë së Kosovës, për rajonin e Mitrovicës, Nehat Thaçi, është dërguar të martën nga burgu u Nishit në Beograd, ku është marrë në pyetje në Gjykatën Speciale 15 ditë pas arrestimit të tij.

Zyrtari i Republikës së Kosovës, Nehat Thaçi, është burgosur padrejtësisht më 29 shtator 2016, në vendkalimin kufitar në Konçul dhe me vendimin e një gjykate të lartë të Nishit iu shqiptua masa e paraburgimit.

Arrestimi i Thaçit u bë mbi bazën e një fletë arresti të lëshuar nga organet serbe, por siç thuhet, kryerjen e një vepre penale të terrorizmit, akuzë që zakonisht rëndon mbi shqiptarët që kërkohet prej organeve gjyqësore të Serbisë. Përveç disa deklaratave të mediave, Qeveria e Kosovës nuk arriti të bëjë asgjë që t'i dalë në ndihmë Nehat Thaçit. Në fakt, kjo qeveri është në gjendje të dëmtojë qytetarët me neglizhencën e saj, por asesi t'u vijë në ndihmë.

Edhe pse ministrja për Dialog shumicën e netëve e bën në Bruksel, duke negociuar fortë me palën serbe, bashkë me anëtarët e tjerë të delegacionit kosovar, çështja e fletë arresteve nuk është diskutuar asnjëherë dhe si rrjedhojë, nuk ka asnjë zgjidhje që shtetasit tanë të mos pësojnë sapa të kalojnë kufirin e të burgosen.

Ministria e Punëve të Brendshme ka dështuar sado që adresojë këtë çështje shumë shqetësuese, megjithëse ka pas mundësi ta bëjë një gjë të tillë. Ministria e Drejtësisë nuk ka lidhje me këto ngjarje, edhe pse do të duhej të ishin të informuar dhe aktive për adresimin e kësaj problematike.

Qeveria jonë mburret se nuk e paska lejuar një vizitë të ndonjë zyrtari serb, por e mbyll gojën kur zyrtarët kosovarë prangosen sapo të kalojnë kufirin me Serbinë.

Kosova nuk e meriton këtë trajtim dhe këtë kokulje qeveritare për shkak të pushtetarëve të papërgjegjshëm, të cilët nuk mërzhiten shumë për bashkëqytetarët e tyre. Kuvendi si institucion më i lartë legjislativ dhe përfaqësues i vullnetit të popullit duhet të detyrojë qeveritë që dialogun ta kushtëzojnë me zgjedhjen e njëherë e mirë të çështjes së fletë arresteve të padrejta për qytetarët e Kosovës.

Bisedimet në Bruksel do të duhej të pezulloheshin, duke kërkuar lirim të menjëhershëm të zyrtarit të Policisë, Nehat Thaçin. Kosova nuk duhet të vazhdojë dialogun me Serbinë nëse kjo e fundit nuk i shfuqizon të gjitha fletë arrestet absurde për terrorizëm të shqiptarëve. Kuvendi ka fuqi përmes votës të nxjerrë një rezolutë, ku obligon Qeverinë të bëhet më e dinjitetshme dhe më e përgjegjshme në mbrojtjen jo vetëm të zyrtarëve, por të secilit qytetar të Republikës së Kosovës.

Unë ftoj grupet parlamentare që të harmonizojnë qëndrimet dhe të dalin si Kuvend etnik që Nehat Thaçi të lirohet menjëherë dhe raste të tilla të mos përsëriten, sepse kështu nuk mund të ketë fqinjësi të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Së pari, të nderuar deputetë, dijeni që 20 vetë ende nuk kanë folur. Kurrkush s'ju thotë flitni kaq, se ju e dini sa keni të drejtë me Rregulloren, por janë kaq.

E dyta, unë jam duke u përpjekur të distribuoj në bazë të partive dhe tash mos merrni turr, se unë po përpiqem një nga një, rend t'u jap fjalën se s'ka mundësi ndryshe, ose i lexoj rend, qysh të doni ju.

E ka fjalën Haxhi Shala, "Nisma".

HAXHI SHALA: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar Qeveri,

Nuk është hera e parë që qytetarët e Republikës së Kosovës arrestohen, maltretohen, plaçkiten nga shteti serb, por tash pyes ministrin e rendit se çka po ndodh me eprorin e Policisë së Kosovës, ku sot momentalisht edhe mbahet kjo seancë për këtë epror. Kur deri më sot vetëm një informatë e kemi, edhe atë nga mediat elektronike se është arrestuar Nehat Thaçi.

Nuk kemi pasur asnjë informatë as nga kryeministri, as nga ministrat, as nga drejtori i Policisë së Kosovës. Po të kishim informata, ndoshta nuk do të kishte nevojë të mbajmë sot këtë seancë të jashtëzakonshme lidhur me arrestimin e Nehat Thaçit. Nuk është vetëm Nehat Thaçi sot në

burgjet e Serbisë, ndoshta Qeveria nuk e di për qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse nuk i ka listat. Ai nuk i pati listat as për personat e pagjetur, kur dje deklaroi ministrja për Dialog, Edita Tahiri.

A po e shihni, zoti kryeministër dhe ju qytetarë të Republikës së Kosovës, pa fije turpit ministrat tanë nuk dinë për qytetarët e vet, asnjë informate për arrestimet e tyre që bëhen nga pushteti serb. Po ashtu këta ministra nuk kanë informata as lidhur me listat që posedon shteti serb të dërguara në Interpol, kuçdo ditë arrestohen qytetarët, e në veçanti pjesëtarët e UÇK-së nga të gjitha vendet.

E aq më keq me të vetmen aktakuzë, terrorizëm për krime lufte, dhe asnjëherë delegacioni ynë, i cili na përfaqëson në bisedimet me Serbinë në Bruksel nuk e ka ngritur këtë çështje. Ndoshta e ka ngritur, por opinioni dhe ne nuk kemi informata. E, aq më keq kur sot edhe ministri Punëve të Jashtme deklaroi se kemi dërguar shkresa, por nuk kemi informata të sakta. Me të vërtetë, a kanë dërguar shkresa a nuk kanë dërguar? Po të kishin dërguar shkresa nuk do të arrestoheshin njerëzit nëpër kufij të shteteve të ndryshme.

Çka po ndodh me institucionet tona? Tashmë ka dalë në pah atë që ne e kemi thënë më shumë se dy vjet, duke filluar nga kryeministri dhe Kabineti i tij nuk dinë asgjë dhe heshtin para shume gabimeve të njëpasnjëshme të bëra nga vetë ata.

E, pasojat e gabimeve tuaja, kryeministër e ministra, po i bartin qytetarët e republikës sonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

E nderuar familje e zotit Nehat Thaçi,

Edhe tani 17 vjet pas luftës, Serbia po vazhdon të zbatojë urdhërarrestet e Kasapit të Ballkanit, të cilat i bëri mbi baza etnike. Një Serbi që pretendon të hyjë në Evropë nuk do të duhej të vazhdonte me politika fashiste ndaj një fqinji të saj, por të distancohej nga ajo periudhë kohore, e cila në radhë të parë e dëmtoi vetë Serbinë, kurse fqinjëve të saj u solli dhimbje e plagë.

Një Serbi që pretendon të hyjë në Evropë, do të ndërpriste zbatimin e politikës së Milosheviqit, por deri më sot, për fat të keq, nuk kemi të bëjmë me një Serbi të tillë. Serbia edhe sot, nuk lë gur pa lëvizur për të penguar dhe për të shantazhuar fqinjët e saj, e në

fokus të veçantë Republikën e Kosovës. Jo vetëm në territorin e Serbisë, por edhe nëpër shtetet e tjera evropiane.

Qytetarët e vendit tonë, më saktë shqiptarët, po maltreohen me arrestime, të cilat rrjedhin nga një regjim fashist serb. Prandaj, do të duhet të punohet në këtë drejtim që këto fletë arreste njëherë e përgjithmonë të hidhen poshtë, në raste të veçanta duhet të lajmërohen autoritetet e Republikës së Kosovës dhe t'i trajtojnë, por nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë që shqiptarët e Kosovës të kidnapohen nga sistemi serb dhe të nxirren para gjyqeve false serbe, duke rrezikuar dënime vetëm për faktin pse ata janë shqiptarë.

Këtu janë të thirrura të veprojnë organet përkatëse të vendit tonë, edhe ne si popull duhet të jemi më të vendosur dhe të mos lejojmë të na shkelin në qafë kujt t'i tekët dhe sa herë t'ia ka qejfi.

Kjo seancë është një veprim i duhur, por ndoshta do të ishte mirë që të ketë edhe një seancë tjetër për një rast në të cilin po shkelen të drejtat e njeriut brenda kufijve të Republikës së Kosovës. Ne, si Parlament votuam disa herë për të vazhduar mandatin e EULEX-it, por ne si Parlament e kemi ulur kokën dhe kemi mbyllur sytë për çdo gjë që ka të bëjë me këtë mision. Më sulmoni ndoshta pas këtij fjalimi dhe më akuzoni se po ndërhyj në çështjet e gjyqësorit, por po ju them një fakt: unë nuk kam forcë të ndikoj në këtë gjyqësor. Unë kam forcë vetëm të shpreh indinjatën time dhe të ftoj të gjithë kolegët e mi që të ngritin zërin për padrejtësitë që po bëhen nëpër gjykatat e Kosovës nga gjyqtarë, të cilët në vendin tonë po sillen si mbretër.

Ne e kemi “Grupin e Drenicës” në burg, i cili më shumë se një vit po pret të trajtohet çështja e tyre në Gjykatën e Apelit. Terminet shtyhen sikur të jemi në ndonjë film të keq, kurse në anën tjetër, për dikë në veri të Mitrovicës terminet mbahen me saktësi të një ore zvicerane. Ne heshtim si deputetë dhe si popull. Kjo nuk është sjellje evropiane, kjo është sjellje nënshtruese, sepse asnjë popull evropian këto veprime që po bëhen në rastin e këtij grupi nuk do t'i toleronte.

Duhet ta ngremë zërin dhe në rast se ne jemi të pafuqishëm, t'u drejtohen të gjitha organizatave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që të vijnë dhe të shohin drejtësinë që po bëhet në Kosovë. Përdërisa ne lejojmë këto veprime, neve do na arrestohen dhe maltreohen qytetarët tanë kudo, sepse ne brenda kufijve nuk jemi të gatshëm të garantojmë tretman si duhet, atëherë si mund të kërkojmë nga një shtet si Serbia, e cila vazhdon me përrallat e saj të Mesjetës që të na trajtojë si duhet?

Ne duhet t'i ngremë këto çështje në çdo “tavinë evropiane”. Asnjë delegacion i këtij vendi nuk ka të drejtë të shkojë në zyrat e Evropës dhe të luajë rolin e dëgjuesit dhe të pohuesit.

Kanë kaluar kaq vjet nga përfundimi i luftë, ne pamë në Kosovë dashamirë e dashakeqës, prandaj ka ardhur koha që të flasim edhe ne, sepse askush më mirë se ne vetë nuk e njeh këtë vend, nuk ia njeh të mirat dhe dobësitë. Ne jemi ata që e bëjmë apo e katandisim vendin tonë.

Prandaj, në fund fare, të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
E nderuar familje e zotit Nehat Thaçi,
Urojmë dhe shpresojmë që shumë shpejt Nehat Thaçi t'i kthehet familjes, t'i kthehet vendit të punës dhe uroj që ky të jetë rasti i fundit që ne të mblidhemi në seanca tilla për të trajtuar çështje të tilla kaq të rëndësishme. Faleminderit!

KRYESUESI: ShaipMuja, deputet pa grup.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë jam deputet i Partisë Demokratike, për që s'koordinohemi, është çështje interne imja se si komentoj me partinë, prandaj e respektojmë radhën edhe të deputetëve.
Ata që paraqiten në emër të grupeve marrin fjalën...

KRYESUESI: Është çështje e perceptimit tënd, në dokument, ty të shkruan pa grup.

SHAIP MUJA: Burgosja e Nehat Thaçit ishte e planifikuar mirë nga Serbia, mendoj që planin për të arrestuar Nehat Thaçin në Serbi duhet parë në disa pista, të cilat janë ngritur me plan dhe duhet të kërkohet arsyeja pse u bë ky arrestim i qëllimtë.

Së pari, është shumë interesant të konkludohet se vetë Nehat Thaçi në vetvete ka ditur se nuk bart asnjë krim në shpirtin e tij dhe s'ka asnjë krim që mund ta kufizojë askund të lëvizë lirshëm. E në këtë rast, edhe në Serbi, dhe për atë arsye dhe ka vendosur të lëvizë nëpër Serbi, sepse s'ka besuar se do të jetë i ekspozuar trillimeve të tilla.

Së dyti, Serbia duhet ta ketë pasur edhe informimin se ai po lëviz në territorin e vet përmes infiltrimeve që ka në sistemin policor e inteligjent të Kosovës. Por, pa dashur të analizojmë shkaqet pse Nehat Thaçi lëvizjen në territorin e Serbisë për të shkuar në Zvicër në planin personal të tij, duhet parë qëllimet e Serbisë pse arreston atë? Besoj dhe kështu do të jetë, sepse komandimi i vendosur i Nehat Thaçit si komandant në zonën e Mitrovicës ka një mesazh që për Serbinë s'ka qenë edhe i favorshëm, sepse nga ardhja e tij në komandim në Mitrovicë kanë ndodhur ndryshime cilësore, sasiore e statistikore.

Sa i përket parandalimit të krimit të organizuar në regjionin e Mitrovicës, ky ka arritur t'i godasë grupet serbe dhe shqiptare të krimit të organizuar në Mitrovicë. E kjo s'i ka shkuar për shtati

Serbisë, sepse vetëm përmes atyre grupeve Serbia mund ta ruajë prezencën e vet në Kosovë, për ta përdorur për diskreditim angazhimin proevropian të Republikës së Kosovës.

Nga ardhja e zotit Nehat Thaçi në veri, ka edhe reduktime të penetrimit të lëvizjeve regresiste islamike nga Serbia, e që përkrahen nga lidhjet islamiste në shtypshkronja në Beograd, enkas për këto qëllime që besimin islam në Kosovë ta diskreditojë, ta portretizojë si pjesë të islamit regresist, e jo si besim fetar, tolerant, e bashkëpunues me të gjitha besimet në Kosovë.

Nga komandimi i tij edhe kolegët tanë deputetë, të komunitetit serb që janë prezentë në Kosovë, lëvizin më lirshëm nga Mitrovica për në kryeqytetin e Republikës së Kosovës për të qenë pjesë e institucioneve të Kosovës, kjo Serbisë nuk i konvenon. Nga ardhja e komandimit të tij në Mitrovicë ka funksionalizim të plotë të doganave, e që flasin edhe numrat statistikorë pozitivë që s'i kishte as UNMIK-u e as EULEX-i. Dhe këta numra ekonomikë kanë reduktuar hyrjet joligjore në vit, mallra në vlerë afërsisht 400 milionë euro në veri ilegalisht dhe kjo vlerë është shitur dhe ka kaluar në duart e krimit të organizuar serbo-shqiptar.

Nga komandimi i tij vendimet për ndalesë të të ashtuquajturve përfaqësues të interesave serbe janë reduktuar dhe implementohen në bazë të kërkesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar ndërkombëtarë,

Ja për këto është arrestuar Nehat Thaçi, e jo për deponime të rrejshme të disa dëshmitarëve, të cilët s'e besoj se kanë fakte për atë çka kanë thënë se ai është terrorist apo kriminel lufte.

Serbia do të vazhdojë të luajë me këto raste vazhdimisht nëse ne nuk bëjmë kërkesa të qarta jo në Serbi, por në Bashkimin Evropian. Për këto arsye unë dëshiroj që të ndaj disa propozime me ju, që të jenë në formë të rekomandimeve dhe të rezolutës.

Ne deputetët e Parlamentit të Kosovës, duke autorizuar Qeverinë e Republikës së Kosovës kërkojmë nga Bashkimi Evropian dhe nga EULEX-i si garantues i rendit dhe qetësisë së bashku me komponentin tonë këtu, t'i ndërpresim bisedimet me Serbinë për shkak të keqpërdorimit të pozitës saj gjeografike që ka, duke keqpërdorur qytetarët tanë dhe pozitës politike që ka Bashkimi Evropian ndaj Serbisë. Në të kundërtën, nëse BE-ja nuk ndërmerr hapa të tillë, ne nuk e vlerësojmë të dobishme vazhdimin tutje të bisedimeve me Serbinë, sepse forma të tilla të skenave Serbia do t'i mbulojë krimet e veta që temë të jetë më shumë zoti Nehat Thaçi në arenën ndërkombëtare, se sa 1 mijë e 600 trupa fëmijësh, grash e burrash të vrarë e të masakruar kosovarë, që s'i dorëzon pranë institucioneve tona, pranë familjeve të veta, e që saktë e dinë fatin e tyre por, tallet me gjithë bashkësinë ndërkombëtare dhe me ndjenjat tona.

Serbia me këtë qasje dëshiron të mbajë ende gjallë krimin e organizuar në Mitrovicë. Këto duhet të jenë rekomandime që duhet t'i adresohen në rrugë diplomatike Bashkimit Evropian. Me këto skema arrestimi të njerëzve të sigurisë, Serbia do që ende të vazhdojë infiltrimin e lëvizjeve të dyshimta islamike në Kosovë me qëllim të portretizimit të Kosovës si vend trampolinë e ISIS-it për nga Ballkani në Siri.

Me këto skena Serbia do që të ketë terren të lirë për politikanët e saj që nuk vijnë këtu për interesat e komunitetit serb, por vijnë t'i përdorin ata si instrument kundër perspektivës evropiane të Kosovës. Dhe, me këto përfundimisht Serbia ka diskretituar planin në sistemin e sigurisë së Republikës së Kosovës, në sistemin e drejtësisë dhe në planin diplomatik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! MelihateTërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Të nderuar deputetë!

Në fakt, për rastin konkret të zotit Nehat Thaçi nuk kemi pasur ndonjë informacion të rëndësishëm, përveç informatave pak a shumë që i morëm sot, e veç asaj që është fjala për drejtorin e Policisë Rajonale të Mitrovicës dhe se është arrestuar dhe po mbahet në burg në Serbi.

Pse ka shkuar? Në çfarë cilësie, e tjerë, e tjerë, nuk janë dhënë asnjë informacion, po them sot ka informata pak më të shumta, por sido që të jetë, pavarësisht për çka është fjala, janë institucionet e Kosovës ato që vendosin dhe marrin masa për qytetarët e saj.

Në fakt, ajo çfarë po ndodh mendoj që është goxha brengosëse. Serbia po vazhdon të bëjë agresion dhe po e sulmon Kosovën nga të gjitha anët. Ka mbetur veç edhe një sulm i armatosur, i dhunshëm, nëse i dëgjoni retorikën e fjalëve zyrtarëve politikë, por edhe atyre fetarë, patriarkëve, siç ishte edhe deklarata e patriarkut Irinej, sidomos këtyre javëve të fundit, mendoj se vërtet janë për t'u brengosur.

Kjo nuk është vetëm një retorikë e fjalëve, zoti ministër i Jashtëm, ky nuk është vetëm diskurs gjuhësor, sepse gjenocidi kundër shqiptarëve, edhe krejt luftërat në hapësirën e ish-Jugosllavisë kanë filluar me këtë lloj retorike. E dini shumë mirë edhe Gazimestanin, edhe rastet e tjera me këto lloj retorika kanë filluar sulmet e dhunshme dhe gjenocidi serb kundër shqiptarëve të Kosovës.

Unë nuk di ku është Bashkimi Evropian, nuk po dëgjoj asnjë reagim të zyrtarëve të Bashkimit Evropian. Paramendojeni sikur një gjuhë të tillë ta përdornin zyrtarët e Kosovës ndaj Serbisë çfarë do të ndodhte. Po, jo dy kushte, por edhe 10 mijë kushte do t'ia kishin vënë Kosovës për liberalizim, bile-bile të mos flas edhe më shumë se çfarë do të mund të ndodhte.

Nuk e di pse Bashkimi Evropian është i padrejtë në këtë drejtim dhe nuk ka një qëndrim të qartë dhe të drejtë ndaj gjithë këtij sulmi, gjithë këtij agresioni të Serbisë ndaj Kosovës. Nuk po flas për pengesat e jashtëzakonshme që janë duke i bërë, e i kanë bërë, për mosanëtarësim të Kosovës, etj., etj. Në fakt, nuk është problemi veç i Serbisë, ne kemi hyrë në këto bisedime dhe po bëjmë pallavra me bisedime, thjesht po bëjmë pallavra. Bisedimet, i kam quajtur që nga fillimi, “janë pa kokë”, bisedime me të cilat Serbia po fiton gjithçka që ajo po do dhe për të cilat Kosova nuk e ka fort dert a po fiton diçka a jo, së paku kështu po duket, rezultatet janë të tilla ose pasojat janë të tilla.

Natyrisht, ne jemi për bisedime, unë s’mund të them që jemi kundër bisedimeve ajo që e tha deputeti Gëzim Kelmendi është qëndrim vetëm i tij dhe jo i atyre që e kanë kërkuar këtë seancë. Por nuk është tragjike nëse dikush kërkon të rishikohen bisedimet. Mendoj që definitivisht bisedimet duhet të ridizajnohen, sepse vazhdimi i mëtutjeshëm i këtillë i bisedimeve Kosovën është duke e dërguar në një rrugë pa kokë. Nuk mundemi ne që vazhdimisht temat që i bën Serbia dhe temat, të cilat Serbinë e çojnë për kandidat të Bashkimit Evropian dhe me të cilat Kosova pothuajse nuk fiton asgjë, e ne të themi që gjithçka po shkon mirë.

Të mos flas për fjalë e për manipulimet, do t’i quaja, të shumta që nga fillimi i bisedimeve, duke filluar nga ato teknike, jo kurrë s’kemi me hy në politikë, jo tash politike e tjera. E tha kryeministri që Serbia ka kërkuar më herët ndërprerje të bisedimeve. Serbia ka kërkuar, sepse po do të fitojë më shumë. Po do të fitojë, ta vejë në rend dite edhe “Trepçën”, për të cilën njerëzit tanë thonë që nuk do të shkojë e nuk e di kush kujt t’i besojë kur fillimisht kanë thënë që do të ketë veç teknike, e s’do të ketë politike, e kemi hyrë edhe në politike.

Kam shumë frikë që edhe “Trepçën” nesër do ta fusin në bisedime. Nuk do të doja të tingëllojë bash si disa opozitarë, por realiteti është i tillë. Fatkeqësisht, realiteti është i tillë.

Zoti president, në fund... jo, jo, ne nuk e anulojmë ligjin. Ne kemi thënë edhe bisedimet s’i kemi politike, e hymë krejt në bisedime politike. Edhe jo veç politike, por po hymë edhe në ato bisedime, të cilat thjesht po e dëmtojnë rëndë substancën e Kosovës. Po e dëmtojnë jo veç formën, por substancën e Kosovës, dhe do t’i lutesha shumë, po e them shumë hapur, po i drejtohem zotit president, zotit kryetar të Kuvendit, zotit kryeministër, dilni zot këtij vendi, ose shkoni!

Këtu s’ka rrugë të tjera, jo vetëm për këtë rast, nuk e kam fjalën për këtë rast, mund të jetë i fundit. Po flasim për gjendjen në përgjithësi në vend. Nëse një shtet me të cilin ne po bisedojmë edhe po kërkojmë normalizim të marrëdhënieve po na sulmon vazhdimisht, po bën agresione të vazhdueshme dhe ne, ne jemi aq inferiorë, aq të padijshëm, kjo nuk shkon më. Kosova ka edhe burra, ka edhe gra që kanë mjaftueshëm dije, atdhetarizëm, kanë mjaftueshëm edhe dije politike, edhe profesionale për t’i kryer punët ashtu siç duhet.

Këto nuk janë bash për të qeshur, por kushdo që qesh e nuk po e sheh mirë, mirë gjendjen ku jemi, le të qesh, por qesh ai që qesh i fundit. Faleminderit!

KRYESUESI: Kolegë deputetë, vazhdojmë, Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Qytetarë të nderuar të Kosovës,
Kolegë deputetë,

Familjarë të zyrarit të lartë të Policisë së Kosovës, Nehat Thaçi,

Konsideroj që është normale që sot në Kuvendin e Kosovës po ndodh ky debat me qëllim të sensibilizimit të opinionit vendor dhe ndërkombëtar në lidhje me arrestimin e oficerit të lartë të Policisë së Kosovës, zotit Nehat Thaçi. Po, nuk do të ishte normale që problemet me Serbinë t'i reduktojmë vetëm në këtë incident, sado i rëndë që të jetë ky, kur dihet se Serbia është shumë agresive dhe armiqësore jo vetëm ndaj qytetarëve të Kosovës, por ndaj shqiptarëve në përgjithësi dhe Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran, në veçanti.

Nuk është normale që Qeveria e Kosovës edhe pas këtij incidenti, sikur pas shumë incidenteve, shkeljeve të marrëveshjeve e të sovranitetit të Kosovës, shkeljes së të drejtave të shqiptarëve në Serbi, marrëdhëniet me Serbinë po i quan normale.

Nuk është normale që Qeveria e Kosovës nuk po reagon as atëherë kur Serbia hapur po ndërhyr dhe po ushtron pushtetin e saj në veri të vendit dhe në enklavat serbe, madje edhe në këtë Kuvend, përmes Listës Serbe dhe në Qeverinë e Kosovës, përmes ministrave serbë, kurse kryeministri, ministrja për Dialog e zyrtarë të tjerë po kalojnë shumë kohë në Bruksel kinse për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve.

Në anën tjetër, Serbia po arreston zyrtarët e Kosovës, po sjell në shkollat e Kosovës tekste shkollore që janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, nuk po e respekton asnjë marrëveshje të arritur në mes të dy vendeve dhe po ua mohon të drejtën elementare shqiptarëve autoktonë të Luginës së Preshevës. Qeveria e Kosovës në vend të ndërprerjes së bisedimeve, ajo po flet për të arriturat përmes këtyre bisedimeve që askush nuk po i sheh, përveç qeveritarëve aktualë.

Derisa Beogradi zyrtar edhe incidentin më të vogël që shpesh e inskenon vetë zyrtarët serbë, e bën çështje të Kombeve të Bashkuara, derisa në Bruksel diskutohet vetëm për pozitën e serbëve në Kosovë, as Qeveria e Kosovës dhe as ky Kuvend asnjëherë nuk e kanë shtruar për diskutim diskriminimin e shqiptarëve të Luginës nga institucionet e Serbisë, edhe pse dihet se shqiptarët e Luginës së Preshevës që jetojnë në Luginë dhe ata që janë shpërngulur në Kosovë, pasi Serbia i dëboi nga shtëpitë e tyre, po përballen me shumë probleme.

Jeta në Luginë për ata është bërë e padurueshme, për shkak të ngecjes së zhvillimit ekonomik, papunësisë, mungesës së trajtimit adekuat shëndetësor, mungesës së teksteve shkollore dhe formave të tjera të presionit shtetëror.

Një numri të konsiderueshëm të shqiptarëve të Luginës së Preshevës Serbia nuk pou lëshon dokumente personale: letërnjoftime, pasaporta etj. nëse ata nuk jetojnë në shtëpitë e tyre më shumë se tre muaj, edhe atëherë kur në shtëpi jetojnë anëtarët e tjerë të familjes. Me qëllim të pastrimit etnik të Luginës së Preshevës, Serbia po e përdorë metodën e pasivizimit të vendbanimeve shqiptare dhe po i heq ata nga evidenca e regjistrave të shtetit, kështu Serbia po u mohon shqiptarëve të gjitha të drejtat që i takojnë shtetasve të tjerë në Serbi.

Edhe këtë vit shkollor nxënësve të Luginës së Preshevës nuk u është mundësuar përdorimi i teksteve shkollore në gjuhën e tyre amtare.

Autoritetet qeveritare në Serbi vazhdojnë prolongimin e nostrifikimit të diplomave. Janë qindra të diplomuar shqiptarë, të cilët presin për njohjen e diplomave të tyre në Serbi. Ndërkohë, nevoja për kuadro sa vjen e shtohen, ndërsa zgjidhja e këtij problemi vazhdon të zvarritet. Diskriminimi në punësim është edhe një formë tjetër e presionit ekonomik që i shtyn shumë shqiptarë të Luginës të largohen nga vendlindjet e tyre.

Në Luginën e Preshevës aktualisht jetojnë rreth 60.000 mijë shqiptarë, ose 70 % e popullatës së përgjithshme të Luginës, dhe nga 1 mijë 596 të punësuar në institucionet publike në Luginë, të punësuar janë vetëm 387 shqiptarë, ose 24% e të punësuarve të përgjithshëm, derisa të punësuar serbë janë 1 mijë 188, ose 75% të numrit të përgjithshëm të punësuarve, ndërkohë që banorët serbë përbëjnë vetëm 25-26% të banorëve të atjeshëm.

Po ashtu, edhe në Kosovë shqiptarët e Luginës së Preshevës, që pushteti serb i ka dëbuar nga shtëpitë e tyre në vitin 2001, përveç problemit të strehimit, punësimit, të drejtës për shkollimi, shërbim shëndetësor, shërbim social, të drejtës në pronë etj., po përballen edhe me probleme administrative që po ua shkakton burokracia e Kosovës.

Nga të dhënat e siguruara në Zyrën për Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, nga dhjetëra-mijëra qytetarë të Luginës së Preshevës që jetojnë në komunën e Gjilanit, vetëm 126 nga ata qytetarë i plotësojnë kushtet të aplikojnë për letërnjoftime të përkohshme, bazuar në Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës për lëshim të lejes për qëndrim të përkohshëm.

Qytetarët e tjerë që janë paraqitur në Zyrën për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc në Gjilan nuk i kanë plotësuar kushtet që i ka shtruar burokracia e shtetit të Kosovës për marrjen e dokumentacionit të përkohshëm të Republikës së Kosovës, po kërkojnë nga këta dokumente që

të sjellin se janë qytetarë të Serbisë, kurse në anën tjetër, Serbia nuk po u lëshon dokumente të këtilla këtyre qytetarëve. Edhe pse Serbia ka lëshuar edhe vërtetime për mosdhënien e dokumenteve të identifikimit dhe udhëtimit në Serbi për shtetasit e saj shqiptarë që argumentojnë shkeljen e të drejtave të njeriut dhe paraqesin një fushatë të organizuar të spastrimit etnik nga ana e Serbisë, për këtë diskriminim nuk ka ndodhur asnjë reagim, as nga dy shtetet shqiptare dhe as nga faktori ndërkombëtar.

Edhe pse dhjetëra-mijëra shqiptarë janë dëbuar nga shtëpitë e tyre, atyre askush nuk u ndihmon t'i riparojnë apo t'i rindërtojnë shtëpitë e tyre dhe as që është iniciuar rikthimi i tyre në vendlindje, derisa në Kosovë nga viti 2005 deri në vitin 2015 për të rikthyerit janë ndërtuar 1 mijë 352 shtëpi, dhe këta janë kryesisht qytetarë serbë.

Sikur të gjitha këto probleme nuk mjaftojnë, Serbia kohëve të fundit e ka rritur ndjeshëm numrin e forcave ushtarake-policore në Luginë, nëpërmjet të cilave po bëjnë jo vetëm presion psikologjik, por edhe presion të drejtpërdrejtë në rrugë, në familjet shqiptare dhe kudo që gjenden shqiptarët.

Përkundër tërë këtij terrori shtetëror mbi shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe cenimit të sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, dy shtetet shqiptare jo vetëm që po heshtin, por edhe po ndihmojnë Serbinë në integrimin e saj në Bashkimin Evropian.

Oficeri Nehat Thaçi duhet të lirohet, por me lirimin e tij nuk marrin fund problemet që ekzistojnë në mes dy shteteve. Për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet ndryshim rrënjësor i politikës së Serbisë ndaj shqiptarëve dhe njohja e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Dhe në fund, natyrisht e përkrah propozimin e iniciuesit të këtij debati për ndërprerjen e menjëhershme të bisedimeve me Serbinë dhe të pjesës së diskutimit të zonjës Tërmerkoll në lidhje me formatin e bisedimeve, sepse pajtohem shumë që kjo që po ndodhë në këto bisedime shkon vetëm në interes të Serbisë dhe assesi në interes të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Arrestimi i qytetarëve dhe personave zyrtarë të Republikës së Kosovës në vendet e rajonit, sidomos në Serbi, është bërë dukuri.

Arrestimi i fundit i drejtorit të Policisë së Mitrovicës, zotit Nehat Thaçit dhe mbajtja e tij në arrest nuk është asgjë tjetër, vetëm për të treguar se Serbia nuk është e interesuar që të ketë marrëdhënie fqinjësore me Kosovën. Është arrestim politik.

Arrestimi i zotit Nehat Thaçi është lajm i keq jo vetëm për Policinë e Kosovës, është lajm i keq edhe për institucionet dhe imazhin e Kosovës. Meqenëse, tashmë ka ndodhur arrestimi dhe ky rast juridikisht është rast gjyqësor dhe jo politik, kërkojmë nga institucionet e Kosovës t'i ofrohet ndihmë juridike nga shteti zotit Nehat Thaçi, t'i paguhet avokati dhe të sigurohemi që të respektohen të drejtat e njeriut për persona të arrestuar, të ketë gjykim dhe trajtim fer. Kjo duhet të bëhet nga shteti përmes organizatave të ndryshme kredibile dhe profesionale.

Shteti i Kosovës nuk ka bërë sa duhet për rastin e Thaçit, angazhimi dhe presioni për lirimin e tij do të duhej të ishte shumë më i madh. Konsiderojmë, se tani ka qenë një arsye shtesë për t'i dhënë fund dialogut edhe ashtu të padrejtë dhe të pabarabartë me Serbinë dhe këtë dialog ta kushtëzojmë edhe me lirimin e zotit Thaçi po edhe me implementimin e të gjitha marrëveshjeve që janë arritur në Bruksel, sepse nuk ka kuptim të ketë ende dialog kur Serbia nuk të njeh dhe për më tepër, kur flitet për përmirësim raportesh, ajo nuk po vepron në këtë mënyrë.

Këto veprime të përsëritura për liderë e zyrtarë të lartë janë të pakuptueshme dhe të papranueshme. Përderisa zyrtarë të lartë të Serbisë vijnë në Kosovë me leje e pa leje, sikurse në tokë të babës dhe me fjalimet e tyre nuk kontribuojnë në stabilizimin dhe relaksim të marrëdhënieve në mes të dy shteteve, por përkundrazi, nxisin urrejtje dhe kontribuojnë në rritjen e urrejtjes në mes të komuniteteve.

Tash, si duhet të veprojmë me këtë shtet, që ka vrarë, dhunuar, ka masakruar me mijëra qytetarë të Kosovës e askush nuk është dënuar, asnjë kërkim falje bile nuk e kemi. Ende kemi mbi 1 600 të pagjetur edhe 16 vjet pas luftës. Shteti i Serbisë nuk po bashkëpunon as me Kosovën e as me organizatat ndërkombëtare, të këto trupa të pajetë të kthehen në Kosovë.

Është momenti që ta respektojmë shtetin tonë, ta respektojmë vetveten dhe të kërkojmë reciprocitet për çdo veprim, se boll ma.

KRYESUESI: Faleminderit! Luljeta Veselaj-Gutaj e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
E nderuar familje e zotit Nehat Thaçi,
Më lejoni që në fillim ta filloj fjalimin tim duke shprehur respektin dhe nderin më të madh për Policinë e Republikës së Kosovës.

Mbrojtja e dinjitetshme e institucioneve të Kosovës është obligim i të gjithë neve. Nehat Thaçi është përfaqësues i institucioneve të Kosovës, drejtor në regjionin e Mitrovicës. Kur ne sot po

diskutojmë dhe po flasim për një arrestim, siç është arrestimi i zotit Thaçi, është gjendje shqetësuese dhe është obligim i të gjithë neve që të bashkohemi dhe t'i themi jo dhe kundër dialogëve të tillë, të cilët na bëjnë pre e arrestimeve të tilla, siç është rasti në fjalë.

Aq më shumë, kur dihet se kemi të bëjmë me një arrestim dhe që kemi frikë për një trajtim jo të mirë nga ato kazamate famëkeqe, ku është më se e arsyeshme të kemi një shqetësim të përbashkët.

Politika serbe në asnjë mënyrë nuk shprehë madje as gatishmëri për të ndërruar, e lëre më që të veprojë në drejtim të ndryshimit të kursit të saj. Arrestimet e tilla krejtësisht me prapavijë politike me aktakuza të sajara nga një regjim i njohur botërisht, jo vetëm që janë të papranueshme në deklarime, por duhet vepruar kundër tyre në mënyrë të qartë dhe pa asnjë vonesë.

Cenimi i lirisë së lëvizjes së qytetarëve tonë duhet marrë përgjigjen e merituar nga ana e institucioneve të Kosovës, sepse nuk është vetëm zoti Nehat Thaçi që po kalon nëpër këtë proces, janë edhe shumë zyrtarë dhe qytetarë të tjerë të Kosovës, të cilët e kanë lirinë e cenuar.

Ne jemi në një proces dialogu me Serbinë dhe këtu propozoj, që delegacioni shtetëror i Kosovës në dialogun që po zhvillohet në Bruksel të kërkojë me urgjencë bisedime për çështjen e aktakuzave të ngritura nga koha e regjimit të Milosheviqit në Serbi, të cilat po i zhvillon në trajtim të qytetarëve shqiptarë të Kosovës. Dhe, duke parë se tashmë kemi një sulm direkt ndaj institucionit më kredibil të vendit, siç është Policia e Kosovës, ne duhet reaguuar me shpejtësi që të lirojmë sa më shpejt zotin Thaçi dhe, njëkohësisht të sigurohet qarkullimi dhe jeta e të gjithë qytetarëve të tjerë, që mund të jenë objekt i sulmeve të tilla.

BE dhe EULEX, ju duhet të angazhoheni më shumë që këto raste t'i trajtoni më me seriozitet. Këto akuza duhet të zhvlerësohen në tërësi dhe për raste individuale, që mund të ketë dëshmi për ndonjë vepër penale, është Misioni i EULEX-it dhe institucionet kosovare që i kanë trajtuar dhe do vazhdojnë t'i trajtojnë bazuar në ligjet në fuqi dhe në konventat ndërkombëtare relevante për çështje të tilla.

Duke besuar se fund të këtij debati ne do të nxjerrim edhe një rezolutë, e cila duhet të jetë obligative për delegacionin tonë në bisedimet që zhvillojnë në Bruksel, e cila duhet të kërkojë prerazi që të kemi një raund urgjent bisedimesh për rastin e aktakuzave ndaj qytetarëve tanë nga ana e shtetit serb.

Uroj që sa më parë Nehat Thaçi t'i bashkohet familjes së tij dhe t'i kthehet punës në ndërtimin e sigurisë së qytetarëve të Kosovës, ndërsa paqes dhe sigurisë në rajon nuk i nevojitet dhe nuk i

kontribuon në asnjë mënyrë kjo sjellje e shtetit serb dhe këto arrestime krejtësisht politike, madje as krijimi i një raporti të shëndoshë multietnik brenda vendit.

Edhe njëherë, nuk duhet të ndalemi vetëm me deklarata politike apo edhe me apeline, duhet vendosmëri institucionale dhe veprime konkrete për të siguruar atë që kemi të siguruar edhe me konventa ndërkombëtare - lirinë e lëvizjes për qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Zonja dhe zotërinj të pranishëm në këtë seancë plenare, dhe

Të gjithë ju që po e përcillni përmes medieve elektronike dhe të shkruara,

Është më se e qartë tash që arrestimet e tilla janë të papranueshme, janë provokim nga shteti i Serbisë, t'i quaj provokime të radhës, sepse nuk është hera e parë që ka ndodhur. Dhe mbi të gjitha, krijohet edhe një ambientum politik, që jo rrallëherë arrestime të tilla përdoren edhe për ballafaqim hesapesh politike.

Sinqerisht, personalisht kam besuar në iniciativën fisnike të deputetit për kërkesën për debat parlamentar për arrestimin e zotit Nehat Thaçi, por nga shumica e parafolësve krijohet përshtypje që aspak nuk është fare në interesim arrestimi dhe lirimi i bashkëqytetarit tonë, se sa që është dhënia e kahes politike, mbi të gjitha edhe formulimet propagandistike, populliste dhe deri te ajo që luan me emocionet familjare të të arrestuarit, por dhe me emocionet familjare të atyre që janë vrarë e masakruar nga lufta në Republikën e Kosovës nga shteti armik Serb.

Besoj se kjo nuk i kontribuon, as çështjes në fjalë, nuk i kontribuon as zhvillimit të punës institucionale, mbi të gjitha krijon edhe një raport dualizmi dhe mund të vijmë në një konkludim që institucionet tona në përgjithësi nuk e kanë interesimin për qytetarët e vendit, qoftë lloji i këtij rasti apo edhe në rastet tjera, por më shumë e kanë qëllimin për mitizim të rasteve të caktuara dhe për të përdorur për emocione politike, mbi të gjitha për goditje politike për çështje, në të cilat tash ne edhe në seancat e kaluara jo pak është folur për dialogun Kosovë-Serbi.

Pse po e potencoj këtë fakt? Sepse, edhe vetë fjalimi im ishte në një kahe tjetër, por nga ajo që tashmë morëm informacione edhe nga dikasteret qeveritarë, ku këtu mendoj që nëse kishte me qenë vullneti i Kuvendit, po e përsëris, po qe se aq vullnet do të kishte Kuvendi për ta trajtuar një rast të tillë, janë komisionet funksionale, Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së, Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, Komisioni për Politikë të Jashtme dhe Komisioni për Punë të Brendshme, që menjëherë do të duhej të thërrisnin ministrat në fjalë që të raportonin për rastin në

fjalë. Por, më shumë është përdorur për popullizëm dhe është pritur në një seancë plenare, kur tendenca për t'i dhënë kahe tjetër debatit dhe normalisht, ka edhe çështje të cilat janë të interesit të veçantë, që duhet Qeveria t'i ketë parasysh, por që nuk i kontribuon rastit në fjalë.

Dhe, nga ajo që thuhet, jo rrallëherë, pa qëllim edhe vetë deputetë rrëshqasin në diçka që nuk i ndihmojnë personit në fjalë. Ajo që kemi dëgjuar, personi Nehat Thaçi nuk ka qenë pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka qenë i burgosur gjatë luftës nga okupatori serb, është liruar me kontingjentin e të burgosurve politikë nga Serbia dhe sot këtu thuhet se ka qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. A po dëshirojmë t'i ndihmojmë apo dëshirojmë që t'ia vemi edhe një barrë, domethënë në këtë krahurë, në këtë tendencë të Serbisë që të mbajë peng personat nga Kosova.

E dyta, unë e dëgjova me vëmendje edhe ministrin e Punëve të Brendshme, e dëgjova edhe përgjigjen profesionale të Ministrisë së Drejtësisë, që besoj se do të vijmë në atë konkludim, herët a vonë, në këtë fazë apo në fazën e mëvonshme dhe pa emocione edhe kjo çështje duhet të trajtohet, Kosova duhet mbrojtur qytetarët e vetë, pa marrë parasysh nën çfarë petku mund të përdoren nga Serbia apo nga çdo shtet tjetër dhe e ka detyrë kushtetuese, që të mbrojë qytetarët e vet.

Po, si është e mundur që një epror i Policisë së Kosovës, i cili udhëheq me një regjion të caktuar të bëjë lëvizje në shtetin serb, duke marrë parasysh edhe intencat e caktuara dhe mos ta dinë eprorët e tij? Pse po e them këtë? Sepse, sipas kodit të etikës së Policisë, që e ka të brendshëm, për shembull, shumë lokacione janë të ndaluara ku pjesëtarët e Serbisë mund të kenë qasje edhe brenda Kosovës.

E dyta, ky është komandant i një regjioni i cili është problematik në vend, ku krimi dhe korrupsioni është arterie kryesore, që dëmton edhe ekonominë e vendit tonë. Në këtë aspekt, ne nuk kemi asnjë informacion, qoftë nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës, qoftë edhe zgjeruar edhe nga Ministria e Punëve të Brendshme për persona të tillë nën petkun e gradave të Policisë së Kosovës për veprimtarinë e tyre, qoftë ajo edhe institucionale.

Andaj, për të mos u keqkuptuar, unë mendoj që rastet e tilla nuk duhet të përdoren si ballafaqim politik këtu, duhet të adresohen qartë, saktësisht, se çfarë kërkon Kuvendi i Kosovës për t'i mbrojtur qytetarët e vet, cilën përgjegjësi institucionale e kërkon nga mekanizmat qeveritarë, ministrinë e linjës të cilat janë kompetente për këtë dhe deri ku mund të shkojnë organet gjyqësore për trajtimin e rasteve të tilla.

Vetëm kështu u ndihmojmë qytetarëve të vendit tonë, nuk u ndihmojmë qytetarëve të vendit tonë duke i mitizuar, duke i përdorur për ballafaqim politik në çështje të dialogut apo duke i përdorur për të gjitha pengesat dhe të gjitha intencat që i përdor Serbia ndaj shtetit të Kosovës. Besoj që

kjo më së miri u pasqyrua edhe në deklaratat e përfaqësuesit tonë diplomatik në Beograd, por edhe nga avokatët mbrojtës të avokatit Nehat Thaçi.

Unë i dëshiroj lirim të shpejt! Mbi të gjitha, pjesë e rekomandimeve duhet të jenë edhe përgjegjësia institucionale edhe brenda vet institucionit të Policisë edhe brenda institucioneve, të cilat janë përgjegjëse për profilin e eprorëve të Policisë apo mbi të gjitha, normalisht po i përfshij edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, edhe lidhjet që kanë me zona të caktuara, ku krimi dhe korrupsioni është arterie dhe e cila, e thash, po e përsëris, po pengon zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Besoj që me këtë debat do të jepet mesazh i qartë me shumë drejtime të caktuara, por jo duke i përdorur për rastet e tjera, si produkt i ndarjes politike, që ekziston në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Sinqerisht, shpresoj që çdoherë ballafaqimi me fakte, ballafaqimi pa emocione u ndihmon rasteve të tilla dhe kjo duhet të jetë një pikënisje e vetëdijesimit për komisionet funksionale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për Kuvendin në përgjithësi, që t'i trajtojë në mënyrë efikase mbikëqyrjen parlamentare ndaj ekzekutivit, para se të kemi ballafaqim të debatit publik. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Flora Brovina, fjala për ju.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Kolegë dhe kolege,

Të nderuar familjarë të zotit Nehat Thaçi,

Akuza dhe burgosja e eprorit, drejtorit të Policisë rajonale të Mitrovicës, zotit Nehat Thaçi, është e qëllimshme dhe e paramenduar. Ajo ka për qëllim përkeqësimin e mundësisë së dialogimit ndërmjet Serbisë dhe Kosovës për përmirësimin e marrëdhënieve tona. Kjo nuk është e drejtë, është një provokim që duhet ta shënojmë si provokim.

Kosova është një shtet i pavarur, i njohur ndërkombëtarisht, në fazën e fundit të liberalizimit të vizave me shtetet e Bashkësisë Evropiane, është anëtare e shumë mekanizmave ndërkombëtarë, ka Kushtetutën, ka gjyqësorin e vet, forcat mbrojtëse, policinë e vet. Në ndërtimin e shtetësisë dhe integritetit tonë ne u sfiduar shumë herë, pikërisht nga ata të cilët bënë gjenocid në Kosovë ndaj popullit tonë shqiptar, që e detyruan edhe forcat ndërkombëtare të intervenojnë që ta mbrojnë popullin e pambrojtur.

Në emër të paqes në vend dhe në pritje të një kërkimfalje për gjithçka ndodhi, në emër të ndërtimit të kësaj paqeje, pra ne kapërcyem dhembjen tonë dhe mbi plagët tona. Ndërtuam ligje dhe Kushtetutën si dokument kryesor që garanton barazinë e komuniteteve e në rend të parë, komunitetit serb, i cili madje mund të thuhet lirisht, është i privilegjuar. Si përgjigje ndaj kësaj morëm përzierje në punët e brendshme të shtetit të Kosovës nga Serbia, e cila instrumentalizon përfaqësuesit e zgjedhur të popullit, pra deputetët dhe të tjerët, që të pengojnë në çdo mënyrë funksionimin e shtetit tonë të ri.

Dialogu teknik si mjet i komunikimit dhe ndërtimit të paqes, sikur e pranuan ne, nuk po jep rezultatet që menduam. Ai nga biseda teknike u shndërrua në dialog politik, sepse kjo u keqpërdor nga Serbia. Ajo mori rolin e paternalizmit, sepse Serbia tani udhëheq me temat të cilat do të dialogohen, ajo prolongon proceset, i detyron ekipet bashkëbiseduese të flasin shumë herë për të njëjtat tema dhe pa u dhënë një zgjidhje dhe për këtë imponon edhe temat e caktuara, duke mos i përfillur interesat tona, ato për të cilat në këtë Kuvend u nxor edhe rezolutë. Pra, ne i paracaktuam se cilat janë prioritetet tona.

Prej kah kjo e drejtë e Serbisë të akuzojë qytetarët tanë si dikur gjatë luftës, kur ajo pikërisht në datën kur në Kumanovë u nxor marrëveshja për përfundimin e luftës, ajo dërgoi pengje, më shumë se 3 mijë pengje, të cilat i dënoi në gjykatat paralele, e theksoj - në gjykatat paralele të Kosovës në Serbi, të cilat funksionojnë edhe sot, duke i mbajtur në tortura dhe me vite këta të zënë peng dhe Bashkësia Ndërkombëtare nuk kishte forcë dhe as nuk pati mekanizma që të evitojë, që agresori t'i dënojë viktimat.

Këtë kohë më kujton pikërisht akuza ndaj zotit Thaçi dhe të tjerëve, ndalesat e qytetarëve tanë dhe funksionarëve tanë në kufij dhe në shtete të tjera. Serbia po tregon forcën dhe mundësinë që e ka. Serbia, ajo ende në Kushtetutën e saj e ka Kosovën brenda si pjesë përbërëse të saj. Serbia po ndëshkon qytetarët e Kosovës pa e treguar se kush ishin emër për emër ata që kryen krime në Kosovë, nuk po tregon ku janë të zhdukurit, të cilët dihet se u zhdukën nga forcat militare të saj, pa treguar krimet kundër njerëzimit, siç është dhuna seksuale gjatë luftës për shkak të përkatësisë së tyre nacionale. Ajo nuk kompensoi dëmet e luftës dhe nuk dënoi kriminelët e masakrave të shumta në Kosovë, ose edhe kur i dënoi ato ishin aq simbolike. E përmend shembullin e Çyshkut.

Serbia sot po fshikullon me kamxhikun e luftës, ndryshe nuk mund të kuptohen fjalimet e politikanëve të ndryshëm serbë, madje edhe të atij që duhet të proklamonte paqen e po e proklamon luftën, që është patriarku Irinej.

Përfundim:

- Së pari, kërkoj që menjëherë, me çdo kusht e pa kushte, të lirohet zoti Nehat Thaçi. Për arrestimin e tij të lajmërohen instancat ndërkombëtare, duke filluar nga Kombet e Bashkuara,

Bashkimit Evropian, Shteteve të QUINT-it veç e veç, anëtarëve të NATO-s, por edhe Interpolit. Kjo nuk do të thotë, se ne nuk jemi anëtarë të Interpolit dhe nuk mund të dërgojmë letër, shkresë, dhe ta informojmë se po burgosen qytetarët e Kosovës.

- Së dyti, personat që propagandojnë luftën, urrejtjen, konfliktin, siç është rasti i politikanëve serbë dhe konkretisht Patriarkut Irinej, të shpallen “non-grata” në Kosovë. Ata po ndjellin marrëdhënie të këqija, konfliktuozë në mes të qytetarëve tanë.

Kosova duhet t’i ketë emrat e kriminelëve dhe ata t’i dorëzojë në I# gjithashtu, edhe pse s’është anëtare e Interpolit, të paktën le të dihet se ne i njohim ata.

- E treta, të shqyrtohet natyra dhe niveli i bisedimeve në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë. Bisedimet janë mjet i ndërtimit të paqes. Ne duhet të kemi bisedime të mirëfillta, ku respektohen të dy palët në mënyrë të barabartë, si shteti me shtetin e jo si shteti dhe provinca, sikur tani, sepse bisedimet tani për tani quhen “Bisedime në mes Beogradit dhe Prishtinës”.

Kërkoj nga Parlamenti që të ngre zërin e kërkesës ndaj Qeverisë, që të respektohen rezolutat e nxjerra në këtë Kuvend. Qeveria e kuptuam se ka bërë diçka, mjaft ka punuar, domethënë të vazhdojë punën e saj rreth lirit të zotit Thaçi, por Kuvendi në emër të vet, të nxjerrë përfundime dhe natyrisht, këto t’i dërgojë në adresat që i përmenda. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Kur Qeveria filloi dialogun me Serbinë, më kujtohet këtu, në këtë seancë, në këtë sallë në fakt, fjalët kyçe të përdorura aso kohe ishin si në vijim: “Vijat e kuqe”, “çështjet e brendshme”, “interesi i Kosovës”, “përmirësimi i jetës së qytetarëve”, e tjerë, e tjerë...

Përgjatë procesit të dialogut, pikërisht fjalët kyçe u shndërruan në veprime kyçe, të cilat me intensitet i kryente Serbia kundër Kosovës, duke avancuar përpara në drejtim të Bashkimit Evropian në kurriz të Kosovës, e cila përgjatë rrugës mbeti e izoluar, e fundit në rajon, pa sovranitet dhe e nëpërkëmbur.

Pra, përgjatë dialogut vijat e kuqe u zverdhën, çështjet e brendshme të Kosovës përfunduan në negociata, negociatat kryesisht përfunduan me koncesione të reja, ku jepte Kosova e merrte Serbia. Interesi i Kosovës dhe qytetarëve nuk merrej parasysh askund e jeta e njerëzve të rëndomtë komplikoheshin edhe më shumë e edhe më keq. Ndërkohë, që Qeveria e vendit merrej veç dhe kryesisht me dialog, Serbia vazhdonte të aplikonte linjën e Milosheviqit në raport me Kosovën, si në vijim:

- duke e vrarë policin Enver Zymberi në veri të vendit përmes paramilitarëve të vet të barrikaduar atje,

- duke uzurpuar territore dhe asete të Republikës, ndërkohë që gjunjëzonte dhe shtrinte për tokë Policinë e Kosovës, përmes xhandarmërisë, e cila hyn e del në vend sa herë t'i teket. Pra, derisa Edita, kryeministri e të tjerët, vazhdonin të dialogonin, përgjigja nga Serbia dhe Daçiçi ishte kjo, ju kujtohet shumë mirë kjo fotografi e Policisë së Republikës së Kosovës e ndërkohë tanët vazhdonin të shkonin dhe të nënshtroheshin në Bruksel para Serbisë dhe kërkesave të saj.

- duke ndaluar në kufi zyrtarët e Republikës së Kosovës me qëllim të heqjes së tabelave, të cilat që njëqind herë u konfirmuan nga Qeveria, se tanimë janë “problem i zgjidhur”. Mirëpo, të gjithë ata që ndonjëherë ju rastisë të kalojnë kufirin e dinë se duhet hequr tabelat fillimisht.

- duke mbajtur në fuqi dhe duke aktivizuar në vazhdimësi fletarrestet dhe dënimet e gjykatave të Millosheviqit e plotë ndërhyrje të tjera përmes projekteve kolonizuese, që aspak nuk dallojnë nga e kaluara, siç është “Lugina e Diellit” në veriun e vendit.

Dhe, ndërkohë që Serbia vazhdon avazin e vjetër, Kosova me marrëveshjen për drejtësi të 10 shkurtit 2015 rregullon numrin etnik të gjyqtarëve në Kosovë, ndërsa Kosova integron “Rojet e Urës”, mbrojtjen civile e gjyqtarët, Serbia arreston policët tanë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto, Kosova s'ka nevojë, s'ka asnjë arsye për të vijuar dialogun me Serbinë, sepse edhe kështu Kosova në këtë dialog po përfaqësohet nga një strukturë e papërgjegjshme e zyrtarëve të Qeverisë, të cilët 17 vite pas lufte, dje deklaruan që s'kanë listë emrash me persona të zhdukur. Dhe hera e fundit, kur kjo çështje është hapur në Bruksel ka qenë viti 2011.

Atëherë, për cilat interesa të qytetarëve të Republikës së Kosovës po flitet dhe po negociohet në Bruksel, kur një deklaratë e tillë fyese dhe e turpshme jepet, pikërisht dje. Në ndërkohë, përsëri vazhdohet me konfirmimin se “ne do të vazhdojmë të dialogojmë në Bruksel”.

Mirëpo, kjo strukturë pushtetarësh e inkriminuar thellë në krim, e përfshirë edhe vet në kontrabandë ndëretnike në qytetin e ndarë, shumë mot, shumë moti pra, braktisi interesat e shtetit e së fundi me këtë qasje, sikurse sot, braktisi edhe Nehatin, policin e Kosovës, të cilin përderisa Serbia po vazhdon ta mbajë peng, kryeministri i Kosovës po vazhdon ta konfirmojë vazhdimin e dialogut dhe me këtë po vazhdon të inkurajojë Serbinë që ta mbajë Nehatin në burg dhe që të arrestojë qytetarë të Republikës së Kosovës sa herë t'i teket.

Përderisa e kemi këtë Qeveri do të kemi edhe më tutje arrestime, do të kemi edhe më tutje padrejtësi dhe do të kemi edhe më tutje momente, kur ne do të skuqemi, sepse do të ndjehemi si qytetarët më të pafuqishëm dhe me të drejtat më të cenuara në mbarë Evropën.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën. Ndërkohë, bëhet gati zonja Shukrije Bytyqi.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit.

Ministrja Hoxha, sigurisht ka kaluar tre muaj e po harron se ndoshta edhe detyrën e vet nuk e ka mësuar mirë, por nuk guxon të ulet në pozitën e deputetit, sepse ne si deputetë nuk ta kemi zënë pozitën atje asnjëherë, ministre. Nuk është “pa, pa, pa...” po thjesht, duhet ta dish detyrën tënde dhe ta kryesh me përgjegjësi. Dhe, normalisht se kryetari ishte dashur t’ia tërheq vërejtjen, por...

KRYETARI: Kërkoj falje, zonja deputete, por me lejen time, gabimi është imi. Me lejen time ka shkuar.

TEUTA HAXHIU: E di që po e merr, kryetar,...

KRYETARI: Jo, jo, me lejen time, po ta jap fjalën e nderit, paraprakisht. E vërejte edhe vet, jo tash, po me lejen time. Gabimi është i imi.

TEUTA HAXHIU: Atëherë, në rregull!

Megjithatë, sot po diskutojmë, po debatojmë në një seancë të thirrur, pra nga më shumë se 40 deputetë, për një rast jo pak të ndjeshëm, por megjithatë si një prej nënshkrueseve të kësaj kërke, më duhet të ju them se e kemi shumë të qartë të gjithë deputetët, që Kuvendi i Republikës së Kosovës vërtet ka shumë e shumë çështje të rëndësishme për t’u marrë, por nuk është e pavlerë kjo që po diskutohet sot, nga se pikërisht gabimet e Qeverisë dhe neglizhenca e saj e ka sjellë, pra edhe Kuvendin, që të reagojë, sepse jemi deputetë të të gjitha subjekteve politike dhe të gjitha deklaratimet që po thuhet këtu, po thuhet për një rast, për të cilin urojmë që të jetë i fundit, por duhet t’i bëhet e qartë Qeverisë në krye me zotin Mustafa, si zoti i shtëpisë, në këtë rast i zoti i Qeverisë, i cili e ke detyrën e vet për të bërë punën siç duhet, konform obligimeve që i ka e jo për të thënë, se “ky Kuvend ka nxjerrë një ligj në 2013-ën” e të thirret sa herë t’i teket kur t’i shkojë për shtati, që në bazë të atij viti, pra 2013, ne jemi të obliguar të vazhdojmë bisedimet.

Bisedimet do të duhej të vazhdonin në frymën e një normalizimi, por ajo nuk po ndodh asnjëherë dhe pikërisht është Kuvendi, janë deputetët, që edhe kanë votuar, por deputetët që po e ngrenë zërin sot, do të thosha nga të gjitha partitë politike, pra u thirrën që janë të dëmshme marrëveshjet dhe janë të dëmshme bisedimet. Prandaj, duhet ta marrë shumë seriozisht këtë çështje të ngritur nga deputetët, zoti Mustafa.

Zoti Mustafa në fjalën e tij vazhdimisht u thirr që “një qytetar i vendit është arrestuar”. Kryeministri Mustafa po harron, që vërtet është qytetar i Republikës së Kosovës nënkoloneli, një udhëheqës i Policisë së Kosovës, pra në Mitrovicë, por para së gjithash është një zyrtar i lartë. Andaj, nuk është njëjtë si një qytetar i thjesht sikurse zoti Thaçi.

E di që ka shumë zëdhënës Qeveria, por merrni detyrat me bekimin e zotit Mustafa dhe mund të thirreni edhe ju zonja Besa, po edhe zonja kryetare e Komisionit për Punë të Jashtme, e cila sot, pra në pikën e parë, u thirr tamam si zëdhënës e Qeverisë. Shumë zëdhënës ka kjo Qeveri, fatkeqësisht.

Institucionet e shtetit, përkatësisht Qeveria por edhe Presidenca e vendit, fatkeqësisht edhe më tutje, pra edhe sot në këtë takim, po vazhdojnë të qëndrojnë vetëm me deklaratat lidhur me rastin e zotit Thaçi, nënkolonelit Thaçi. Është absurd i llojit të vet, nëse Qeveria e Kosovës mjaftohet me deklaratat krejt boshe, sikurse edhe sot që u tha. Rastet e tilla janë të papranueshme, kështu thanë, apo “do të japim maksimumin që ta zgjidhim këtë çështje”. Unë konsideroj, se po në këtë frymë kanë qenë edhe deklaratat sot.

Kjo është e neveritshme. Në vend të kësaj Qeveria, Ministria e Punëve të Jashtme, do të duhej të dilnin me urgjencë për ndërprerjen e menjëhershme të bisedimeve me Serbinë, po potencoj edhe unë.

Edhe ashtu, kupa është mbushur që moti! Serbia nuk i ka respektuar asnjë nga marrëveshjet e arritura dhe asnjëherë, pra asnjëherë, e kanë theksuar sa herë zyrtarët e shtetit Serb, nuk do ta njohin shtetin e Republikës së Kosovës. Mbi të gjitha, shtetin e Republikës së Kosovës nuk e njeh as Kabineti i zotit Mustafa, pra përfaqësuesit që i ka në kabinet nga minoriteti serb. Këtë e kemi edhe tek udhëheqësit komunalë, pra siç e kemi pa, në asnjë rast nuk e kemi një shenjë që tregon se ata janë brenda Republikës së Kosovës. Përkundrazi, me akte të tilla të çmendura apo... ata po e vazhdojnë politikën e vjetër, Serbia në këtë rast, në raport me shtetin e Kosovës duke i fyer rëndë institucionet tona dhe uniformën e Policisë, pra hierarkinë e saj.

Është koha e fundit, madje krejt e fundit, që këtij mentaliteti kriminel t’i thuhet NDAL.

Këtë normalisht, se do të duhej ta bënte udhëheqja e shtetit. Si mund të nxirret para gjykate një komandant i Policisë së një vendi fqinjë, pa asnjë bazë ligjore? Bazuar në të gjitha normat e drejtësisë ndërkombëtare, si mund të pretendojnë të njëjtit, i njëjti mentalitet dhe e njëjta politikë, që në një të ardhme të afërt të kthejnë në Kosovë rreth 200 mijë serb, në mesin e të cilëve qindra kriminelë, militare e paramilitarë, që ushtruan gjenocid mbi shqiptarët në Kosovë? Çfarë do të ishte reagimi i Qeverisë së Kosovës në këtë rast?

Kësaj Qeverie në vazhdimësi, e cila po e dëshmon nënshtrimin e saj ndaj Serbisë, duke besuar në normalizimin e marrëdhënieve me këtë mentalitet milosheviqian, që për fat të keq ende udhëheq Serbinë. Isa Mustafa si kryeministër dhe Hashim Thaçi si president do të duhej më në fund ta kuptojnë, se kjo formë e të bërit politikë, kjo formë e komunikimit, ky nënshtrim i madh dhe këto fyerje që u bëhen institucioneve të ngritura nëpër sakrificë mbinjerëzore të këtij populli, do të duhej të marrin fund.

Kryeministri dhe Presidenti do të duhej të ishin, pra të parët, që duke qenë në nivelin e detyrës dhe përgjegjësisë shtetërore të reagonin fuqishëm menjëherë pas arrestimit të nënkolonelit Thaçi, duke shprehur vendosmërinë për lirimin e tij të menjëhershëm. Ka mundësi dhe rrugë diplomatike. Këta do të duhej të ishin të parët, që të kërkonin nga Bashkësia Ndërkombëtare, përkitazi Bashkimi Evropian, lirimin e menjëhershëm të zotit Thaçi. Në vend të kësaj, ata po vazhdojnë të mjaftohen me deklaratimet boshe të zyrtarëve qeveritarë, me papërgjegjshmërinë e deklaratave të kota, të zbrazëta, pa formë dhe absolutisht të pavendosura të zonjës Edita Tahiri, e cila nga Brukseli dhe Enver Hoxha gjithashtu, nga Prishtina.

Më lejoni që të përmend një deklaratë të zonjës Tahiri në komision, më duket ditën e djeshme, e cila nuk e di se deri kur më do të vazhdojë, por në këtë rast e përmendi rastin e listave të të pagjeturve dhe është diçka që më së paku do të pritej prej një zyrtari, sikur është zonja Tahiri, e cila thotë se “lista të të pagjeturve ende nuk kemi”. Prandaj, do t’i thosha zonjës Tahiri, që vetëm po t’i drejtohej organizatave, ose shoqatave që thërrasin, që mbrojnë këto familje të të pagjeturve, të gjithë i kanë listat. Mbi të gjitha, ka edhe shumë mekanizma të tjerë, që i kanë listat, i ka edhe Kryqi i Kuq e të tjerë. Por, zonja Tahiri dhe Qeveria asnjëherë nuk ishin të interesuar që këtë çështje ta marrin shumë seriozisht.

Në këtë mënyrë, me këto veprime të pamatura, është e qartë se rruga integruese e të dyja vendeve po dëmtohet seriozisht. Prandaj, duke parë pafuqinë, pavendosmërinë e institucioneve tona të ngritura me shumë mund, kërkojmë me ngulm nga autoritetet relevante ndërkombëtare, përkatësisht nga Brukseli zyrtar, që të ushtrojë gjithë tryshninë e tij mbi Beogradin, për të liruar nënkolonelin Thaçi dhe për të marrë fund këto arrestime që po ndodhin me qytetarët e vendit tonë.

Në këtë rast, siç e përmendi një prej kolegëve këtu, unë dua t’i them që Komisioni për të Drejta të Njeriut në takimin e javës së kaluar ka reaguar, pra si komision i parë nga Kuvendi, lidhur me këtë rast. Por, më lejoni të ju them, që njëri prej anëtarëve, pra zoti Rashid, si anëtar i Komisionit për të Drejta të Njeriut në atë takim tha: “Nuk do të reagoj, nga se asnjë nga zyrtarët, në këtë rast as kryeministri,” tha, “as presidenti, as Qeveria, nuk e ka bërë një hap të tillë. Ata do të duhej ta bënë një hap të tillë para nesh.”.

Por, në fakt, komisioni pa votën e tij, kuptohet, bënë një reagim. Mirëpo, reagimi i komisionit, reagimi ynë si deputetë, fatkeqësisht, më vjen keq prej prindit të zotit Thaçi këtu që po diskutojmë, normalisht që është me interes që secili të marrë pjesë në diskutim, por në fund të fundit e kam brengën siç e kam përmendur sa herë, që asnjë gjë nuk do të ndodhë, pra nuk do të ketë tryzni, sepse kjo qeveri e papërgjegjshme nuk i përfill asnjë vendim, asnjë deklaratë, as të gjitha dokumentet, kam thënë, rezolutat që nxirren në Kuvend nuk respektohen dhe thjesht, mbesin një letër. Andaj, uroj që si rast, le të jetë rasti i fundit, por përgjegjshmëria duhet të ngritët dhe syçeltësia duhet të jetë shumë më e madhe e udhëheqësve të vendit, në mënyrë që ky vend vërtet të shohë një rrugë, një dritë të gjelbër, për të menduar se është vendi ku ne duhet t'i themi "STOP", pra ne jemi ata që po respektojmë komunitetin më shumë se të gjitha vendet e rajonit. Por, privilegjet, që e kam përmendur edhe herën e kaluar, të një komuniteti serb në Kosovë, po na kthehen bumerang nga Serbia, prandaj mjaft me këto bisedime, ose bëni një analizë dhe shihni ku jemi.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Gaxherri, edhe pak desha... ndërmend e pata, se ke mbetur vetëm edhe ti pas Shukrijes me e marrë fjalën. A po do? A ta ka përmendur emrin? Si të duash, por fjalën e ke menjëherë pas Shukrijes. E dëshiron replikën, pra? Ia paske përmendur emrin, zonja Haxhiu, më fal!

BESA GAXHERRI: Po më vjen shumë keq, që këtu për këto... e përmendët emrin dhe po thoni jo. Unë po ju përgjigjem, kolege e nderuar, nuk jam zëdhënëse e Qeverisë, por kur bëhet fjalë për problemet në raport me Serbinë, atëherë po, unë jam zëdhënëse e Qeverisë, zëdhënëse e opozitës, zëdhënëse e mazhorancës, zëdhënëse e popullit dhe vendit tim.

Edhe me këtë rast, pasi që tash ma imponove ta marr fjalën, natyrisht se reagimi im shkon me të gjithë kolegët, të cilët deri tash diskutuan për lirimin e zotit Nehat Thaçi, por ne nuk i kontribuojmë çështjes kështu në këtë formë, as duke nda dëgjuar Serbia se çfarë jemi e kush jemi e, mundemi e s'mundemi. Natyrisht, kjo çështje është e ndjeshme, ne i kemi institucionet tona, i kemi ministritë relevante dhe për mendimin tim, më falni tash që po ju them, ai grup i cili ka iniciuar këtë debat dhe të gjithë ne, është shumë gabim.

Por, natyrisht nuk është gabimi ynë i parë si deputetë, shpeshherë ne duke u munduar të bëjmë patriotizëm bëjmë bumerang tema mbi veten dhe nuk zgjedhim hiç asnjë gjë. Por, megjithatë së paku të kisha lutur, ty dhe të gjithë kolegët, kursehuni, bile njëri me tjetrin mos të fyhemi këtu. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Zonja Haxhiu, hiç mos... le të bëhet zonja Gaxherri, pas Shukrije Bytyqit e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Zonja Haxhiu, urdhëroni! Fjala është për ju.

TEUTA HAXHIU: Shumë faleminderit, kryetar!

Edhe njëherë, si zëdhënëse mund të jesh, është krejt në vullnetin e zotit Mustafa. Ndoshta, edhe deputetëve tuaj këtu, por jo kurrë e opozitës, mos pretendoni. E di që shumë herë e merr fjalën dhe vërtet flet shumë, por në përmbajtje nuk the asgjë. U mundova ta kuptoj çfarë the, asgjë.

KRYETARI: Zonja Gaxherri e ka fjalën. Të mos dalim nga tema.

BESA GAXHERRI: Shumë keq po më vjen, që po duhet me e lëshua në këtë nivel bisedën e diskutimin, pa marrë parasysh që unë s'pajtohem të bëhet debat për këtë çështje në Kuvend, megjithatë tema është shumë serioze.

Tash, unë po të them, po e kam të qartë, ti s'kupton. Është e vërtet që ti s'kupton kurrëgjë.

KRYETARI: Zonja Shukrije Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar familje e komandantit të Policisë së Mitrovicës, zotit Nehat Thaçi,

Vërtet nuk meritojnë Policia e Kosovës të jenë kaq të pambrojtur nga institucionet e Kosovës.

Po behën gati dy javë që Nehat Thaçi, komandant i stacionit policor në Mitrovicë, po mbahet padrejtësisht në burgjet serbe, madje edhe duke u maltretuar here në Nish e here në Beograd për të dale para gjykatës speciale të Serbisë, gjoja për terrorizëm dhe shpërnguljen apo maltretimin e një familje serbe në Kosovë pas lufte së vitit 1999.

Kjo nuk është hera e parë që qytetarët e vendit tonë, madje edhe ata që mbajnë poste publike apo drejtojnë struktura të sigurisë maltretohën në shtetet fqinje, e besa edhe brenda territorit të Serbisë. Heshtja e stërzgatur e kësaj qeverie në lidhje me këtë rast na bën të kuptojmë paaftësinë e Qeverisë për të mbrojtur qytetarët e saj.

Shpeshherë kur ne kemi bere thirrje për ndërprerjen e bisedimeve me Serbinë, me argumentin e plotë se kjo qeveri është e pafuqishme për të biseduar me ta, sikur nuk e keni marrë seriozisht, ndërsa tani që për çdo ditë po arrestohen qytetarë të vendit tonë me aktakuza të montuara, nuk po i dilni zot e besa edhe po strukeni në qoshet e Qeverisë e larg medieëve, sikurse nuk ka ndodhur asgjë.

Po të ishte ndonjë veprim i shqiptarëve të Kosovës, apo i opozitës lidhur me pakënaqësitë ndaj Qeverisë, besoj që kjo qeveri deri më tani kish mbajtur konferenca shtypi bukur shumë.

Ndërsa, tani që Nehat Thaçi është në burg, nuk ka asnjë reagim prej institucioneve të Kosovës deri sot kur është thirrur kjo séancë.

Zoti kryeministër, Nehat Thaçi, përveç që është qytetar i Republikës së Kosovës është edhe komandant në zinxhirin e Policisë së Kosovës dhe ju ende asnjë veprim konkret për të!

Të nderuar deputetë,

Kjo qeveri prej ditës se parë të themelimit të saj ka bërë kompromise për pushtet, pra për ta mbajtur pushtetin dhe asgjë tjetër.

Madje, që ditën e arrestimit të tij është dashur që të tërhiqen bisedimet në Bruksel me Serbinë, dhe në vend të ndërprerjes se bisedimeve ne dëgjojmë, që Edita Tahiri thotë se Serbia do e njoh Republikën e Kosovës. Qysh po e njeh shtetin tonë Republika e Serbisë, unë e pyes ministren Tahiri? Duke arrestuar qytetarë, duke arrestuar struktura të sigurisë së Kosovës, duke shkelur sovranitetin dhe duke operuar ilegalisht në veri? Jo, kështu nuk njihet shteti ynë, e besa as nuk normalizohen marrëdhëniet ndërshtetërore.

Prandaj, veprimet dhe heshtja e kësaj qeverie e kanë bërë që Nehati të mbesë në burg kaq gjatë, dhe madje të reklamohet arrestimi i tij si një fitore dhe lojë kundër Republikës së Kosovës.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Nuk është hera e parë që policia dhe prokuroria serbe luajnë me sektorin e sigurisë në Kosovë, dhe për këtë fajtor janë vetë strukturat e Qeverisë sonë. Prandaj, jam e bindur se ashtu siç u tronditëm me pamjet e mëhershme të Policisë së Kosovës, të shtrirë në kufi me Serbinë, ashtu do të tronditemi edhe me pamjet e zotit Nehat Thaçi.

Jemi tejet të shqetësuar me veprimet që po ndodhin kundër Policisë së Kosovës dhe sektorit të sigurisë në përgjithësi. Shqetësim tjetër është agjenda pa krye e bisedimeve me Serbinë, që nuk po prodhojnë asgjë përveç tensioneve, prandaj si të tilla kërkojmë, që të ndërpriten sa më shpejt bisedimet me Republikën e Serbisë.

Arrestimi i Nehat Thaçit është dështim për shtetin e Kosovës dhe si i tillë po vazhdon të provokojë vendin dhe stabilitetin e saj. Prandaj duhet të ndërmerren hapa konkretë në sigurinë e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Përderisa, në Kosovë shëtisin ende kriminelë të dyshuar për krime lufte në Republikën e Kosovës e nuk arrestohen nga askush, si mund që kjo qeveri të mos quhet e dështuar.

Kërkojmë pa asnjë kusht lirinë e Nehat Thaçi dhe sa më shpejt t'i kthehet familjes dhe punës së tij. Dhe, nuk mund të mos them në fund, se nuk ka asgjë në jetë më mirë se t'ia dish hallin vetes,

kështu që kjo Qeveri duhet ta shohë paaftësinë e saj dhe të jep dorëheqje, sepse për paaftësinë e saj pasojat po i vuajnë qytetarët e Republikës së Kosovës çdo ditë. Faleminderit!

KRYETARI: Shukri Buja e ka fjalën, ndërkohë bëhet gati Veton Berisha, pastaj Mytaher Haskuka.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Se qysh i kemi punët, e shohim në Parlament me pjesëmarrjen e deputetëve në një pikë kaq “të nxehtë” dhe të rëndësishme, por aq më mirë e shohim kur i shikojmë karriget e ministrave, thuajse nuk kanë zëvendës po që se janë shumë të angazhuar, tepër të angazhuar e t’i çojnë zëvendësit që t’i zëvendësojnë në emër të Qeverisë. Nëse, s’kanë të drejtë, atëherë pse kemi kaq shumë zëvendësministra?

Po hy në temën për të cilën po diskutojmë. Është krejt normale kjo që po na ndodh, tepër normale, pse po habiteni? Cili institucion reagoi, kur kryeministri serb dha betimin dhe u duartrokit gjatë, u betua se do ta mbrojë Kosovën me çdo mjet si pjesë të Serbisë.

Cili institucion reagoi kur Gjykata e Hagës e liroi Millosheviqin si të pafajshëm dhe nisin iniciativat nga ministrat serb të qeverisë me të cilën po bisedojmë ne, për ta shpallur hero të shtetit serb.

Cili institucion i Kosovës reagoi tash së fundi, kur ne si Parlament e vendosëm Ligjin, jo edhe aq të mirë, për “Trepçën”, po marrin vendim për ta shfuqizuar, ndërhyjnë tepër ashpër, në mënyrë tepër të keqe, në punë të brendshme të Kosovës.

A do të vazhdojmë veç me deklarata dhe të vazhdojnë bisedimet, sepse kështu e kemi votuar me 2/3-at thotë kryeministri dhe unë e respektoj rezolutën e juaj. Ne si Parlament duhet t’i kufizojmë se në cilat bisedime duhet të hyjmë me Serbinë, jo t’i ndërpresim por duhet t’i kufizojmë, për dëmet e luftës, për pasurinë e përbashkët që e kemi pasur, që ta ndajmë, për çështjen e të zhdukurve, për fondet e vjedhura të pensionistëve të Kosovës e çështje të tjera që janë me rëndësi për shtetin. Çfarë ka të përziehet në këto punë tjera Serbia?

Po normalisht, që kur hyn në këto bisedime e s’reagojmë hiq, kurse Serbia reagon për një pllakë, Serbia reagon për një emër që ne e potencojmë, atëherë normalisht që edhe na arrestojnë, do të na arrestojnë edhe shumë prej nesh, bile.

Ushtarët e UÇK-së përballen me tri gjykata e me shumë shtete perëndimore, e para është Gjykata Speciale për krime të luftës në Kosovë, e cila është formuar nga ky Parlament, është Gjykata

Speciale e Kosovës por që do të veprojë jashtë, është Gjykata e Serbisë, të cilën e respektojnë shumica e shteteve që na kanë njohur si shtet apo si Pavarësi e Kosovës. Dhe, ne prapë habitemi dhe reagojmë për një rast.

Unë ju them, se zoti Thaçi ka qenë ushtar i UÇK-së, i është njohur statusi veteran i UÇK-së, ka qenë ushtar imi gjatë luftës së UÇK-së. Po ua them edhe këtë, ne do ta marrim si shkas, nuk është se duhet të merremi me një individ, ju lutem! Zotin Thaçi nuk e morën si veteran apo ushtar të UÇK-së, kjo ishte vetëm pretekst, arsye që u ngrit aktakuza për një... është një akuzë banale.

Po, arsyeja kryesore është se kanë dashur ta provokojnë rëndë shtetin e Kosovës, e kanë arrestuar drejtorin e Drejtorisë së Policisë. Kjo është arsyeja pse merren dhe përse duhet të angazhohemi, gjithsesi për zotin Thaçi.

Ju lutem, a po prisni që do t'i kemi punët më mirë, kur e shihni vetëm si rregull, kryeministri i Kosovës e mbanë fjalën para jush si shef i ekzekutivit, si njeri që udhëheq institucionin dhe pas tij e marrin fjalën ministrat, ai flet në emër të ministrave. Po të kishin folur ministrat para kryeministrit dhe kryeministri me e përmbledhë, atëherë do të ishte e arsyeshme, po kjo është jashtë çdo logjike. Shihet një mos organizim këtu dhe një joseriozitet. Duhet të kërkojmë seriozitet nga ky ekzekutiv, do të kërkojmë që edhe në bisedime të jetë gjithsesi serioz.

Unë dola këtu edhe për ushtarin tim, po dola të ju njoftoj tash publikisht, se të njëjtin fat e kam edhe unë, të njëjtën akuzë e kam edhe unë. Para një muaji, shteti që na ka njohur, që i kemi marrëdhëniet shumë të mira, që proklamojmë shumë, Maqedonia, ka tentuar të më arrestojnë. Ua lash peshqesh pasaportën edhe eca. Janë tri arsye pse eca dhe s'mundën të më arrestojnë.

E para, sepse do të kishte ndodhur një konflikt i armatosur në mes ushtarëve të mi, të cilët ishin pjesë e njësisë së Policisë së Maqedonisë dhe ishin policët e komunitetit maqedonas.

E dyta, do të kisha mbetur në burg për kohë të gjatë, se këtu po e shihni si veprojnë institucionet në Kosovë, a do të mund të më nxirrnin a jo?! Sa kanë mundur ta nxjerrin një ushtar e të mos flasim për një gjeneral!

Dhe e treta, arsyeja është se normalisht kanë tentuar të më arrestojnë, sepse në listë nuk kam qenë në listën e INTERPOL-it, një ditë përpara kanë tentuar të më arrestojnë dhe si gabim më kishin çuar në Serbi edhe Zoti e di se kur do të mundnin institucionet tona të më tërhiqnin, mbase pasi që ta kisha kryer dënimin në burg.

Unë desha ta propozoj një formë të rezolutës, por po tërhiqem për shkak se rezolutën në qoftë se s'e aprovojmë me 2/3-at e kishim... këtu në Parlament u tha që me 2/3-at duhet të aprovohet në mënyrë që të respektohet.

Ministrit, zotit Hyseni, po i them se Rregulloren e brendshme të Policisë, pasi ta lirojmë zotin Thaçi, pasi të angazhohen institucionet tona, të vijë ai në Kosovë, le ta zbatojë Rregulloren e brendshme, s'ka nevojë të na tregojë neve publikisht, se çfarë thotë Rregullorja e brendshme, a ka shkuar me leje a pa leje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për hir të korrektësisë procedurale, zotëri Buja, rezoluta ka të njëjtën vlerë edhe me votimin e shumicës së deputetëve, veç me e pas parasysh se nuk duhen 2/3-at, ose rekomandimet. Veç duhet të jenë 61 deputet votues në sallë.

Për sqarime shtesë, pastaj kur jemi te procedura e votimit edhe profesori... Veton Berisha e ka fjalën, ndërkohë të përgatitet Mytaher Haskuka.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar familjarë të zotit Nehat Thaçi,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë jam një prej nënshkruesve të kërkesës së kolegut Gëzim Kelmendi, për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme.

Mendoj se kam bërë mirë që e kam nënshkruar, për shkak se të paktën sonte u informuam për veprimet e institucioneve në raport me veprimet e tyre institucionale, në raport me arrestimin e zotit Nehat Thaçi, për të cilat vërtet nuk kemi qenë të njoftuar më herët. Për këtë po ndjehem mirë, ndërsa në anën tjetër, besova fuqishëm që sonte do të jemi fuqishëm njëzëri dhe do të diskutojmë e të japim rekomandime reale nga secili prej nesh, në mënyrë që të dalim nga kjo situatë dhe të bëjmë zgjidhje edhe për zotin Thaçi edhe për Familjen, ndërsa disa prej diskutuesve vërtet, ishin diskutime me qëllime politike dhe nuk morëm shumë zgjidhje. Vërtet, është për keqardhje kjo punë.

Unë nuk do ta zgjas dhe do të mundohem të jap arsyet e nënshkrimit tim të kësaj kërkesë.

Është një fakt që është arrestuar një shtetas i Republikës së Kosovës, aq më tepër është arrestuar edhe një drejtor i Policisë së Kosovës, i një regjioni me vështirësi dhe specifika të veta politike, siç është Mitrovica. Kam nënshkruar me qëllim për t'i dalë në përkrahje një drejtori, i cili mendohet dhe njihet si një person që është dëshmuar si këmbëngulës në luftimin e korrupsionit dhe veprimeve kriminale në Kosovë.

Kam nënshkruar me qëllim të shprehjes së pakënaqësisë ndaj Republikës së Serbisë, e cila pabesisht dhe në mënyrë jo të drejtë edhe pas mundit për të rikuperuar raportet tani e 16 vjet, shteti serb me veprime të tilla provokon dhe nuk lejon zhvillimin e Republikës së Kosovës dhe pengon integrimin e vetë serbëve të Kosovës në Kosovë, edhe pse Kosova ka bërë jashtëzakonisht shumë për komunitetin serb, bile-bile edhe duke shkelur të tjerët.

Kam nënshkruar me qëllim që të bëj thirrje, që vërtet edhe Bashkësia Ndërkombëtare të ndërmarrë të gjitha veprimet, që më në fund me veprimet e veta demokratike të trajtojë shtetin e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran dhe Republikën e Serbisë si shtet fqinj i yni.

Mendoj se shteti i Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ne si deputetë, duhet njëherë e përgjithmonë të ngulim këmbë, të jemi të mobilizuar dhe njëzëri të mbrojmë secilin qytetar të Republikës së Kosovës, pavarësisht se ku arrestohet, ashtu siç ditëm të mbrojmë edhe territorin edhe pasurinë e Kosovës, siç ishte rasti i fundit i mbrojtjes së “Trepçës”.

Mendoj dhe bëj thirrje, që Republika e Serbisë të pranojë realitetin dhe të fillojë të krijojë mundësi të mira bashkëpunimi ndërshtetëror në mes Kosovës dhe Serbisë. Ne si deputetë dhe si shtet nuk jemi që t’u dalim në mbrojtje asnjë veprimi të asnjë individi, që mund të ketë kryer ndonjë veprim kriminel, por në formën se si po vepron shteti serb, është kryekëput politik dhe provokues.

Për fund, ftoj institucionet e Kosovës dhe Bashkësinë Ndërkombëtare, që të vazhdojnë angazhimin që sa më parë zoti Nehat Thaçi të kthehet në Kosovë dhe sa më parë t’i bashkohet familjes dhe detyrës së tij në Policinë e Kosovës, për t’i kryer përgjegjësitë e tij në mbrojtje të shtetit dhe sundimit të ligjit në Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Haskuka, fjala për ju. Ndërkohë, të bëhet gati deputeti Bislim Zogaj.

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar deputetë dhe deputete,

E nderuar Kryesi,

Arrestimi i Nehat Thaçit, drejtorit rajonal të Policisë së Kosovës në Mitrovicë, është episodi i fundit nga seriali i propagandës së Serbisë, që luftën e drejtë të shqiptarëve dhe të UÇK-së për liri dhe pavarësi ta paraqesë si një luftë terroriste.

Po, a kemi ne faj në këtë aspekt? Në njërën anë e kemi një Serbi, që shkatërroi ekonominë e Kosovës, shkatërroi rreth 150 mijë shtëpi, qindra objekte fetare, u vranë më shumë se 12 mijë qytetarë të Kosovës, mijëra të tjerë u plagosën dhe u dhunuan, sot e kësaj dite i kemi 1665 persona të pagjetur.

E çfarë bënë institucionet e Kosovës, prokuroria, gjykatat e Kosovës? Në vend se të persekutojnë këta kriminelë, ata në njëfarë mënyre u amnistuan dhe mundohemi t'i integrojmë në strukturat e Policisë. Ish-punëtorët e MUP-it të Serbisë të cilit ishin edhe në kohën e Milosheviqit dhe që morën pjesë në krimet e luftës u amnistuan dhe tani gjoja, po i integrojmë në institucione dhe ata po marrin rroga nga Buxheti i Kosovës.

Pra, nëse ne nuk merremi me krimin, krimi merret me neve. Nëse, ne nuk merremi me Serbinë, Serbia merret me neve, nëse ne nuk i kërkojmë llogari Serbisë, Serbia kërkon llogari prej nesh. Tani, Serbia me këtë episodin e fundit mundohet të luajë rolin e viktimës dhe kërkon të bëjë propagandë ndërkombëtare, duke arrestuar ish-ushtarin e UÇK-së, duke arrestuar shqiptarë. Dhe, këtë tani mundohen ta paraqesin edhe si një pikë në Bruksel.

Para disa muajsh isha në Krushë të Madhe e Krushë të Vogël dhe duke biseduar u befasova, që nuk ka asnjë rast të vetëm, ku prokurorët e vendit janë marrë me këto masakra dhe nuk ka asnjë të arrestuar dhe nuk ka asnjë gjykatë lidhur me këto krime, ku u vranë qindra qytetarë të pafajshëm të këtyre fshatrave.

Që nga data 5 nëntor 1999, kur ka filluar të funksionojë UNMIK-u dhe institucionet e përkohshëm të qeverisjes, janë evidentuar më se 1187 vepra të dyshuara të krimeve të luftës nëpër të gjitha vendet e Kosovës. Por, nga të gjitha këto vetëm 50 raste janë shqyrtuar nga UNMIK-u dhe EULEX-i, pra më pak se 5% të rasteve. 17 vjet pas lufte, pse kaq shumë kriminelë serbë e asnjë të gjykuar? Pse u dënuan kaq pak serbë për krimet e luftës që i bënë në Kosovë?

Ndoshta, fajin e kemi ne! Ka pasur një dështim të tërësishëm të sistemit të drejtësisë për të gjykuar krimet e luftës në Kosovës. Shumë herë qeveritë e kaluara kanë thënë, se kjo është prioritet, por ky prioritet ka qenë vetëm në emër, vetëm për propagandë politike. Kurrë qeveritë nuk kanë ndarë resurse të bollshme humane dhe financiare për të gjykuar krimet e luftës që kanë ndodhur në Kosovë. Pra, drejtësia për viktimat e luftës në Kosovë ka qenë vetëm retorikë elektorale.

Në vitin 2009 EULEX-i hetonte 50 raste të krimeve të luftës në Kosovë, ndërsa në të njëjtën kohë kanë qenë të evidentuara diku rreth 1 009 raste të krimeve të luftës. Nga këto, vetëm 158 raste ishin të hedhura poshtë, nga se nuk kishte dëshmi të mjaftueshme, ndërsa të tjerat diku rreth 851 raste janë joaktive, pra do të duhej të hetoheshin por nuk ka ende hetime për këto. Shumë pak nga këto janë hetuar, si nga ndërkombëtarët po edhe nga institucionet vendore.

Të ketë kaq shumë ndihmë për drejtësi, të ketë kaq shumë organizata ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare, kaq shumë donacione për të pasur drejtësi në Kosovë e të mos ketë drejtësi për viktimat e luftës dhe për familjet e tyre, është një krim më vete. Pasi që, qeveritë e gjertanishme

kanë dështuar në adresimin e krimeve të luftës, të kryera nga Serbia në Kosovë, tani Serbia bën propagandë me raste të tilla mediatike, që shqiptarët po ashtu kanë kryer krime dhe mundohet që të paraqesë edhe shqiptarët si kriminelë, ndërsa serbët si viktima. Por, këtë propagandë kemi ndihmuar edhe ne dhe qeveritë tona me mospunën e deritanishme lidhur me këtë çështje.

Prandaj, unë në këtë rezolutë propozoj që të shtohet edhe një pikë, që tu ndahen resurse humane dhe financiare gjykatave të Kosovës, që ato t'i kenë krimet e luftës si një ndër prioritetet e tyre gjatë punës së ardhshme. Është e pafalshme, që 17 vjet nga lufta Prokuroria e Luftës nuk ka hapur asnjë rast të vetëm për masakrën e Krushës së Madhe, Masakrën e Krushës së Vogël, Çabratin në Gjakovë, Tususin në Prizren e shumë qytete e fshatra të Kosovës, ku kanë ndodhur masakra dhe ku dihen fajtorët dhe ku dihet se cilët paramilitarë dhe militare kanë marrë pjesë në to.

Arrestimet e ardhshme të qytetarëve të Kosovës nga ana e Serbisë ne mund t'i ndalim vetëm nëse mbrojmë të vërtetën tonë për luftën e vërtetë të UÇK-së, e cila ka qenë luftë e drejtë, luftë për liri dhe luftë për pavarësi.

Po ashtu ne këtu mund të dalim vetëm nëse angazhojmë profesionistë dhe me punë të palodhshme t'i adresojmë krimet në prokurori dhe në gjykatat e Kosovës.

Serbia tërë kohën i përsërit gënjeshttrat e saj për Kosovën dhe në të njëjtën kohë ne nuk i përsërisim të vërtetat tona për Kosovën. Besoj që edhe ky është një rast tjetër që duhet përsëritur të vërtetat për Kosovën dhe të kërkojmë nga Serbia që të japë llogari për atë çfarë ka bërë në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zogaj, merreni fjalën dhe le të bëhet gati Driton Çausi.

BISLIM ZOGAJ: Përshëndetje, kryetar!

Përshëndetje ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Në realitet, unë nuk kisha paraparë të marr fjalën, sepse nuk ka qenë i nevojshëm të jetë ky debat kaq i gjatë, por më shtyn diskutimet e kolegëve, por edhe realisht kam menduar se kjo seancë do të zgjatë diku rreth gjysmë apo më së shumti një orë, mirëpo më shtyri që edhe unë t'i them nja dy-tri fjalë.

Arsyeja pse po flas është se kemi respekt për Nehat Thaçin, në rend të parë se ka qenë ushtar dhe meriton çdo respekt.

Mirëpo, thirrja e kësaj seance kam menduar do të jetë vetëm sa për ta votuar një rezolutë apo edhe për t'u informuar se çka ka bërë Qeveria apo institucionet e Kosovës për lirin e zotit Nehat.

Diskutimet ishin aq të paarsyeshme, për mendimin tim, sa që kishte edhe asi diskutimesh se a ka pasur leje a s'ka pasur, a është dashur të shkojë në Serbi apo s'është dashtë, që thuaja ne sot e gjykonim Nehatin e nuk ishim të interesuar për ta liruar Nehatin.

Pati diskutime që thuaja se për herë të parë e kishim një nevojë për të vendosur se çka të bëjmë, a të vazhdojmë bisedimet me Serbinë apo jo, a të ketë reciprocitet apo jo, dhe shumë gjëra të tjera.

Pati edhe diskutime që t'i vëmë ultimatum Serbisë që të lirohet Nehati, e çka nuk pati në këto bisedime, që për mendimin tim më shumë i ngjanin fushatës elektorale se sa një çështjeje, që për mendimin tim, është dashur të trajtohet më seriozisht.

Po e them këtë sepse kolegët deputetë kanë thirrur një seancë dhe folën më shumë se 40 deputetë për të respektuarin Nehat, që thashë e respektoj, por që është tani i arrestuar nga një aktakuzë e fabrikuar në Serbi, e cila për mendimin tim është e paqenë, kurse asnjëherë s'e ngritëm zërin për Azem Sylën, ish-komandant i Shtabit të Përgjithshëm dhe deputet.

Dikush mund të thotë, po për Azem Sylën ka bazë, po akuzohet për një vepër që ekziston. E unë them se s'ekziston dhe besoj që të gjithë këta deputetë e njohin Azem Sylën dhe a mund të jetë i akuzuar apo jo.

Po e them këtë me bindje, sepse edhe kjo aktakuzë apo akuza që i bëhen Azem Sylës janë të fabrikuara në të njëjtën kuzhinë ku është bërë edhe akuza për Nehatin. Pra, akuzë e fabrikuar në Serbi, e Dragolub Stankoviçit.

Pra, ne si deputetë, më shumë jemi duke folur dhe dukur në televizion se sa për të ndikuar aty ku kemi mundësi, sepse ndikimi ynë në pushtetin e Serbisë është zero. Kurse në këto institucione në Kosovë mendoj se mund të kemi ndikim, jo për të ndikuar negativisht, por për të ndikuar pozitivisht që edhe në Kosovë të ketë drejtësi.

Edhe një herë kërkoj falje, ndoshta u zgjata pak, por më befasuan kolegët deputetë që e zgjatën më shumë për folklorizëm se sa për qëllimin për të cilin jemi mbledhur sot.

KRYETARI: Faleminderit! Driton Çausi e ka fjalën!

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të pranishëm,

Fillimisht më duhet të shpreh habinë time nga fjalimet që sapo i dëgjuam nga deputetët e koalicionit qeverisës. Do të ishin shumë shpresëdhënëse të gjitha ato qëndrime që dëgjuam, me plot gojën: reciprocitet, sovranitet, ndërprerje të dialogut, ndryshim të dialogut dhe masa të tjera në raport me Serbinë pas rastit të arrestimit të Nehat Thaçit.

Por, për ata qytetarë që nuk kanë pasur mundësi të përcjellin në tërësi seancën e sotme të parë, po ju kujtoj se kishim dy rezoluta të propozuara nga Lëvizja “Vetëvendosje” që kishin të bëjnë pikërisht me raportet parimore, të cilat ne i kërkojmë, në raport me shtetin e Serbisë dhe të cilën po të njëjtët deputetë që tani po flasin me fjalime të zjarrta ndaj Serbisë, nuk i votuan.

Pra, kjo tregon për hipokrizinë brenda kësaj salle të Kuvendit.

Është tepër zhgënjyese pas atyre që i dëgjuam nga kryeministri dhe ministrat se çfarë niveli ka rënë nënshtrimi i Qeverisë së Kosovës në raport me qëndrimet hegjemoniste të Qeverisë aktuale serbe.

Pra, kryeministri tha se nuk mund të ndërpresim dialogun pas çdo provokimi. Të njëjtën gjë e tha edhe ministri Hoxhaj. Më intereson se ku është ai pragu, i cili nuk tejkalohet, i këtyre provokimeve, e që nuk përbën shkelje të integritetit dhe të sovranitetit të Republikës së Kosovës.

Pra, në çdo shtet tjetër funksional do të kishim një reagim tjetër dhe nuk do të bëhej fare fjalë për vazhdim të dialogut pas këtyre veprimeve.

Mirëpo, unë do t’i përmend vetëm dy momente skandaloze, që e shpërfaqin në mënyrën më të mirë rrjedhën e këtyre bisedimeve.

Më 3 gusht të vitit 2015 kryeministri Mustafa u kishte premtuar familjarëve të të pagjeturve që tema e vetme dhe kryesore, domethënë gjatë negociatave të ardhshme në Bruksel, do të jetë fati dhe gjetja e të pagjeturve.

Le që s’ka ndodhur një gjë e tillë, por ne dëgjuam një deklaratë edhe më skandaloze nga ministrja Edita Tahiri që për fatin e të pagjeturve në Bruksel është biseduar vetëm një herë dhe kjo ka qenë në vitin 2011. Dhe, arsyeja pse s’është diskutuar më tutje ka qenë fakti se ne nuk kemi, Kosova pra nuk ka lista me emra të të pagjeturve.

Pra, kjo tregon mënyrën më të mirë se në çfarë raporti qëndrojnë këto dy shtete dhe si zhvillohen këto negociata.

Tjetra që më duhet të përmend gjithsesi është edhe gjendja në veri, Lugina e Diellit. Pra paramendoni se në çfarë shtete ka ardhur shteti i Kosovës.

Zëvendëskryeministri Stojanović merr pjesë në përrurimin e një ndërtimi ilegal, të iniciuar dhe të shtyrë nga shteti serb, i shoqëruar nga ministri Mariq dhe, në anën tjetër, në Prishtinë Qeveria lëshon një deklaratë duke e dënuar këtë akt dhe duke i tërhequr vërejtjen shtetit serb të mos ndërhyjë dhe të mos nxisë serbët lokalë.

Pra, pyetja për kryeministrin është se cila është Qeveria e Kosovës, kjo që lëshon komunikatën apo ajo pjesë e Qeverisë që merr pjesë në përrurimin e Luginës së Diellit.

Më duhet të ngre edhe një çështje që lidhet me rastin e arrestimit të Nehat Thaçit.

Mendoj se është pasqyra më e mirë për atë që ka ndodhur me institucionin e Policisë së Kosovës, pra me degradimin e këtij institucioni, që do të duhej të kishte një subjektivitet dhe një pavarësi të veten, por po konstatojmë të gjithë se nuk e ka.

Natyrisht se kur bëhet fjalë për policë të thjeshtë, të gjithë jemi të vetëdijshëm se ata janë të diskriminuar, ata nuk i kanë të drejtat që duhet t'i kishin, ata nuk kanë as sigurime shëndetësore, mirëpo mënyra se si ky institucion udhëhiqet tregon se kemi të bëjmë me një institucion të kapur dhe që s'ka fije pavarësie në funksionimin e vet.

Pra, përderisa shteti serb ngre dhe monton raste për qytetarët dhe policët e Republikës së Kosovës, kjo polici politike e bën të njëjtën me aktivistët e Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Të rinjtë, aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, 6 prej tyre ende po mbahen në mënyrë të padrejtë, pa asnjë bazë, me rastin i cili u është montuar atyre për terrorizëm.

Pra, është absolutisht fatkeqësi dhe do të ishte një gjë që do ta thosha asnjëherë, mirëpo paralelja është e qartë. Mënyra se si këto dy institucione funksionojnë është e njëjtë. Të dyja janë politike dhe të dyja montojnë raste si kjo në Serbi ndaj zotit Nehat Thaçi, ashtu edhe policia politike e kapur nga klani “Pronto” Mustafa ndaj aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Pra, policia përdoret sa herë i nevojitet pushtetit, mirëpo kur pushteti duhet të dalë në mbrojtje të tyre, ata lihen dhe hidhen si lecka.

Natyrisht se ne e përkrahim idenë, e ky nuk është rasti i parë dhe nuk do të ishte ky momenti, sepse ky moment ka kaluar shumë kohë më parë, që ky rast të shërbejë si një mundësi për ndërprerje të negociatave joparimore dhe të padrejta me shtetin serb. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe tre diskutues i kemi! Albin Kurti!

ALBIN KURTI: Qytetarë të Republikës,

Deputetë të Kuvendit,

Do të përpiqem të theksoj gjëra të cilat nuk janë thënë sot këtu, por edhe të mos i përsëris ato që i kam thënë më herët.

Pasnesër, siç e dimë, bëhen dy javë prejse zoti Nehat Thaçi, drejtor i Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, u rrëmbye nga Serbia dhe ai tash atje po mbahet si një rob lufte apo si një peng i luftës, i akuzuar padrejtësisht për krime ndaj serbëve lokalë.

Ne kemi thënë shumë herë që qëndrimet tona dhe veprimet tona ndaj Serbisë nuk mund të përkthehen në qëndrime dhe veprime ndaj serbëve, për shkak se e bëjmë dallimin fundamental midis Serbisë, si shtet dhe serbëve si popullsi.

Ky debat mund të jetë i vonuar dhe sigurisht që është debat i vonuar. Mirëpo, nuk është edhe saktësisht kështu kur kemi parasysh që debati i këtillë i Kuvendit është edhe reagim ndaj Qeverisë së Kosovës, përveç se ndaj Serbisë.

Në fakt, Kuvendi i Republikës ka pritur për Qeverinë 12 ditë që të thotë diçka përmbajtjesore, të vendosur, serioze e të sinqertë, në mënyrë që Kuvendi mbase edhe të mos ketë nevojë të organizojë kësi debati.

Debati që po ngjan sot në Kuvend nuk është vetëm rezultat i pranisë kriminale të Serbisë kundër Kosovës, por rezultat edhe i mungesës së veprimeve të Qeverisë së Kosovës.

Të thuash se Kosova duhet të bisedojë me Serbinë, me Qeverinë aktuale të saj, pa asnjë kusht për Serbinë, është e mundshme vetëm nëse beson se gjithmonë duhet biseduar edhe me terroristët, edhe me kriminelët. Jo vetëm politikanë, por edhe studiues të politikës, ka të tillë që besojnë se çdoherë, çdo kund duhet biseduar me gjithkënd, përfshirë këtu edhe terroristët edhe kriminelët. Pra, ka të tillë që besojnë edhe ashtu.

Pra, pasi që i ke cilësuar si të tillë, si terroristë e si kriminelë dhe përkundër që i ke cilësuar si të tillë, negocion e angazhohesh në dialog me ta. Veçse, edhe atëherë, pra edhe për ata politikanë e studiues që besojnë se gjithmonë duhet të negociohet me gjithkënd, tërë kohën e kudo, edhe atëherë kjo s'mund të jetë bisedë, negociatë e dialog për tema të cilat i përcakton vetëm terroristi e krimineli, në rastin tonë, Beogradi.

Pra, nëse beson që çdoherë duhet biseduar me gjithkënd, kjo nuk mund të jetë sipas temave, çështjeve, agjendës së terroristit dhe kriminelit, në këtë rast të Qeverisë së Serbisë, e cila siç duhet është përplot me kriminelë të luftës, e qe besa edhe Kuvendi i tyre me 85% deputetë ose çetnikë ose rrotull-çetnikë. Vetëm 15% të Kuvendit të Serbisë janë opozitë atje.

Dhe, çfarëdo bisedimi, negociate apo dialogu edhe me terroristë dhe me kriminelë sipas temave e çështjeve të tyre nuk paraqet dialog e negociatë me ta, por paraqet nënshtrim ndaj tyre.

E kuptoni, pra, se nuk është e mundshme, edhe për ata që besojnë se çdoherë duhet negociuar, që në këtë rast të negociojnë, sepse kjo po bëhet sipas temave e agjendës së Serbisë. Asnjë temë e Kosovës nuk është duke u negociuar në Bruksel mes zonjës Tahiri dhe qeveritarëve të tjerë me Serbinë. Të gjitha temat i ka përcaktuar Serbia.

Cili është konkluzioni? Konkluzioni është që nëse bisedimet nuk janë sipas kushteve të Kosovës, atëherë bisedimet janë sipas kushteve të Serbisë. Këtu nuk ka neutralitet. Nëse kushtet nuk janë tonat, atëherë janë të Serbisë. Dhe kushtet e bisedimeve në Bruksel kanë qenë kushte të Serbisë. Duke qenë kushte të Serbisë, nuk kanë mund të sjellin rezultat tjetër.

Mirëpo, si u quajt ky rezultat? Ky rezultat u quajt normalizim. Normalizim i marrëdhënieve. Mbase i kanë normalizuar marrëdhëniet ata që kanë negociuar, mirëpo jo edhe qytetarët e popullsitë që ata i përfaqësojnë.

Dhe, teksa nuk ka ndodhur as normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë, krerët e Kosovës flasin për stadin e ardhshëm, për etapën e ardhshme, për fazën në vijim që ata e quajnë pajtim. Në fakt, ata mund të jenë tashmë të pajtuar me krerët e Serbisë, por te populli nuk ka as normalizim.

Dhe këtu duhet të bëjmë një vërejtje thelbësore. Dihet se dija në përgjithësi është e dy llojeve, është dija si çështje e fakteve të përvojës dhe është dija si çështje e vlerave normative.

Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Serbisë mund të mos jenë pajtuar sa i përket fakteve të përvojës. Nëse e pyetni Qeverinë e Serbisë, nuk ka pasur gjenocid në Kosovë. Nuk ka pasur krime ndaj shqiptarëve, nuk ka pasur luftë çlirimtare. Dhe, nëse na pyetni neve, po edhe Qeverinë besoj, ka pasur edhe luftë çlirimtare, edhe gjenocid të Serbisë, edhe krime të Serbisë, edhe agresion e okupim, edhe shtypje politike, edhe shfrytëzim ekonomik, edhe diskriminim kulturor.

Pra, ne me Serbinë nuk pajtohemi për faktet. Mirëpo, a e dini çka është paradoksi? Qeveria e Kosovës pajtohet me Serbinë për vlerat. Ky është problemi. Sepse, për faktet me Serbinë s'pajtohen as këta. Se Serbia s'pranon asgjë për Kosovën. Mirëpo këta pajtohen për vlerat. Cila është vlera? Normalizimi. Cila është vlera: pajtimi, dialogu me kriminelë e me terroristë, pavarësisht kush janë, çka kanë bërë e çka duan në të ardhmen. Ky pra është problemi.

Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Serbisë, edhe pse s'pajtohen për faktet, pajtohen për vlerat. Bile, bile thënë të drejtën, më keq është të pajtohesh për vlera se për fakte me Serbinë.

Këta po pajtohen për vlera, prandaj e kemi të ardhmen e rrezikuar. Kur pajtohesh për vlera, e ke të ardhmen e rrezikuar. Kur s'pajtohesh për fakte, e ke historinë e kontestuar.

Dua të dal te ajo që duket se polici Nehat Thaçi i ka besuar kësaj Qeverie. Këta kanë thënë po i normalizojmë marrëdhëniet. Nëse normale janë marrëdhëniet me Serbinë, ky ka mundur të nisej drejt Austrisë e Zvicrës, t'ia mësyjë nëpër Serbi. Se vetë Qeveria i të cilës ai është vartës, i ka thënë se i kemi normalizuar marrëdhëniet. Mos ke gajle, lirisht shko ti nëpër Serbi.

Pra, Nehat Thaçi është viktimë e besimit të tij me Qeverinë e Kosovës, e posaçërisht me zonjën Tahiri.

Por këtu ka edhe një gjë tjetër shtesë, se unë besoj që njëmend Serbia mund të jetë hakmarrë taktikisht, sepse në kohë ka ndodhur asisoj, ndalimi i Gjuriqit. Është përmendur edhe më herët.

Mirëpo, politikisht është më thellë se kaq. Janë lulet e të ashtuquajturit “president Thaçi në Grackë të Lipjanit, te pllaka ku shkruan – viktima të agresionit të NATO-s dhe viktima të terrorit shqiptar”. E pra, kur të shkosh në Grackë të Lipjanit e të qitësh lule, në Grackë të Lipjanit, është e njëjta komunë prej nga vjen Nehat Thaçi, dhe të qitësh lule te pllaka ku shkruan “Viktimat e terrorit shqiptar”, atëherë normalisht se ti e shtron rrugën politikisht për atë çka të bën vaki më vonë.

Bile, kush e di tash, Prokuroria e Serbisë mund ta thërrasë si dëshmitar të ashtuquajturin president të Kosovës, sepse ky ka shkuar e ka qitur lule te “viktima e terrorit shqiptar”. Pra, paska pasur terror shqiptar këtu. Për mua do të ishte në rregull ky të shkojë në familje të serbëve të vrarë. Në familje të shkojë dhe t'u shprehë ngushëllime dhe të shprehë zotim për luftimin e krimit që ka ndodhur në ato familje, por jo te pllaka e Serbisë, se pllaka nuk është e serbëve. Pllaka është e Serbisë. Serbia e ka qitur atë pllakë.

Duhet të kesh kujdes a po i qet lulet te serbi i vrarë lokal, a te pllaka e Serbisë që të akuzon ty si komb. E ky ka shkuar i ka qitur te pllaka e Serbisë lulet, bash në Grackë të Lipjanit. Po kjo ka qenë grackë, tamam Grackë qysh e ka fshati emrin.

Pra, po them, ky është problemi i madh që e kemi ne. E kemi në krye. Me shtrimin e këtij asfalti politik për mësymjet e Serbisë. Dhe, është mirë që si Kuvend po debatojmë dhe le të miratojmë rezoluta që e obligojnë Qeverinë, porse ky është reagim sa ndaj Serbisë kriminale e terroriste, po ashtu edhe ndaj papërgjegjësisë dhe moskokëçarjes qeveritare tek ne. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe dy deputetë janë dhe i japim përparësi opozitës gjithmonë, Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se u thanë shumë gjëra dhe gati që nuk ka mbetur pa u thënë gjë. Shumica e diskutuesve shprehën mllëfin e tyre ndaj këtij arrestimi. Një pjesë folën për armiqësinë që ka Serbia ndaj Kosovës, të tjerët folën për reciprocitetin e kështu me radhë.

Kryeministri, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Punëve të Jashtme dhe ministrja e Drejtësisë folën për motive politike të këtij arrestimi.

Asnjëri prej ministrave nuk e qartësoi, duke e përfshirë këtu edhe kryeministrin, se cili është motivi politik i Serbisë për këto arrestime.

Ministrja e Drejtësisë u përpoq të arsyetonte se arrestimi i zotit Nehat Thaçi është i padrejtë, sepse Serbia nuk ka juridiksion në Kosovë dhe nuk është përgjegjëse as për krimet e supozuara në Kosovë.

Në fakt, motivi politik i arrestimit të Thaçit është ky: Serbia nuk e njeh shtetin e Kosovës; Serbia konsideron se Kosova është pjesë e saj, prandaj edhe bën arrestime të tilla.

Pa e rregulluar çështjen e njohjes si element bazë të reciprocitetit me Serbinë, nuk do të ketë normalizim të marrëdhënieve dhe do të ketë vazhdimisht arrestime të qytetarëve të Kosovës, sepse Serbia e konsideron vendin tonë si pjesë të Republikës së Serbisë, ndërsa qytetarët e saj, qytetarë armiq.

Pra shtrëngoni duart sa të doni me Vuçiqin e Tadiqin, por të gjitha këto do të jenë të kota.

Unë po i kthehem prapë problemit me zotin Nehat Thaçi. Unë nuk e njoh zotin Nehat Thaçi, nuk ia njoh familjen, nuk ia njoh as të kaluarën dhe të tashmen, nuk e di se çfarë njeriu është, por e di që është komandant i Policisë në Mitrovicë dhe ka qenë luftëtar i UÇK-së.

Derisa Qeveria e Kosovës legalizon, u jep rroga dhe i integron brenda sistemit policor të vendit rreth 450 policë të Milosheviqit, policia serbe i arreston policët tanë. Ky është rezultati i bisedimeve me Serbinë.

Ky Thaçi i arrestuar, edhe sikur ta kishte emrin Hashim, kisha për të ngritur zërin kundër këtij arrestimi, sepse bëhet fjalë për një qytetar të Kosovës.

Unë sot dua t'u drejtohem policëve të Kosovës, një pjesëtar i të cilëve është arrestuar padrejtësisht.

Kosova ka sot rreth 9 mijë policë. Unë besoj që shumica e tyre janë qytetarë të ndershëm, djem e vajza, burra e gra që e donë vendin tonë, që e donë shtetin e tyre dhe që angazhohen profesionalisht që ky shtet të funksionojë.

Këtu bëjnë përjashtime ata policë që janë kthyer në vegël qorre të politikës, që janë policë partiakë, që po dhunojnë shtetin, që bëjnë montime faktesh, procesesh, që inskenojnë fakte, që hyjnë me pushkë të gjata në zyrat e “Vetëvendosjes”, që arrestojnë deputetë dhe i ngrehin zvarrë, arrestojnë aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Pra, këta bëjnë përjashtim nga këto që dua t’i them tani.

Kjo Qeveri policët nuk i mbron. Kjo Qeveri i dërgon policët në veri dhe i bën mish për top.

Kjo Qeveri nuk u siguron as sigurime shëndetësore, as sigurime jetësore, edhe pse këta trupin çdo ditë e kanë në rrezik.

Kjo Qeveri nuk i ka krijuar as kushtet minimale për punë dhe u jep atyre rrogat minimale.

Unë njoh një pjesë të vogël të tyre personalisht dhe dua t’ju flas për një rast, gjatë arrestimit tim. Një polic, i krimeve të rënda, ushtar i UÇK-së, ka qenë dy vjet në luftë, pas përfundimit të luftës ka studiuar Juridikun. Është angazhuar maksimalisht që ky shtet të funksionojë dhe në një moment të caktuar, më thotë: Faton, kam vetëm një qëllim jetësor, dhe kur e pyes, cili është ky qëllim i yt jetësor, thotë: “I kam 3 fëmijë, nuk po i ngop dot me bukë, kam punuar 3 muaj jashtë orarit të punës dhe nuk po arrij ta kompensoj, sepse s’po marr kompensim për këtë punë. Qëllimi im është që këta fëmijë të mi t’i nxjerr jashtë vendit. Ishalla kallet ky vend”, thotë polici, i mllëfatur dhe i inatosur me gjendjen në të cilën ndodhet ai dhe ndodhen policët e tjerë të ndershëm të Kosovës.

Mendoj se është shumë e dhembshme kur një ushtar i UÇK-së, kur një polic i ndershëm vjen në situatë kur duhet të thotë: “Ishalla kallet ky vend, sepse këtu gjithçka është e korruptuar, gjithçka është e shkatërruar”.

Policë të nderuar, pra po flas për atë pjesën dërrmuese të policëve të mirë, jo për ata që janë të kapur nga shteti.

Ju e dini që në Kosovë ka pasur protesta të ndryshme të studentëve, të mjekëve, të arsimtarëve dhe të gjithë të tjerëve, prandaj ju ftoj që edhe ju të organizoheni e të mbroheni vetë, që të protestoni para Qeverisë dhe të kërkon t’ju mbrojë prej arrestimit nga Serbia, t’ju siguroj shëndetin, t’u sigurojë jetën, t’u japë paga që ju i meritoni dhe që të mos luajë me fatin tuaj ashtu siç ka luajtur me fatin e zotit Thaçi, i cili ka disa ditë që qëndron në burg, për arsye se kjo Qeveri nuk e ka kryer detyrën e saj.

KRYETARI: Bekim Haxhiu. Deputetë të tjerë të lajmëruar për diskutim nuk ka. Është lajmëruar edhe një deputet, nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

U thanë shumë çështje sot sa i përket kësaj kërkesë për debat lidhur me arrestimin e komandantit të Policisë, zotit Nehat Thaçi.

Sigurisht se nuk do t'i përsëris ato që i thanë kolegët deputetë, por gjithsesi mund të them se nuk është rast i vetëm arrestimi i qytetarëve tanë në Republikën e Serbisë, arrestime prej vitit 1999 edhe pas pavarësisë së Kosovës me akuza e fabrikime të ngjashme janë arrestuar edhe plot qytetarë të Republikës sonë, disa nga ta, të cilët janë kthyer nga bota perëndimore, e disa të cilët për arsye të ndryshme, qofshin shëndetësore apo të tjera kanë kërkuar ose janë detyruar të kalojnë përmes Serbisë, na pamundësi të tjera.

Reagimet e institucioneve tona kanë qenë të ngathëta, kryesisht këta qytetarë ashtu sikur tani edhe zoti Thaçi detyrohen që përmes avokatëve, pra ata qytetarë në të kaluarën, edhe pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për ndonjë akuzë krejt banale, ndonjë konflikt me qytetarët ose ndonjë konflikt i viteve të 80-ta e më herët ka ndodhur që ata të ndalen në Republikën e Serbisë e të arrestohen dhe pastaj që ata të paguajnë shuma të mëdha të parave për lirin e tyre për akuza vërtet të fabrikua.

Kur jemi te pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjithsesi mund të themi se Serbia fillimisht, pas çlirimit të Kosovës, kishte dënuar në mungesë koka të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe menjëherë pas luftës, pas çlirimit të Kosovës, kishte vazhduar me metodën e njëjtë që t'i riaktualizojë ato fabrikime dhe përmes elementeve të caktuar fillon një gjyqësi, tani e dytë, ndaj bartësve të luftës, pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, fillon përmes gjyqësisë së UNMIK-ut, ku Serbia duke fabrikuar akuza i riaktualizon ato.

Përveç kësaj, këtu në këtë foltore, kur e kemi miratuar për herë të parë vazhdimin e mandatit të EULEX-it kam thënë që huqja në drejtësi e EULEX-it ka qenë kur akuzat e fabrikua të Serbisë përmes elementëve të caktuar, të deponuara në gjyqësinë e UNMIK-ut, policinë e UNMIK-ut, po edhe EULEX-i i ka marrë ato blanko dhe pastaj ka filluar që me ato të punojë.

Dhe përveç kësaj, u desh edhe një drejtësi tjetër për pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me insistimin e faktorit ndërkombëtar, por gjithsesi të ndihmuar edhe nga disa shqipfolës, nga disa që sponsorizuan edhe ata që u quajtën Dik Marti, apo David Filips dhe aranzhuan bashkëpunimet me ta dhe tani këtu derdhin lot krokodili për pjesëtarët e UÇK-së, por janë të njëjtit, ama të njëjtit që ndihmuan Dik Martin, David Filipsin për të drejtuar gishtin për çdo gjë nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Tani ndihen komodë dhe devijojnë tema të caktuara këtu, jo pse e kanë hallin te Nehat Thaçi, por e kanë hallin pse atje s'kanë mund ta çojnë Hashim Thaçin. Kjo është arsyeja. Janë të njëjtit që me vite e vite pas luftës për të arritur qëllimet e tyre politike kanë ngritur akuza dhe bashkëpunim me Dik Martin dhe shërbimet serbe për të ngritur këto aktakuza të fabrikuara ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Bashkëpunimi i institucioneve të Kosovës dhe të drejtësisë me mekanizmat ndërkombëtarë është më se i domosdoshëm.

Por nëse kemi kaluar nëpër këto faza të drejtësisë dhe gjyqësisë, gjyqësinë e UNMIK-ut, gjyqësinë e EULEX-it, gjyqësinë vendore, atëherë pse u dashka që pjesëtarët tanë të kenë edhe një gjyqësi në një shtet tjetër. Nëse këtu përfundon gjyqësia, në Kosovë për pjesëtarët dhe qytetarët e saj, atëherë sigurisht se Ministria e Drejtësisë dhe në veçanti institucionet tona këtë çështje duhet ta ngrijnë në mekanizmin ndërkombëtar, të cilët kanë qenë insistues dhe iniciatorë që vërtet të krijojnë një gjykatë speciale, e cila në mënyrë të paanshme do të vërtetojë luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Atëherë pse u dashka që edhe në Serbi të ketë edhe një gjykatë tjetër, e cila prapë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do t'i trajtojë. Mendoj se është non-sens që vërtet këto çështje ndodhin, e këto duhet të ngriten në një instancë më të lartë shtetërore.

Çështja tjetër është se këtu ka pasur ide të ndryshme. Ky problem ndoshta ka mundur të zgjidhet edhe më lehtë se sa me një debat parlamentar, por është mirë që ky debat u bë sot në Kuvend dhe të gjithë nga ne japim këndvështrimet dhe qëllimet, të cilat i paraqitëm ashtu si jemi këtu të zgjedhur të popullit dhe është mirë që këtë temë e trajtuam në këtë formë.

Po ndoshta sikur të ishte një reagim më spontan, që do të ishte një reagim ose mendim i qytetarëve edhe unë po e paraqes këtu, për shembull, përmes Republikës së Kosovës kalojnë me dhjetëra oficerë të policisë dhe MUP-it serb, dhe sikur në të njëjtën formë të ndalohej ndonjëri prej tyre, sigurisht se atëherë mund të vijë te reciprociteti në mes të dy ministrive të brendshme dhe dy shteteve të pavarura e sovraane.

Unë mendoj se të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës viteve të fundit janë duke e bërë, po edhe në të kaluarën e kanë bërë, punën e tyre me nder dhe përkushtim dhe një nga ata ka qenë edhe zoti Nehat Thaçi, i cili, vërtet në regjionin e Mitrovicës ka ndikuar pozitivisht që gjendja e sigurisë të jetë më e mirë, jo e kënaqshme, por të jetë më e mirë se që ka qenë në të kaluarën në regjionin e Mitrovicës dhe kjo është shqetësuese, sigurisht edhe për institucionet tona, po edhe për vetë Policinë e Kosovës.

Gjithsesi mund të themi se këtij kontributi për policët tanë që të jenë në shërbim të qytetarëve të Kosovës i ka shërbyer Qeveria e Kosovës në të kaluarën, duke ngritur pagat për ta, duke i bërë pagat të dinjitetshme, unë nuk besoj, ama hiq nuk besoj që një polic i Kosovës sot vuan për kafshatë të gojës.

Pagat e policëve të Kosovës nuk janë më të mirat, por mund të jetohet dinjitetshëm me to në Kosovë. Sigurisht se xhepi shpenzon aq sa ka dhe njeriu shpenzon aq sa ka, por mendoj që edhe për rrezikimin në punë policët paguhen.

Sigurisht se kolegët e Komisionit Parlamentar për Siguri e dinë këtë çështje dhe janë më shumë afër këtyre problematikave, por nuk është e vërtetë se policët e Kosovës heqin për kafshatën e gojës.

Këtë desha të them dhe kërkoj që institucionet tona, në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare, këtë problematikë, jo vetëm të Nehat Thaçit, por edhe të pjesëtarëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe qytetarëve të tjerë të Republikës së Kosovës, të cilët po ndalohen në Republikën e Serbisë t'u vijë fundi dhe të vendoset pikë e të mos kemi më këto probleme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi gati në përfundim të debatit! Nënkryetari i Kuvendit e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë i kisha disa fjalë t'i them dhe në pikën tjetër u detyrova t'i them nga foltorja dhe e mora një gjysmë vërejtje. S'kishte kush më zëvendëson, e tash kam të drejtë të flas këtu, në këtë foltore, që po i thoni e deputetëve.

Pra, 45 deputetë kanë nënshkruar një kërkesë për seancë të jashtëzakonshme, me një formulim debat parlamentar me rastin e arrestimit të drejtorit të Policisë së Kosovës në rajonin e Mitrovicës, Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë.

Saktë, kjo që ndodhi sot ka ndodhur pikë për pikë sipas formulimit, që i bie – po me rastin, por jo edhe për rastin. Kalimthi për rastin, por me rastin po bisedojmë.

Unë i kam dëgjuar të gjithë, se edhe me detyrim e kisha, po edhe mbaja shënime. Natyrisht, dikush ka kaluar përtej kësaj, por dominanca është kjo.

Pra, u diskutua për shumë probleme, që lidhen me raporte shumë të koklavitura, të rënda, shumë të vështira ndërmjet dy vendeve, Kosovës dhe Serbisë, dy vende që historikisht e gjeografikisht janë fqinj qoftë për të mirë, qoftë për të keq, edhe dikur, edhe dje, edhe sot, edhe nesër.

Tash, u diskutua me kritere ndërkombëtare për lëvizjen e lirë, thuaja se jetojmë në territore e në koordinata gjeografike që lëvizja e lirë është ABC e qytetarëve. S'është e vërtetë! Lëvizje më të palirshme se në Ballkan s'ka, e lëvizje më të palirshme se në Kosovë, e sidomos nëpër Serbi s'ekziston. Në Evropë, jo! Dhe këtë vetëdije e kemi ne, s'e nuk jemi ne këtu, edhe në këto banka, po edhe njerëz ordinerë të Kosovës e dinë këtë punë.

Prandaj, diskutimi po merr kahe shumë kundërshtuese, këndeje kërkohen kritere ndërkombëtare e lëvizjes së lirë se është e drejtë qytetare, e në anën tjetër, thuhet se Serbia është djalli vetë, sidomos karshi shqiptarëve. Po e përkufizoj me një figurë, por pak a shumë kështu edhe po thuhet.

Atëherë, duhet të ketë vetëdije çdo njëri, qoftë funksionar në Kosovë, qoftë deputet, qoftë qytetar, që nëse kalon andej, kalon në një terren të tillë, se edhe librat e shenjtë e librat e urtisë që i respektojmë të gjithë, s'po them popullore, tash po flas për libra të shkruara, edhe ato bile që e kanë filozofi dashurinë në mes të njerëzve, si ungjijtë, diku-diku bile shumëkund thonë: "Mos shko atje ku nuk të duan". Janë libra të shenjtë, e kanë filozofi dashurinë në mes njerëzve. Është empiri.

Prandaj, nganjëherë duhet të ketë njeriu vetëdijen në kohën e të hapësirës ku jeton dhe, fundi i fundit, të mos i bie bile vullnetarisht atje ku s'të duan, nëse s'je i detyruar.

Nuk më pëlqen as kësaj radhe, as kurrë diskutimi nga pozita e shpifur, e forcës vetjake, duke i rënë gjoksit saqë dikujt-dikujt edhe iu ka bërë gropa në gjoks duke i rënë. Mirëpo, është shumë paradoksale që po këto fjalime po t'i merrni përfundojnë me një lutje, më në fund dhe me një shpresë, që është kontradiktë e madhe. Nuk rrinë bashkë. Do të duhej pak racionalisht të pajtohen këto kërkesa.

Prandaj, ne shkojmë në një situatë të një autodestruktiviteti pa kufij për vetveten dhe njëfarë kujdesi engjëllor për të tjerët, e pastaj ne i përziejmë çka mund të marrim vendim ne, a po marrim drejt, dhe çka do të marrin të tjerët për ne. Prandaj ne e nisim me rrahje gjoksi personale vetvetes dhe e mbarojmë me shpresën që bashkësia ndërkombëtare, miqtë tanë etj., do të merren me ne. Jo, s'do të merren përditë dhe jo në çdo rast, sepse ata kanë edhe interesa të veta, së pari dhe, së dyti, nuk jemi ne interesi i gjithë globit sot, dhe duhet ta dimë këtë punë.

Pra, diferencimi edhe në këtë rast dhe në të tjerët është çka mund ne të marrim vendim, a po marrim mirë dhe tutje çka mund të kërkojmë nga të tjerët që ne s'e marrim atë vendim, sepse ne e nisim se jemi zot të vetvetes dhe e mbarojmë në lutje te ndërkombëtarët.

Për bisedimet. Tash meqë nuk u bisedua shumë për rastin, po me rastin, u fol edhe për bisedimet.

Thënë të drejtën, e kam njëfarë të drejte morale të flas si tash, si para tre vjetësh e kusur kur janë votuar me fuqi kushtetuese ato bisedime. Këtu të gjithë e dinë kush qysh ka votuar e pse ka votuar. Ka që kanë votuar atëherë dhe kanë harruar që kanë votuar e tash bërtasin pse janë votuar, po evidencat ekzistojnë.

Unë nuk dua të përsëris asgjë. Krejt çka kam pasur, e kam thënë në ato 7-8 herë që kemi biseduar në Kuvend për bisedime dhe nuk shtoj asgjë.

Veçse, po them që çdo ndryshim i saj e do një fuqi tjetër kushtetuese të tillë, prandaj unë thashë nuk është puna, edhe këtu çka kërkohet, varet çka shkruhet - a i do, a do votim kushtetues a jo.

Unë mendoj se në gjendjen që është tash, është shumë më komode, më politike, më e saktë, më e mundshme të jetë efektive e të thuhet - nuk bisedojmë dhe s'bëjmë marrëveshje të reja, meqë i bëmë 7 a 8 e s'është realizuar asnjëra. Po presim. S'po bisedojmë më dhe s'po tentojmë marrëveshje të reja, le të zbatohen ato që janë bërë. Kjo është shumë më politike dhe të jep të drejtë më shumë moralisht në kontakt.

Thashë, unë mendoj kështu, meqë janë bërë disa, e nuk është zbatuar asnjëra deri në fund. Nuk po i listoj, ato dihen, që janë.

Edhe një herë, dhe po e përfundoj. Këtu diskutimi u bë. Dikush e tha këtu, bile njëri nga nënshkruesit, mua më duket e tha Zafiri, emri i tij është nën numrin 30 të nënshkruesit: pse e kemi bërë, sepse veç po përsërisim sendet. Ai e tha vetë. Nën 30-tësh, e ka shkruar në këtë 45-shin.

Po mirë, nëse e kërkon të jashtëzakonshme vetë, vetëdijshëm, atëherë s'duhet të protestojë pse e bën, nëse e di që përsëriten sendet, atëherë duhet ta dijë se përsëriten sendet. Atëherë mund të përsëriten sendet, sepse njeriu nganjëherë i përsërit sendet me mija herë, a – ajo e famshmja “Kartagjena duhet të rrënohet”, po e zëmë, lejohet.

Mirëpo, edhe për të jashtëzakonshme, unë e kam një tëhollim të vogël. Ky Kuvend, nëse Qeveria ka të dhëna të kualifikuara që nuk duhet të bëhen publike, qoftë në një Kuvend, ne kemi mundur në mënyrë komode të bëjmë seancë të informuar, të mbyllur, që e bën e gjithë bota nëse ka nevojë, nëse kemi nevojë, që është krejt diçka tjetër. Unë nuk di a kanë, por nëse kanë, do të mund të bëhej edhe e tilla.

Ne tash morëm një mori informatash që normalisht s'i kemi pasur të tilla. Nuk më pëlqen mënyra e personifikimit të këtyre sendeve. Njerëz jemi, njerëzit menjëherë tani kalojnë e kallëzojnë edhe situata personale. Unë e di këtu që ka njerëz se plot personale dramatike kanë, e kurrë s'i përmendin dhe mirë bëjnë që s'i përmendin.

Ky diskutim po mbaron. Unë edhe një herë po e nënvizoj - më mirë është të bëhemi më racionalë, më pak autodestruktivë, sepse ajo veç na dobëson, kot deklaron solemnisht dhe i mëshon vetvetes, e atëherë je më i dobët. Kështu që një përfundim kjo do ta marrë dhe unë mendoj që sot edhe jemi vonë, edhe s'kam parë ndonjë formulim të saktë. Në të vërtetë, është e drejtë e atyre 45 deputetëve të propozojnë një përfundim çfarë donë, por ndoshta, po e jep një propozim, është punë për ta, edhe një herë ata ta thonë, sepse më s'do të flas për këtë problem. Më mirë është ndoshta të pritët, të mblidhen, edhe në ndonjë seancë tjetër, të kalohet e të votohet, për të mos u ngutur, për t'u bërë më të mençur, më racionalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, tanimë jemi kah përfundimi. Nuk ka më asnjë deputet për të diskutuar dhe i falënderoj të gjithë deputetët, Qeverinë, të gjithë ata që e kanë pasur sinqerisht reagimin për një epror të Policisë së Kosovës, për një prind të tre fëmijëve, për një djalë, ish- luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të prindërve të vet.

Tani jemi në fazën e fundit kur faktikisht, edhe po që se dëshirojmë të procedojmë, nuk mund të procedojmë, sepse s'kemi numër të mjaftueshëm prezentë të deputetëve.

Por, ajo që do të kërkoja do të ishte mirë nga propozuesi, e unë do t'ia jap fjalën tash dhe e orientojmë edhe si seancë, por për t'ia lehtësuar proceduralisht, të harmonizojmë një tekst të përbashkët, sikur që është propozimi i propozuesit që ishte më herët dhe pastaj në seancën e radhës ta sjellim për votim. Urdhëroni, fjalën e ka propozuesi i seancës së jashtëzakonshme. Zoti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ashtu isha edhe unë, i atij mendimi që së bashkë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare të mblidhemi sonte, ta hartojmë atë tekst të rezolutës, së bashku me rekomandimet e me dëshirën time dhe të gjithë deputetëve sonte do ta kishim votuar për faktin se Nehati ndodhet në burg, nuk ndodhet në liri.

Por, unë kërkoj mirëkuptim nga grupet parlamentare apo nga shefat e grupeve t'i ftoj në deputetët, sepse seanca është e një rëndësie të veçantë. Dihet se ne si Parlament i Kosovës që sot me orë të tëra qëndrojmë deri në mesnatë dhe Nehati e meriton të qëndrojmë jo vetëm deri në mesnatë, por edhe deri në mëngjes dhe deri nesër të qëndrojmë këtu, pra 24 orë.

Prandaj, mendoj se ju jeni ata që vendosni. Propozimi ynë është që ne të mblidhemi së bashku me përfaqësuesit e grupeve dhe pas një periudhe të shkurtër, sonte ta votojmë këtë dhe sado pak t'i ndihmojmë Nehatit, t'i ndihmojmë Kosovës dhe ta zgjidhim këtë problem në mënyrën më të mirë të mundshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pra, ndërkohë kemi një propozim konkret. Shefat e grupeve parlamentare, përkatësisht ju, të nderuar deputetë, e merrni vendimin. Urdhëro, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Së pari, falënderoj deputetët dhe përfaqësuesit e Qeverisë. Kjo që dëgjuam sonje na lehtëson dhe nuk e zbeh aspak shqetësimin tonë për zotin Thaçi. Do të kishim edhe ne dëshirë që sot të kryhej ky qëndrim, kjo rezolutë, por nuk varet edhe krejt nga ne që t'i sjellim deputetët, sepse disa janë me angazhime jashtë.

Nëse i kemi këtu, do ta bëjmë, nëse jo, ne veç kemi caktuar paraprakisht si Grup Parlamentar një deputet që të merret me tekstin e rezolutës, është kjo zonja Selvije Halimi. Prandaj, nëse janë të gjithë dakord, edhe ne do të jemi, e nëse jo, atëherë le të caktohet një grup i deputetëve, nga grupet parlamentare, por edhe deputetë të tjerë që kanë qenë nënshkrues dhe sikur që zoti Shqip Muja e kishte një tekst dhe le të takohen e të harmonizohen për një dokument qoftë në këtë seancë, qoftë në seancën tjetër, ne ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Salih Morina, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Gjithashtu, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e mbështet debatin i cili u zhvillua sot si nga ana e Qeverisë, e po ashtu edhe nga ana e deputetëve. E kemi pak vështirë për shkak të rrethanave specifike që një numër i deputetëve nuk banojnë në Prishtinë, por banojnë në regjione të ndryshme dhe po ashtu një numër i deputetëve janë edhe jashtë vendit, kështu që ne pajtohemi të formohet grupi dhe nga radha e Lidhjes Demokratike ne e propozojmë deputetin Armend Zemaj të jetë pjesë e hartimit të kësaj rezolute dhe mendoj që e kemi pak vështirë që sonje të ftohen deputetët, por të shohim mundësinë që seanca të thirret ndoshta në një afat sa më të shpejt. Por, e mira është që të hartohet rezoluta dhe të ketë konsensus në mes të subjekteve politike, të cilat e përfaqësojnë Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca nga Lëvizja “Vetëvendosje” e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Pajtohem me propozuesin e këtij debati që rezoluta është mirë të kryhet sot, por sa po kuptoj, prej administratës numri i deputetëve të pranishëm nuk është as për së afërmi i mjaftueshëm që kjo edhe të votohet.

Mirëpo, do të thosha që ose sonje ose nesër të vazhdojë kjo seancë dhe menjëherë të nxirrej ajo rezolutë pasi të përpilohej prej përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Si duket, as 50 deputetë nuk janë të pranishëm. Pra, janë 44 deputetë, ndoshta të pamjaftueshëm që kjo të bëhet, por kjo nuk na pengon që t'i koordinojmë të gjitha qëndrimet dhe të vijmë te formulimet e përbashkëta se çka do të përmbajë kjo rezolutë.

Kurse, sa i përket votimit, sonte po më duket është shumë pesimiste situata.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Pal Lekaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Falënderoj të gjithë deputetët që dhanë kontributin e vet sa i përket çështjes që është me rëndësi, e Nehati t'i kthehet familjes dhe mendoj që ne, si deputetë, duhet të jemi korrektë edhe me vetveten dhe unë nuk mendoj që asnjë deputet e ka shfrytëzuar foltoren për të keqën e dikujt, por për të mirën e proceseve dhe mendoj që e kanë dhënë kontributin e vet.

Unë mendoj se një përpilim i rezolutës duhet të ndodhë, mirëpo sot po shihet se nuk mund të jetë miratimi i kësaj rezolute dhe mendoj që nuk është vonë edhe nesër të ftohen deputetë që ta votojmë rezolutën, sepse atëherë nuk ka kuptim nëse vonohemi, sepse ndoshta edhe Qeveria nuk merr obligime sikur që edhe deri sot s'ka marrë, por mendoj se në këtë drejtim ne duhet ta themi tonën dhe të miratohet një rezolutë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Qerim Bajrami nga "6+" e ka fjalën dhe le të bëhet gati Haxhi Shala nga Grupi "Nisma".

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Mislim da je dobar predlog da se sutra sastanem i spremimo dobru rezoluciju i da, ili u toku sutrašnjeg dana ili u najkraćem roku, se ona izglasa, uzimajući u obzir sve današnje diskusije vezano za problem hapšenja gospodina Thačija. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka zotëri Shala, nga Nisma!

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë dua t'i falënderoj të gjithë deputetët, të cilët kontribuan lidhur me çështjen e arrestimit të Nehat Thaçit.

Edhe ne si grup e kemi kandidatin tonë dhe do të kontribuojmë në përpilimin e kësaj rezolute dhe pres që sonte të përpilohet një tekst dhe nesër të thirret seanca për ta aprovuar, sa më shpejt që është e mundshme, lidhur me çështjen e Nehat Thaçit që gjendet në burg. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë e mora obligim që në emër të grupit dhe jam i gatshëm të kontribuoj në hartimin e një draft-rezolute, e cila do t'i paraqitet Kuvendit të Kosovës për miratim, për rastin në fjalë, por duhet të jemi të sinqertë me rastin për të cilin po debatojmë.

Fuqia e rezolutës, e dini të gjithë ju, deputetë, dhe ata që s'e dinë, ta lexojnë Rregulloren e punës së Kuvendit, është vetëm shprehje deklarative e vullnetit të Kuvendit për një çështje të caktuar. Prandaj, nuk besoj që ne, edhe nëse mbesim peng sonte i votimit apo i mosvotimit, nuk mendoj se me draftimin e saj dhe me votimin mund të kontribuojmë më shumë sesa veprimet që u paraqiten që i ka marrë Qeveria apo edhe ministrat. Pra, nëse dëshirojmë që të kemi deklarata të tjera politike në kuadër të kësaj, është krejt çështje tjetër dhe besoj që grupet politike do të japin mendimin e vet. Mirëpo, duhet të jemi të sinqertë, cila është fuqia e rezolutës, qoftë edhe në raport me Qeverinë e Republikës së Kosovës, prandaj është më mirë që ne këtu deklarativisht ta obligojmë Qeverinë për atë që u tha dhe në veprimet të cilat i ka ndërmarrë dhe duhet të ndërmarrë, sa më shpejt të mundësohet lirimi i bashkëqytetarit tonë Nehat Thaçi. Faleminderit!

KRYETARI: Zotëri Muja, fjala për ju!

SHAIPI MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se nuk është mirë që për vendime të tilla, nuk është duke u folur vetëm për çështjen e Nehat Thaçit, por është sfiduar Republika e Kosovës në disa drejtime. Dhe Kuvendi i Kosovës, në këtë rast është institucioni më i lartë që autorizon dhe ndihmon Qeverinë në prezantimin ndërkombëtar, duke e mbështetur në vendime që do t'i nxjerrë nga një rezolutë ose draft-rezolutë që sonte do të mund të përgatitet.

Unë jam munduar, së bashku me disa kolegë, t'i nxjerrim disa pika, të cilat do të jenë orientuese për Bashkimin Evropian, jo për Serbinë, sepse Bashkimi Evropian është fascilitues, është ndihmues dhe garantues, në një mënyrë, të bisedimeve me Serbinë. Prandaj, nga Serbia ne nuk po kërkojmë lëmshë, por kërkojmë t'i respektojë ato që edhe shumë kolegë tanë thanë, për të cilat është zotuar dhe jo të prodhojë probleme të panevojshme, të cilat ajo ka qejf të na shohë neve natë për natë duke bërë rezoluta ose bisedime të tilla.

Prandaj, ne duhet t'i ndihmojmë Qeverisë në këtë rast, nëse donë t'i ndihmojmë, dhe t'i qartësojmë raportet me Bashkimin Evropian për çështje të bisedimeve me Serbinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Propozuesi le të ketë vëmendjen! Nesër do të mbajmë seancë, sepse s'ka kuptim ta çojmë më larg, e sonte kështu-ashtu, vetëm mund ta komplikojmë situatën. Do të bëj thirrje publike që deputetët të jenë në seancë nesër në orën 10:00.

(Ndërhyrje)

Komisioni sonte duhet të jetë në gjendje, sepse po të ishit secili prej juve në burg kishit pasur qejf sonte të ishte... Tash do t'ua jap fjalën, por nesër në orën 10:00 duhet të kemi seancë të rregullt. Urdhëro, Faton! Nuk do të ikim jashtë seancës.

FATON TOPALLI: Jo, jo! Është problemi i kohës, që nesër kanë shumë komisione mbledhje pikërisht në orën 10:00, prandaj propozimi im është për orën 12, sepse është kohë pushimi, është kohë që kryhet shpejt. Ose, në orën 9:00, në mëngjes!

KRYETARI: Në orën 9:00, në mëngjes, e jo në 12:00. Dhe nuk e di pse po ikim... Në qoftë se e keni pasur me seriozitet këtë çështje sot, ta mbajmë mbledhjen ose në ora 9:00 ose 10:00 dhe e bëj publike se asnjë mëditje nuk do të merret, kjo vlen për nesër, gjatë votimit.

(Ndërhyrje)

Po, por unë e kam obligim ta them, për arsye se edhe kur nuk votohej, pastaj filluan të votojnë.

(Ndërhyrje)

Po Armend, do ta jap fjalën, por për një vendim edhe në bazë të Rregullores më takon, jam i detyruar, në orën 9:00 - 10:00, në 12:00 nuk do të jetë, sepse s'është seriozitet. Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar!

Është duke na ndjekur një opinion i gjerë dhe besoj se krahasimin me çështjen se kush rri në seancë plenare dhe kush nuk rri, edhe mediat e përcjellin dhe nuk është mirë që ndoshta të apostrofohet ajo çështja e mëditjeve se, pothuaj që janë deputetët e njëjtë që rrinë apo janë në gjendje të rrinë 24 orë derisa të përfundojë seanca plenare.

Pra, ky ishte vetëm propozim, sepse ne kemi agjendë edhe të mbikëqyrjes së ligjeve. Unë vetëm po apostrofoj që personalisht unë nga Lidhja Demokratike dhe zonja Selville Halimi e kemi një vizitë të planifikuar për mbikëqyrjen e ligjit për Këshillin Gjyqësor në Pejë. Do të thotë, është krejt një çakordim që bëhet. Prandaj, krejt çka po kërkojmë është për të gjetur një kohë të përshtatshme për ditën e nesërme që të jemi sa më shumë deputetë në Kuvend të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Po, në sa ju konvenon?

ARMEND ZEMAJ: Në 12:00, apo në 13:00.

KRYETARI: Në orën 9:00?

ARMEND ZEMAJ: Në 9:00 nisemi, sepse në Pejë duhet të shkojmë.

KRYETARI: Po le të shtyhet pak, sepse s'ka kuptim dhe bie që s'jemi seriozë.

Salih, urdhëro, merre fjalën! Ju lus, për 2 minuta, sepse po e di që jeni lodhur. Dhe, Armend, pikërisht çështja e mëditjes, zakonisht merret kush është aty dhe pikërisht se s'po flitet për ju, e përmenda mëditjen, ta kesh parasysh.

Urdhëro, zoti Morina, e keni fjalën.

SALIH MORINA: Kryetar, ne po kemi një numër të komisioneve, dhe edhe Armendi e theksoi se duhet shkuar në Pejë në orën 9:00, mirëpo mendoj se do të kishte qenë koha më e përshtatshme në orën 10:00, ashtu sikur i mbajmë gjithë dhe mendoj se duhet të dakordohen edhe të tjerët për këtë kohë.

Pra, Grupi Parlamentar i LDK-së është për në orën 10:00.

KRYETARI: Zenun, e Glauk, për orën në 10:00?

ZENUN PAJAZITI: Për orën 9:00, do të kemi pak probleme teknike. Po mund edhe në orën 10:00 dhe në cilëndo orë që ta mbajmë, deputetët agjendat e tjera duhet t'i rregullojnë për seancë. Është krejtësisht në rregull, se pas këtij debati të tërheqim diçka nga agjendat e tjera të komisioneve dhe të jemi në orën që e caktojmë këtu, në 9:00 ose 10:00.

KRYETARI: Pali po thotë në 10! Glauk?

GLAUK KONJUFCA: Unë jam për në orën 9, kryetar! Por për ty e kam, nëse nuk vjen, do të të hiqet mëditja.

KRYETARI: Publikisht mëditja ime tërhiqet, vij a s'vij. Unë do të jam. Këtë punë e bëj me qejf, të rrimë edhe gjithë natën. "6+", Qerim Bajrami e ka fjalën!

ĆERIM BAJRAMI: Kryetar, në orën 10:00!

KRYETARI: Pra, vazhdimi i seancës do të jetë nesër në orën 10:00. Grupet le ta harmonizojnë tekstin. Pra, lus deputetët që nuk janë aktualisht të pranishëm, le të vijnë për ta vazhduar seancën. Mirupafshim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 11 tetor
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë!

Ndoshta kanë kaluar një orë e 15 minuta nga momenti kur e kemi lënë seancën, megjithatë edhe për hir edhe të opinionit publik do të ishte e vështirë të fillonim seancën pa qenë 61 veta. Faleminderit për pjesëmarrje, aktualisht janë 68 deputetë në sallë.

Kabineti qeveritar nuk qenka.

I vazhdojmë punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 11 tetor 2016.

Votimi i propozim-rezolutës lidhur me arrestimin e drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, zotit Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë.

Të nderuar kolegë,

Diskutimet kanë përfunduar dje. E ftoj deputetin Gëzim Kelmendi të paraqesë propozim-rezolutën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni fillimisht t'u falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin korrekt dhe debatin që u zhvillua mbrëmë dhe sot.

Si propozues i seancën kam obligim moral dhe ligjor t'ju njoftoj se grupet punuese të cilat ishin caktuar mbrëmë të punojnë sot prej orës 9:00, kemi punuar së bashku deri në orën 10:30 dhe nuk kemi arritur një harmonizim të qëndrimeve. Kemi pasur divergjenca, mospajtime kryesisht në pikën që ndërlidhet me ndërprerjen, konkretisht pezullimin e bisedimeve me Serbinë.

Unë si propozues dhe partitë opozitare Lëvizja “Vetëvendosje”, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma dhe deputeti i pavarur, Shaip Muja, kemi qenë njëzëri që të jetë kjo pikë e rekomandimit, pikë e rezolutës, pika 10, ku kërkohet ndërprerja, konkretisht pezullimi i bisedimeve deri në lirim të Thaçit dhe deri në zhvlerësimin e të gjitha aktakuzave për ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por këtë pikë, këtë propozim timin dhe të partive opozitare nuk e kanë mirëpritur partnerët e koalicionit nga dy partitë më të mëdha dhe për këtë arsye nuk kemi mundur t'i harmonizojmë qëndrimet tona dhe unë si propozues ju njoftoj se ne nuk kemi rezolutë, do të thotë është për keqardhje se si pas debatit të mbrëmshëm maratonik, Kuvendi sot del pa rezolutë nga ana e propozuesit dhe nga ana e deputetëve, ngase ne e dimë, të nderuar deputetë, se shumë deputetë mbrëmë përveç nga opozita, edhe nga koalicioni qeverisës kanë

pasur qëndrime shumë parimore, shumë të shëndosha dhe të drejta në raport bisedimet Kosovë-Serbi, dhe nuk mund të kuptoj se si tash sot në mëngjes kërkohet të mos votohet ajo rezolutë, me të cilën kërkohet ndërprerja e bisedimeve deri në lirimin e Thaçit.

Prandaj, kjo është për keqardhje për mua personalisht, por edhe për ne si Kuvend i Kosovës, nga se kemi ndryshim qëndrimeve nga fjalimi i mbrëmshëm sot në mëngjes.

Situatën e bën edhe më të rëndë fakti se partitë tash nga koalicioni kanë propozuar një rezolutë para deputetëve më parë, para pak çasteve është shpërndarë një rezolutë, e cila nuk është e propozuesit, nuk është imja, është e tyre, e cila asgjë tjetër nuk përmban përveç retorikës së njëjtë 10-vjeçare pothuajse nga mandati i kaluar, edhe në këtë mandat, ku thuhet...“do të mundohemi” dhe “do ta bëjmë” këtë me Serbinë. Ne e kemi parë që në bisedimet në Bruksel me Serbinë përfituese ka qenë Serbia, nuk ka qenë Kosova. Asnjë marrëveshje nuk është respektuar në raport me Kosovën dhe së fundi arrestohen qytetarët e Kosovës, arrestohen bijtë dhe bijat më të mirë që ka pasur ky vend, arrestohen pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Dhe pas tërë kësaj situatë ne prapë do të themi “do ta bëjmë”, “do të kërkojmë”. Nuk jam asgjë kundër kësaj, por mendoj që retorikës së tillë jo të drejtë, jo parimore, agresive të Serbisë, ka ardhur koha t’i themi mjaft.

Ne duhet t’i tregojmë Serbisë, edhe shpeshherë e di se këtu po futen në lojë edhe partnerët ndërkombëtarë, partnerët ndërkombëtarë e kanë çmuar dhe e kanë ndihmuar luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, edhe e ndihmojnë çdo lëvizje pozitive edhe dashamirëse dhe paqësore të Kosovës. Por ku jemi ne, ta kemi të qartë një gjë, ne jemi viktimë, ne nuk i kemi vrarë mbi 20 mijë në Serbi, ne nuk kemi dhunuar 12 mijë gra në Serbi, por ka ndodhur e kundërta. Ata e kanë bërë këtë te na dhe prapëseprapë ne si viktimë nuk e kemi guximin të kërkojmë së paku të drejtën tonë morale që të ndërpriten përkohësisht bisedimet deri në lirimin e Thaçit dhe pezullimin e të gjitha fletë arresteve të tjera.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Pa dashur të zgjas më shumë, ju njoftoj se debati i propozuar nga unë. Kur jemi te debati kam obligim moral ta sqaroj edhe një gjë. Mbrëmë edhe nga kryeministri dhe sot dëgjova se Gëzim Kelmendi ka kërkuar një debat parlamentar dhe nuk ka kërkuar rezolutë dhe rekomandime. E keni parë me shkrim, kam propozuar dhe qëndroj pas asaj. Është arkivuar në Kryesinë e Kuvendit, kam propozuar kështu.

Që në fund të debatit parlamentar do të nxirren rekomandimet dhe në fund të debatit unë si propozues kam të drejtë të propozoj. Ka propozuar opozita, ka propozuar Shaipe, nuk janë pranuar, tash çka ka të keqe këtu. Dikush më tha se nuk e ke kërkuar këtë. Unë kam mundur ta

bëj edhe tjetrën, po për hir të respektit që kam ndaj jush, deputetë, nuk e kam bërë. Kam mundur kur kam kërkuar debat parlamentar të fus propozimin “të pezullohen bisedimet, të ndërpriten”.

Veç pak, mos u ngutni, të keni pak durim, tash të tregoj pse nuk e kam bërë. Pse e di që dikush prej juve s’do ta nënshkruante, edhe s’kam dashur.

(Reagim nga salla)

E po e shoh, tash po ju tregoj, po shoh që fatkeqësisht..

KRYETARI: Kolegë, ju lutem, fjalën do ta marrë kushdo, vetëm le ta përfundojë.

GËZIM KELMENDI: Fatkeqësisht, në institucionin më të lartë shtetëror mungon korrektësia, kam dashur që të jem korrekt me juve, nuk kam dashur t’i marr nënshkrimet...

(Reagime nga salla)

...vetëm pak, se ndoshta ashtu nuk kisha arritur as numrin 40. Po nuk kam dashur të dal para mediave e të them që x deputeti nuk po e nënshkruan këtë, por e kam bërë në mënyrën më korrekte dhe i kam qëndruar asaj. Është e arkivuar në Kryesinë e Kuvendit kërkesa për debat parlamentar dhe në fund të debatit do të dalin rekomandime ashtu kemi vepruar, në fund të debatit.

Sot jemi mbledhur, kemi propozuar rekomandime, secili grup, secili deputet, i kam qëndruar besnik asaj. Ndërsa asaj çka ju po thoni, vërtet është shumë e rëndë dhe shumë jokorrekte, për faktin se mbrëmë keni folur tjetër, ka pasur qëndrime nga deputetët e koalicionit, sot kemi tjetër diçka para veti.

Prandaj, unë edhe një herë falënderoj të gjithë ata deputetë që kontribuan për debat, në anën tjetër, shpreh keqardhje më të madhe se si institucioni më i lartë i shtetit nuk jemi të gatshëm pas 17 vjetëve në Kosovë, pas tërë këtyre arrestimeve të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pas tërë kësaj padrejtësie që e bën Qeveria e Beogradit ndaj nesh, së paku si viktimë që jemi, kemi qenë, ta themi hapin parimor dhe të shëndoshë, t’i themi Serbisë se nuk bisedime deri sa nuk i plotëson këto kushte. Qysh ata po na qesin kushte neve, përderisa ka të drejtë Serbia të kërkojë ndërprerjen e bisedimeve për “Trepçën”, që nuk është pronë e saj, pse ne nuk kemi të drejtë të kërkojmë ndërprerjen e bisedimeve për arrestimin e djemve tanë.

Prandaj, edhe një herë ju falënderoj për kohën, kureshtjen dhe shpreh keqardhjen më të madhe që Kuvendi nuk është i gatshëm t’i pezullojë bisedimet me Serbinë për lirimin e Nehat Thaçit.

KRYETARI: Deputet, të lutem, të lutem veç një minutë. Derisa ne po flasim, askush nuk e di pse po flasim, ju kisha kërkuar për hir edhe të opinionit publik.

A ka mundësi ta lexosh projektrezolutën, pastaj Armendit do t'ia jap menjëherë fjalën që ta lexojë projektrezolutën që edhe opinionit publik ta dijë për çka, ç'është ndryshimi.

GËZIM KELMENDI: Nuk është kjo rezoluta ime, i nderuar kryetar.

KRYETARI: S'keni, ok-ej, më fal!

GËZIM KELMENDI: Falënderoj për pyetjen, për hir të korrektësisë. Në debatin parlamentar që kam kërkuar mbështetjen e deputetëve, nuk kam kërkuar rekomandime, s'kanë propozuar.

Në kërkesën e adresuar në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës e keni ju të shkruar, është se në fund të debatit parlamentar do të nxjerrën rekomandime, në fund dhe tash nuk kemi, nga se propozimin që e kam unë, propozimin që e kanë partitë opozitare dhe Shaiپی nuk pajtohen partnerët e koalicionit dhe kjo është shumë korrekte prej anës time, se nuk kemi mundur ta draftojmë një rezolutë nga se nuk kemi përkrahje nga partitë në pushtet.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë veç për hir të korrektësisë, e rëndë është se nuk kemi një projekt-rezolutë. Sido që të jetë, Dauti e paska. Armend, t'i do ta lexosh tash, për hir të opinionit publik e paska edhe Dauti njëjtë. Armend Zemaj e ka fjalën. Urdhëro!

Ju kisha lutur, kolegë deputetë, shumë e rëndësishme që opinionit publik ta dijë për çka po bëhet fjalë, kjo është. Urdhëro, Armend!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Kjo është për hir të korrektësisë, edhe debatit të djeshëm, por mbi të gjitha është edhe për hir të korrektësisë së njerëzve që janë angazhuar në emër të grupeve parlamentare për ta nxjerrë një draft-rezolutë edhe për t'ia paraqitur Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim, apo për mosmiratim. Domethënë kjo është ajo çka po kërkohet prej neve, pa hyrë në tema të tjera, që besoj se kanë vend edhe për diskutim, qofshin të përcaktimit politik, apo të interesit të përgjithshëm të deputetëve.

Ne e paraqesim seriozitetin ndaj rastit në fjalë dhe koherencën ndaj zhvillimit të debatit të djeshëm dhe sipas kërkesës të debatit, që është bërë nga 45 deputetë, të nënshkruar. Dhe njëherësh sigurisht që Kuvendi duhet ta respektojë këtë vullnet.

Grupi i caktuar në emër të përfaqësuesve të grupeve politike është ulur, ka diskutuar, ka pasur drafte në fjalë, është munduar, të jem i sinqertë, t'i harmonizojë qëndrimet rreth pikave të përmbledhura që tash janë në këtë rezolutë. Ka një harmonizim në pikat e caktuara, qoftë nga kërkesa që e ka paraqitur deputeti Shaip Muja, qoftë nga deputeti Lahi Ibrahimaj, në emër të grupit parlamentar, por edhe në grupet politike parlamentare, nga unë dhe Selvije Halimi, gjithashtu edhe nga deputeti i cili ka përfaqësuar grupin "6+" dhe sidomos edhe bashkëpunimi shumë korrekt i përfaqësuesit të VV-së rreth qëndrimeve që keni paraqitur në aspektin procedural, por edhe mbrojtjes së qëndrimeve të tyre politike se çka mendojnë për rastin në fjalë.

Domethënë, kjo është ajo në pika të shkurtra që unë u mundova ta përmbledh, mbi të gjitha janë edhe kolegët këtu që kanë marrë pjesë në këtë diskutim.

Pa dashur ta zgjat, unë po e paraqes një rezolutë të cilën e kemi hartua bashkërisht me zonjën Selvije Halimi dhe deputetin nga Grupi Parlamentar "6+", njëherësh mendojmë që i kemi përfshirë disa kërkesa, qoftë nga debati, edhe një herë po them mendojmë që i kemi përfshirë, por edhe disa propozime, 2 apo 3 ta them më shumë kushtimisht, që janë deklaruar dhe janë sponsorizuar nga deputeti Shaip Muja, por edhe nga deputeti Lahi Ibrahimaj. Në mënyrën se si po i paraqesim kemi të drejtë edhe ne, mund t'i paraqesë edhe dikush nëse e ka një draft tjetër të hartuar.

Nëse më lejoni, unë do ta kisha lexuar rezolutën dhe janë deputetët që do të vendosin me votën e tyre a pajtohen apo nuk pajtohen. Mbi të gjitha, unë kisha kërkuar që t'u lejohet debati edhe grupeve tjera politike se çka mendojnë rreth kësaj rezolute.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 40 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më 11 dhe sot më 12 tetor 2016, pas debatit parlamentar lidhur me arrestimin e zotit Nehat Thaçi, epror i Policisë së Republikës së Kosovës nga autoritetet e Serbisë, nxori këtë:

R E Z O T U L Ë

1. Bashkimi Evropian, si ndërmjetësues dhe garantues i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nëpërmjet mekanizmave të tij, të ndërhyjë te Qeveria e Serbisë që të lirohet zoti Nehat Thaçi.
2. Çdo komunikim për rastin e arrestimit të zotit Nehat Thaçi deri në lirimin e tij të bëhet vetëm nëpërmjet Zyrës së Mogerinit, si Përfaqësuese e Lartë e BE-së. Kjo ka dalë edhe nga ato që kemi marrë dje, dy shkresat që u janë drejtuar institucioneve ndërkombëtare që janë në Kosovë, Zyrës së BE-së edhe Zyrës së EULEX-it nga ministritë e linjës që dje janë paraqitur këtu.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës t'ia bëjë me dije BE-së se veprimet e tilla të Serbisë në

raport me institucionet dhe qytetarët e Kosovës po e rrezikojnë thellë përmirësimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe dialogun ndërmjet dy vendeve, duke na detyruar në reciprocitet.

4. Misioni i EULEX-it të deklarohet për rastin e zotit Thaçi, njëherësh kërkojmë angazhim të drejtpërdrejtë si mision me kompetenca të veçanta, dhe

5. Ka qenë kërkesë ndoshta më shumë deklarative, por që është interes i përgjithshëm, ta quaj kushtimit në anëtarësimin e institucioneve të sigurisë në institucionet kredibile ndërkombëtare. Kërkojmë nga Interpoli që Policia e Kosovës të bëhet pjesë e kësaj organizate, njëherësh insistojmë që fletarrestet politike të largohen nga sistemi i tyre ligjor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë Daut Haradinaj e ka fjalën.

Të nderuar kolegë, tek unë janë dorëzuar dy projekt-rezoluta, e kjo është arsyeja pse kërkoja. Daut Haradinaj e lexon tjetrën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë i kam dy rezoluta para vetes, edhe me sa po i shoh vetëm një pikë këtu nuk harmonizohet, domethënë edhe për këtë po nxitohen ndoshta koalicioni.

Pika diskutonte, ose pika jo në harmoni me opozitën, është shumë e qartë, kërkesa është eksplicite - ndërprerja e dialogut me Serbinë edhe kurrëgjë kurrëgjë. Del se pushteti duhet thënë që ne kërkojmë vazhdimin e dialogut, se nuk na shqetëson arrestimi i tij.

Do të thotë kryetar, rezoluta e propozuar prej 40 deputetëve, e iniciuar prej Gëzim Kelmendit, deputetit, e ka vetëm një pikë, e cila është kryesorja dhe që kërkon pezullimin e dialogut me Serbinë deri në lirimin e zotit Thaçi. Nuk ka asnjë gjë të paqartë këtu, unë s'po di pse nuk po e thoni me zë, bile t'u marrim vesh.

Gjithçka çka e lexoi Armend Zemaj jemi për. Shumë bukur është, prefekt është rezoluta, por i mungon edhe një resht - ndërprerja e dialogut.

Edhe unë mendoj që nuk do të ishte e tepërt të futet ky rresht. Po na vjen keq që nuk e kemi askënd të Qeverisë këtu e të dëgjojnë pak edhe ata, sepse mendoj që ai zyrtari i Policisë, ish dashur ministri i Punëve të Brendshme të jetë këtu i pranishëm e të na tregojë a ka pasur leje ai së pari për të shkuar në Serbi, a ka marrë...

(Reagime nga salla)

Sa herë ka qenë në Serbi para këtij rasti? Pse nuk është arrestuar deri në këtë rast? A e kanë lejuar autoritet serbe deri në mundësinë e fundit kur e kapën? Shumë pyetje janë, por aty hyjnë sot.

Tema e diskutimit është a po e futim edhe këtë pikë, a nuk po e futim? Shkurt, a ta ndërpresim dialogun me Serbinë deri në lirimin e tij dhe pastrimin e listave, apo si do t'ia bëjmë?

Dy rezoluta janë para juve, votojeni cilën doni.

Pa e lexon 100 herë, o Profesor. Qeveria e Kosovës ta ndërpresë dialogun deri në lirimin e zotit Nehat Thaçi. Asgjë tjetër s'ka. Pikë! Kaq! Më thjesht nuk ka. A po e ndërpresim dialogun me Serbinë, a nuk po e ndërpresim, po e vazhdojmë.

(Reagime nga salla)

Po shumë e mirë, por po i mungon edhe ky rresht. Pse nuk është e mirë Profesor, thuaje në mikrofon! Hajde thuaje burrë, hajde unë këtu po rri e po të dëgjoj. Shumë qartë! Po, hajde urdhëro! Thuaje me mikrofon!

KRYETARI: Nënkryetari i Kuvendit e di edhe gjuhësisht. Unë po shoh shumë dallim nga kjo çfarë tha deputeti Daut Haradinaj, por tash... Por, gjuhësisht do të kishte mundur të na ndihmojë nënkryetari dhe do ta kishim përfunduar shpejt, në qoftë kemi pajtim.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ju e dini që i fundit fola mbrëmë se e dija që mbërrim këtu. Merreni shiheni a jemi a s'jemi aty? Jemi! Se e kemi një propozim-rezolutë që i ka pesë pika, të cilat janë, ta shikoj e rrahagjoksi ka rënë pak, por të tjerat krejt janë variacione prej kërkesës në lutje. Merreni, lexojini!

Opozita tha që kjo për perfekte, por i mungon një fjali. Unë po e them atë fjali thojeni ju se nuk jam propozues, por unë po ju them as kjo s'është hiç perfekte. Ja shumica e paska, po meqë jemi në Kuvend unë kam të drejtë. Nuk është perfekte, sepse problemi themelor, zonja dhe zotërinj, pse jemi mbledhur dje, është se 45 deputetë kanë kërkuar seancë të jashtëzakonshme, nuk është kjo çka po thuhet këtu, por është arrestimi i një njeriu, një qytetari, që është edhe funksionar i Policisë së Kosovës dhe, meqë ai është thelbi, pika numër një e kësaj të ashtuquajture rezolutë, nëse s'është ajo, kjo s'ka të bëjë me këtë punë. Kjo është variacion.

Duhet të thuhej: Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon lirimin e menjëhershëm të zotit Nehat Thaçi nga burgu i Serbisë. Pikë! Nëse nuk ekziston kjo, krejt tjerat janë variante politike, që ne mund të bëjmë përditë për gjithçka. Ju po thoni është perfekte, nëse është kjo. Unë mendoj që s'është. Kjo nën një do të duhej të ishte, numër një. Kuvendi le të marrë diçka mbi vete. Lini

hajgaret! Jo ne jemi organi më i lartë, tani kurrkund Kuvendi, pos në fillim është. Po merrini përgjegjësitë, pra! Ju po i degazhoni lehtas tash. Diçka po i jepni Qeverisë, BE-së patjetër, Mogerinit gjithsesi, një lutje për Interpol po. Kjo thjeshtohet.

Pra, Kuvendi e merr të vetën, në të dytën çka do të bëjë Qeveria, në tretën çka kërkoni prej ndërkombëtarëve. Unë nuk po bëj formulime, s'i jap të drejtë vetes. Do të mund t'i bëja gjitha, por jo se unë po shoh që i keni dy variante. Prandaj, unë e luta përfaqësuesin e opozitës që ta kem atë letër në dorë për ta analizuar në këtë formë, jo për tjetër. Faleminderit! Ditën e mirë e bëfshi!

KRYETARI: Ndërkohë, edhe pesë veta fjalën e kanë kërkuar, por a do të kishte pasur mundësi që të ulen e të na e formalizojnë një propozim të përbashkët. Jo për konsum politik, e njeriu në burg, të gjithëve do të jua jap fjalën, asnjë s'do të mbetet pa folur.

Vjosa Osmani e ka kërkuar fjalën. Atëherë Vjosa largohet. Atëherë veç Visar Ymeri, e deputetët s'kanë fjalë më. Vetëm grupet parlamentare.

VISAR YMERI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

Edhe sot këtu e pamë një dëshmi jashtëzakonisht të keqe të kequdhëheqjes së seancës se si Kadri Veseli u mundohej me çdo kusht të na e ndalë fjalën Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", në emër të cilit po flas tash.

Dua të flas më së pari për rezolutën që na është dorëzuar, e cila u quajt si rezolutë e konsensusit, edhe pse u pa që nuk qenka rezolutë e konsensusit dhe disa prej problemeve të kësaj rezolute tashmë u realizuan edhe nga profesor Hamiti, edhe nga deputeti Haradinaj. Por, unë mendoj që kjo rezolutë është nëse e lexon me vëmendje e kotë, E kotë edhe në propozime, e që besa është në shpërputhje flagrante me atë që është diskutuar dhe në seancë. Pra, kjo rezolutë nuk e merr parasysh fare çfarë është thënë dhe në seancë, edhe e shtrembëron atë deri në dhimbje, që i bie faktikisht që deputetët që kanë folur dhe, e secili prej tyre në forma të ndryshme kanë kërkuar edhe ndërprerje të dialogut me Serbinë, e që besa nëse tre krerët institucionalë të Kosovës nuk i dalin zot vendit, atëherë duhet të shkojnë deri në kërkimin e dorëheqjes. Sot në rezolutë pasqyrohet një diçka krejt tjetër.

Unë nuk e di se çfarë ëndrrash shihni gjatë natës, ose me kë flisni para se të bini të flini. Mirëpo, ky ndryshim i qëndrimeve gjatë natës është kah bëhet problem serioz politik në Kosovë. Krejt një gjë e kemi në mbrëmje, ose pasdite, e krejt një tjetër mendim pastaj në mëngjes. Ju kisha lutur të mos hani mëngjes para se të vini këtu se po më duket është kah ju mundon.

Tash për rezolutën. Këtu, siç e përmendi edhe profesor Hamiti, edhe jam plotësisht dakord me të, ajo në njëfarë mënyrë nuk i jep kurrfarë obligimi as Qeverisë, as Kuvendit. Pra, kjo rezolutë

synon ta obligojë Brukselin, por jo Qeverinë e Republikës së Kosovës. Thua ti jemi duke diskutuar këtu në Parlamentin Evropian. Krejt kërkesat dhe lutjet janë ndaj Brukselit dhe mendoj që këtë absolutisht ne mund ta votojmë si Kuvend, por është e kotë, nuk thotë gjë kjo. Ne me rezolutat e Kuvendit shpeshherë kemi dështuar ta obligojmë edhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, e lëre më tash po duam ta obligojmë Mogerinin që ajo të angazhohet për lirin e Nehat Thaçit.

A po kuponi çfarë po them? Pra, në njëfarë mënyre me këtë rezolutë po përvidhet e pavetëdijshmja jonë si deputetë. E kjo e pavetëdijshme që po përvidhet këtu, që po vjen nga ju që po e përkrahni këtë rezolutë, është se në fakt jeni duke e pranuar që Kosova nuk është shtet sovran.

Pra, po thoni veç Brukseli mund të na shpëtojë, se që po e shpëtojmë ne vetë, harroje këtë punë. Këtë po e thotë kjo rezolutë, edhe Brukseli natyrisht që s'na shpëton, sepse ne veten s'po duam ta shpëtojmë, e aq më pak s'po duam ta shpëtojmë Nehat Thaçin. Sepse, në këtë rezolutë a di çka po i themi Serbisë: "Mbajeni Nehat Thaçin sa të duash se ne ndërmend s'e kemi të bëjmë kurrëgjë hiq për këtë punë".

Pra, nëse vendos Mogerini të kërkojë lirin e Nehat Thaçit, ndoshta edhe lirohet, po që po e kërkojmë ne, harrojeni këtë punë prapë. Pra, këtë po e themi me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, organit më të lartë legjislativ edhe vendimmarrës në Republikën e Kosovës. Kjo për mua është mohim i shtetësisë së Kosovës, ju mund të thoni çka të doni.

Pastaj, shikoni çfarë ka, për shembull, kjo rezolutë që e lexoi deputeti Zemaj, te pika 3 thotë: "Po i rrezikojnë thellë marrëdhëniet e Kosovës- Serbi dhe dialogu mes dy vendeve duke na detyruar në reciprocitet". Pra, për propozuesit e rezolutës reciprociteti i marrëdhënieve qenka detyrim, qenka diçka që ne obligohemi në fund ta bëjmë, e jo në parim udhërrëfyes që do të duhej të ishte. Reciprociteti është në parim udhërrëfyes i marrëdhënieve, asnjë vend në botë nuk ka marrëdhënie me një vend tjetër pa e bazuar atë në reciprocitet.

Ne këtu e kemi paraqitur si një lloj ndëshkimi për ne që s'po kemi qare pa ia bërë ashtu. Natyrisht, që duhet t'ia bëjmë reciprocitet, pra natyrisht që pa reciprocitet nuk mund të ketë marrëdhënie të mira, e reciprocitet me Serbinë është dëshmuar që nuk mund të ketë për sa kohë që ajo e mban këtë qëndrim armiqësor karshi Republikës së Kosovës.

Prandaj, propozoj që atë që e tha edhe deputeti Gëzim Kelmendi, si nismëtar i këtij debati parlamentar, që e kemi pasur dje dhe sot, i cili qe besa në propozimin e vet fillestar, siç e shpjegoi edhe vetë shumë mirë, nuk ka dashur që kërkesa për seancë të jashtëzakonshme parlamentare të mos jetë konsensuale e deputetëve, dhe rrjedhimisht propozimi i tij sot për ndërprerjen e dialogut deri në lirin e Nehat Thaçit ishte po ashtu propozim konsensual, duke u

bazuar në atë që e kanë thënë dhe deputetët nga të gjitha grupet parlamentare, deputetë të ndryshëm.

Pra, kjo është e vetmja pikë konsensuale nëse bazohemi në debatin e djeshëm. A nëse bazohemi në ëndrrat e mbrëmshme, atëherë po duket që nuk është konsensusi i deputetëve. Po sidoqoftë, mendoj që një rezolutë e Kuvendit sot që do të duhej të votohej nga deputetët duhet të jetë e thjeshtë, edhe propozoj që t'i ketë këto dy pika: nën një, atë që e tha me plot të drejtë profesor Hamiti, së pari, sepse seanca është për lirin e Nehat Thaçit. Duhet të themi që Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon lirin e menjëhershëm të drejtorit rajonal të Policisë, Nehat Thaçit.

Nën dy, të ndërpritet dialogu me Serbinë deri në lirin e Nehat Thaçit dhe deri në zhvlerësimin e të gjitha aktakuzave ndaj ushtarëve të UÇK-së në Prokuroritë e Serbisë. Dhe, me kaq duhet të përfundojë kjo rezolutë. Ne mund të shtojmë edhe pika të tjera që ta bëjmë atë pak më voluminoze, po këto dy pika janë thelbësore, pa këto dy pika nuk ka rezolutë në Kuvend. Me këto dy pika, edhe ndonjë pikë eventuale tjetër, bëhet një rezolutë domethënëse e Kuvendit bazuar në debatin që e kemi pasur mbrëmë. Përndryshe, paskemi folur mbrëmë kot, edhe do të votojmë sot kot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në një situatë kur janë bërë tri propozime për rezoluta, të shkojmë me grupet parlamentare, deklarohuni për arsye se po më vjen keq edhe për opinion publik që po na ndjek jashtë, më tepër është luftë politike brenda se sa qëllim për të kryer punë.

Janë pothuajse tri projektrezoluta, ka përfunduar konsumi për hir të publikut dhe ta maltretojmë publikun për të treguar sa patriotë jemi e qysh po i futim e qysh s'po i futim në burg.

PDK-ja, jepen qendrimit, LDK-ja, të gjitha partitë, të futemi në votim.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Po mendoj se debati është bërë dhe për këtë temë, i falënderoj të gjithë deputetët e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe deputetët e tjerë që kanë pasur një frymë konstruktive gjatë gjithë këtij debati. Mendoj që sot nuk është e arsyeshme të dalim me diçka që më shumë se sa debat konstruktiv për lirin e zotit Thaçi, është shpalosja e koncepteve politike për sa i përket dialogut dhe çështjeve të tjera.

Mendoj që nuk është aspak korrekte ta bëjmë këtë. Kemi provuar, ne kemi porositur zonjën Halimi që sa të jetë e mundur të bëjë gjithçka që të ketë një tekst të unifikuar dhe mendoj që ajo ka dhënë kontributin që ky tekst të bëhet. Nuk është arrit ashtu siç u tha, unë si përfaqësues i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike mendoj që propozimi i profesor Hamitit duhet të përfshihet automatikisht në pikën e parë dhe teksti i rezolutës që është dakorduar me Lidhjen

Demokratike të jetë një prej propozimeve dhe të dilet edhe me propozime të tjera që ka dhe sot ta votojmë një rezolutë.

Mendoj që ky tekst ndoshta nuk është më i miri, por ne duhet të jemi racionalë. Kemi përfshirë të gjitha çështjet në frymën e debatit që nga deputetët tanë që është bërë dje, dhe mendoj që kjo rezolutë do të jetë një version i mirë për ta dhënë qëndrimin tonë për çështjen e zotit Thaçi, me kërkesën për lirim të zotit Thaçi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ashtu siç u tha në marrëveshje dhe me vendim të Kuvendit realisht ne i dërguam ose i kishim përfaqësuesit tonë në grup punues për të harmonizuar për atë që është e mundur, sepse është shumë e qartë që e kemi ditur që mund të ketë vështirësi në harmonizim të tërësishëm të tekstit dhe zoti Zemaj e paraqet qëndrimin e plotë të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe për këtë ne e mbështesim tekstin e harmonizuar, me përfshirjen e pikës që u tha të profesor Hamitit, në thënien tekstuale që Kuvendi kërkon ashtu siç e tha, nuk po e vazhdoj tekstin, lirim të menjëhershëm të zotit Thaçi.

Ndërkaq të gjitha pikat e tjera janë ato që janë të harmonizuara me Grupin Parlamentar të PDK-së dhe të përfaqësuesve të “6+”. Dhe, ne kërkojmë që kjo rezolutë e propozuar me këtë plotësim, kështu siç u tha edhe nga parafolësi, nga PDK-ja dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së kërkoj që kjo pastaj të hedhet në votim dhe ta votojmë pikërisht për të treguar se megjithatë është shumë më serioze edhe më me rëndësi ta votojmë jo siç po thuhet do si ndonjë rezolutë, por në fund të prodhohet një rezolutë për atë që ka qenë e mundur të harmonizohet dhe të mos dalim pa një votim të një rezolute të tillë.

Prandaj, rezolutën që është propozuar dhe lexuar nga zoti Zemaj, me plotësimin që e thashë, ne do ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Driton Çausi nga Lëvizja “Vetëvendosje”.

DRITON ÇAUSHI: Atëherë, besoj që deputeti Ymeri e sqaroi mjaftueshëm qëndrimin jo vetëm të Lëvizjes “Vetëvendosje”, por të opozitës në përgjithësi, të deputetit Kelmendi, por edhe të deputetit Hamiti.

Nuk ka kuptim që kjo rezolutë të zgjatet më tutje përveç atyre dy pikave të propozuara. Pra, mbështesim kërkesën për një rezolutë që përfshin kërkimin e lirit të menjëhershëm të Nehat

Thaçit dhe ndalimin e dialogut në Bruksel deri në lirimin e tij dhe deri në zhvlerësimin e të gjitha listave dhe aktakuzave për ish- luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Është për keqardhje, por po e them edhe njëherë për të gjithë ata qytetarë që kanë dëgjuar dhe kanë përcjellë seancën e mbrëmshme të Kuvendit dhe i kanë dëgjuar edhe qëndrimet e koalicionit se si ata kërkonin reciprocitet ndërprerje të dialogut, kurse sot po shpërfaqin një hipokrizi të vërtetë, duke mbajtur një qëndrim pa kurrfarë kushtëzimi dhe në tërësi, në kundërshtim me atë që kanë deklaruar mbrëmë për të gjithë ata që i kanë dëgjuar.

Vetëm kjo rezolutë që ne e propozuam ka një kosto për shtetin serb, përndryshe ajo që është sjellë nga koalicioni PDK-LDK nuk ka kurrfarë kosto dhe është praktikisht dorëzim dhe është një shpërfaqje e plotë e organit më të rëndësishëm legjislativ në raport me ngjarjet e fundit dhe në raport në tërësi me shtetin serb. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Por, për një sqarim, edhe për hir të opinionit publik edhe juve. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka dorëzuar një projektrezolutë me shkrim, gjersa ju po flisni në emër të opozitës. Tash edhe Daut Haradinaj do të flasë, në bazë të Rregullores, në qoftë se Lëvizja “Vetëvendosje” ka një projektrezolutë, do të ishte mirë me shkrim ta sjellë ose del njëri nga ju e lexon, pastaj unë do ta lexoj çdo projektrezolutë e cila propozohet.

Ok, ta pyesim, ju e dini Rregulloren se kur nganjëherë po e thyej Rregulloren, ju menjëherë po reagoni, e dini mirë. Ja ku e keni Albinin, e di më së miri prej juve qysh i di të gjitha.

Kështu Daut Haradinaj, pastaj përgatituni që ta pyesim Dautin a keni folur në emër të tyre. E kam një projektrezolutë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, këtë desha. Urdhëro, zoti Haradinaj, fol për vete!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Të mos i përsëritim të njëjtat fjalë, prapë domethënë ne nuk është vetëm që qëndrojnë, por kërkesa eksplicite, edhe pse nuk isha pajtuar me profesorin Hamitin se më replikonte pa mikrofon fare.

Është shumë e thjeshtë, krejt diskutimi i djeshëm dhe i ky sotmi dhe vazhdojmë, unë besoj që të gjithë këtu bashkë jemi dakord të kërkojmë sa më shpejt lirimin e zotit Nehat Thaçi dhe kurrë një dilemë kurrkush asnjë deputetë nuk e ka. Duhet futur këtë pikë të veçantë: “Kërkesë ndërprerja e dialogut me Serbinë deri në lirimin e zoti Nehat Thaçi”.

Pika 2, kërkesa duhet të jetë shumë e saktë, meqë jemi dakord të gjithë bashkë, prapë po pajtohem edhe me opozitën, edhe me pushtetin që të pastrohen listat me aktakuza të Milosheviqit, se boll më. Dhe, s’kemi çka të dialogojmë me një shtet i cili vazhdon akoma me të

njëjtat agenda të vjetra. Domethënë, këtu nuk kemi asnjë shpërputhje dhe jemi dakord. Ndërsa, Aleanca e ka propozuar një rezolutë në kuptimin e mirë që të mos biem ndesh as me pushtetin, as me opozitën, në këtë rast, domethënë ne kërkojmë edhe njëherë të futet edhe një rresht shtesë: “Kërkesë ndërprerja e dialogut me Serbinë deri në lirimin e zotit Nehat Thaçi”.

Pika 2, “Pastrimi i listave” edhe vazhdojmë me lutje për Interpolin, pse jo. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani Çerim Bajrami nga “6+” e ka kërkuar fjalën.

ÇERIM BAJRAMI: Zahvaljujem, predsedavajući!

S obzirom da sam uzeo dakle udjela radu ove grupe koja spremala ga rezoluciju, možda će biti subjektivno, ali moramo odmah na početku da kažem i podsećam sve članove radne grupe da samupravo predložio da prvo tačka bude nešto slično što je predložio profesor Hamiti.

Dakle da Skupština Kosova oštro osuđuje hapšenja gospodina Taçi, direktora regionalna Policije u Mitrovici, i traži njegovo momentalno oslobođenje, i onda da se ide sa ovim drugim tačkama. Što se tiče ovaj razlika između predstavnika opozicije i pozicije u ovaj radne grupe, jeste samo kod jedne te reči, koja bila rečeno na albanskom “pezullim”, suspenzija, dakle razgovora odnosno dijaloga do daljnjeg, oko ova nema slaganje očigledno, i ostaje verovatno da ova Skupština glasa između jedne i druge verzije. Hvala!

KRYETARI: Zafir Berisha nga “Nisma për Kosovën” apo Haxhi Shala, cili doni? Haxhi Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetar!

Në qoftë se dikush është duke bërë politikë dhe patriotizëm, këtë e kemi parë dje me veprimet ose me bisedimin e deputetëve të dy grupeve më të mëdha parlamentare.

Procesverbalet janë, incizimet janë. Mirë është t'i lëshojmë dhe t'i dëgjojmë disa fjalime të deputetëve të pozitës. Duke dëgjuar fjalimet e deputetëve të pozitës ne kemi ardhur në përfundim se Parlamenti i Kosovës ka kërkuar dje që të ndërpritet ose të pezullohet, pak po e zbusim, bisedimet me Serbinë. Në qoftë se kjo pikë nuk hynë në rezolutë, nuk e di çfarë kuptimi ka rezoluta tjetër. Edhe ajo çka propozoi profesori Sabri Hamiti jam dakord plotësisht, por pika e dytë duhet të jetë pezullimi ose ndërprerja e bisedimeve deri në lirimin e zotit Nehat Thaçi.

Në qoftë se për bashkësinë ndërkombëtare më e rëndësishme është të mbahet Nehat Thaçi në burg se sa bisedimet, atëherë le të jetë ai në burg, edhe bisedimet ne po i ndërpresim. Kështu që as nuk jemi duke bërë politikë këtu, zoti kryetar, siç na the ti, as duke shitur patriotizëm. Patriotizëm dhe politikë paskan bërë dy grupet më të mëdha politike dje në Parlamentin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në fazën e fundit, kështu do të shkojmë, nuk kemi qëndrime të përbashkëta. Do të shkojmë pothuajse tri projektrezoluta do të votohen një pas një.

A ka mundësi të futemi në votim, apo dëshironi ende të flisni? Doktorëshë, më vjen shumë keq, unë ta jap fjalën, por pastaj duhet edhe 5 a 6, edhe në qoftë se dëshironi, lajmërohuni sa më shumë flisni dhe e ftoj opinionin publik sa më shumë të na dëgjojë sa jemi të shkathtë dhe patriotë.

Urdhëro, zonja Flora Brovina, përgatitet Ilir Deda, e ka fjalën Shaip Muja dhe kush do tjetër.

FLORA BROVINA: Realisht, ne po pajtohemi që ta kemi një rezolutë. Nuk është e vërtetë që s'po pajtohemi, është rezoluta, të cilës duhet t'ia shtojmë vetëm disa fjali dhe ajo është unanime për të gjithë, po besoj unë.

Për shembull, rezoluta që e dorëzoi Zemaj vetëm ia shtojmë: "Kuvendi kërkon lirimin e menjëhershëm të zotit Nehat Thaçi" dhe pastaj kërkojmë që BE-ja, domethënë "Kuvendi i Kosovës kërkon që BE-ja..." dhe vazhdon fjalia. Ndërsa, sa i përket pezullimit, pikërisht këtu në pikën dy i shtojmë "pezullohen bisedimet deri te lirimi i Thaçi", kurrëgjë tjetër, unë po kujtoj që të gjithë po pajtohemi.

KRYETARI: I kisha ftuar edhe të vijnë ata që s'janë këtu, secili për vete ta thotë mendimin, dhe në fund votojmë. Shaip Muja, Ilir Deda, s'keni grupe parlamentare, s'keni mundur të merreni vesh, flisni.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar, faleminderit!

Zoti kryetar, unë s'kam nevojë të paraqes as nivelin patriotik timin, por jam munduar mendimin racional edhe të adaptueshëm, edhe të nevojshëm për identitetin e Republikës së Kosovës dhe për t'u ndihmuar institucioneve të Kosovës në paraqitjet e bisedimeve në Bruksel.

Çka kam thënë unë, zoti kryetar?

KRYETARI: Mirë është t'i tregosh opinionit, se s'të ka dëgjuar.

SHAIP MUJA: Edhe dje kam thënë që ne Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të shkruajë një notë diplomatike në Zyrën e BE-së, konkretisht zonjës Mogerini.

Dhe nga shtatë pikat, të cilat unë i kam paraqitur, pothuajse të shtatë pikat janë të përmbledhura në këtë rezolutë, përveç dy pikave, të cilat quhen në pikën tre. Çka kam thënë në pikën 3: Thuhet "deri në zbardhjen e fatit të arrestimit të Nehat Thaçit, Republika e Kosovës pezullon bisedimet me Serbinë", pezullimi nënkupton njëfarë "time out" edhe në futboll po ndalen...

KRYETARI: A ka mundësi në gjuhën shqipe çka i bie “time out” se kemi nënkryetarin e Kuvendit gjuhëtar e s’po e marrim vesh.

SHAIPI MUJA: Një suspendim të përkohshëm të bisedimeve ose pezullim dhe nëse nuk paraqiten, them faktet e bazuara dhe reale dhe këto fakte do të jenë valide kur kanë qasje institucionet e Republikës së Kosovës përmes Bashkimit Evropian.

Sepse, ne nuk po dimë lëndën për çka është ndaluar, ne po dëgjojmë nga mediat. Bashkimi Evropian është garantues i bisedimeve dhe unë në vitin 2013 kam qenë përkrahës dhe vazhdoj të jem përkrahës i bisedimeve me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, por nuk jam përkrahës i asaj që të lëshojmë pe vazhdimisht në çdo kërkesë e cila paraqitet para nesh.

Tjetër, në notën diplomatike ne i ndihmojmë Qeverisë së Republikës së Kosovës me këtë rezolutë, disa po mundohen ta interpretojnë rezolutën si të pavlerë, ashtu e dëgjova nga disa. Mirëpo, nëse thuhet në Rregulloren e Kuvendit se rezoluta shpreh vullnetin e vet, Kuvendi shpreh vullnetin për një çështje, atëherë ajo çështje po formohet edhe në obligim. Prandaj, ne po i ndihmojmë Qeverisë që të jetë e thirrur në vullnetin e deputetëve të Republikës së Kosovës, për një çështje e cila mund të ketë zgjidhje.

Problemi është që a do ta lirojmë menjëherë apo jo, neve nuk do të na pyesë askush nëse Bashkimi Evropian dhe zonja Mogerini nuk kërkojnë fakte shtesë pse bëjnë lojëra të tilla. Ndërsa, çështja e anëtarësimit në Interpol, të cilin e kam kërkuar, thuhet: “Të bëhet selektimi me premisa politike”, nuk po them vetëm për ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka edhe të tjerë me premisa politike aty. Prandaj, Interpoli në mënyrë të njëanshme po e vlerëson edhe Europol po e vlerëson Kosovën, prandaj nuk ka kuptim, edhe pse po këmbëjmë informacione për çështjen e sigurisë. Kjo është çështje të cilën unë nuk e kuptoj ose ndoshta unë nuk kam informacione.

Prandaj, pezullimi nuk i dhemb askujt, sepse derisa ne kërcënohemi për çdo vlerë dhe të integritetit brenda territorit të Kosovës, ne s’po pretendojmë në territorin e Serbisë, sepse kemi interesa të përbashkëta të integrohemi edhe si Kosovë, edhe si Serbi në Bashkimin Evropian. Prandaj, Bashkimi Evropian duhet të jetë tolerues, por jo edhe të jetë vazhdimisht në drejtim të Kosovës kërkuar i pafund i standardeve deri t’i rregullojnë krejt shtetet e tjera përreth dhe ne në fund. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ilir Deda e ka fjalën, bëhet gati Zafir Berisha. Kush ka për të diskutuar, ju lutem lajmërohuni, pastaj të mos na futni edhe një herë në diskutime.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Në frymë të përkrahjes të asaj çka tha zoti Hamiti, mendoj që propozim-rezoluta e koalicionit qeverisës ka mangësi. Ne si Kuvend a merremi me një qytetar privat të Kosovës, apo si një zyrtar

shtetëror. Nëse është zyrtar shtetëror, duhet ta cekim “ne duam që komandanti i Rajonit të Policisë së Mitrovicës të lirohet” si Kuvend, jo një qytetar, e para.

E dyta, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk mund të obligojë BE-në për asnjë gjë. Ne mund ta obligojmë vetëm Qeverinë e Kosovës që të kërkojë nga BE-ja si ndërmjetësuese që të bëjë presion. BE-ja nuk ka mekanizma detyrues, Armend, më fal!

E treta, si shtetet e tjera në rajon, ne duhet ta kontestojmë si Kuvend i Kosovës juridiksionin universal të Serbisë, ajo pretendon që mund ta arrestojë këdo në territorin e ish-Jugosllavisë dhe ta gjykojë. Këtë e bën Kroacia, këtë e bëjnë të tjerët, duhet ta bëjmë edhe ne. E tash, nëse merremi me 15 rezoluta, a mund të jepet një pauzë që të bëjmë tamam si duhet një rezolutë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zafir Berisha, Vjosa Osmani, Albin Kurti, Fatmir Xhelili. Në qoftë se ka edhe dikush, pas kësaj here kur të thërras, më nuk kemi diskutues.

Zafir Berisha, fjala është për ju.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Thënë të drejtën, tash debati që po zhvillohet për një çështje që mendojmë se është diskutuar dje, po bëhet qesharak.

Faktikisht ky parlament ka nxjerrë rezoluta për çështje për të cilën po diskutojmë, por unë mendoj se edhe kjo rezolutë, cilado që nxirret, për Qeverinë e papërgjegjshme që aktualisht ka vendi nuk do të thotë asgjë. Unë dje në fjalimin tim kam cituar një rezolutë të vitit të kaluar, ku në pikën 2 të asaj rezolute, domethënë është përafërsisht kërkesa e sotme që po bëhet nga shumë kolegë deputetë lidhur me arrestimet që ndodhin ndaj qytetarëve dhe zyrtarëve të shtetit mbi bazat e aktakuzave të fabrikuara nga Serbia.

Ajo që më shtyri të marr fjalën për të potencuar joseriozitetin e partive në pushtet, në këtë rast zotit Pajaziti thotë krejt diçka tjetër në emër të grupit më të madh. Ndërsa, doktoresha krejt diçka tjetër. Domethënë, kjo neve na bën të dyshojmë në cilindo rezolutë që mund ta nxjerrim dhe cilindo tekst që e futim, se kjo nuk do të ketë efekt.

Sido që të jetë, unë mendoj se ky Kuvend duhet të nxjerrë edhe një rezolutë vetëm me një kërkesë, me një pikë, dhe pika e vetme duhet të ishte: “Kuvendi kërkon nga Qeveria që të pezullojë bisedimet me Serbinë derisa të lirohet zoti Nehat Thaçi, zyrtar i lartë i shtetit”.

Çdo gjë tjetër që e shtojmë, domethënë është për të mos bërë asgjë. Thashë rezolutë për tema të përafërta kemi pasur vitin e kaluar, ajo rezolutë është injoruar. Unë dje kur e kam përmendur në

Kuvend këtë rezolutë kryeministri aktual ka qeshur në formë të injorimit dhe thjesht, unë mendoj se jemi duke humbur kohë dhe ky Kuvend përpos që duhet t'ia kthejë seriozitetin vetveten, duhet t'ia kthejë seriozitetin edhe Qeverisë.

KRYETARI: Faleminderit! Kjo është lista përfundimtare e diskutuesve: Vjosa Osmani, Albin Kurti, Fatmir Xhelili, Shukri Buja, Time Kadrijaj, Nuredin Ibishi, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi. Besa Gaxherri. Atëherë, urdhëro zonja Osmani!

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Mendoj që si Kuvend i Kosovës, pra si institucion, por edhe si deputetë individualë duhet të tregojmë pak më shumë seriozitet, se sa të përqeshim propozimin e secilit për çështje të tilla serioze.

Arsyeja pse sot e morra fjalën, është se për shkaqe objektive dje nuk kam pasur mundësi të flas për këtë çështje, por në mënyrë specifike dua t'i komentoj propozimet.

E para, akoma e kemi një rezolutë në fuqi, e cila është miratuar para disa vitesh dhe e cila kërkon pezullim të dialogut me Serbinë, derisa të zgjidhet çështja e të zhdukurve. Pra, nuk është që ky Kuvend nuk ka vendosur të pezullohet dialogu derisa të zgjidhet një çështje e tillë, por Qeveria nuk e ka implementuar. Kjo si çështje e parë, që po e shtroj është për arsye se unë nuk mendoj që edhe një kërkesë tjetër nga ky Kuvend për tu pezulluar dialogu derisa të zgjidhet edhe një çështje ndihmon dhe, në veçanti nuk ndihmon në këtë rast. Pse? Për shkak se këtu nuk kemi të bëjmë me një shtet si Sllovenia, rastin që e kishim me zotin Haradinaj, që na ka njohur, por kemi të bëjmë me një shtet që nuk e ka njohur Kosovën, kundërshtuesin më të madh të Republikës së Kosovës, të cilit nuk mund t'i dërgojmë notë proteste, sepse u dërgohet zakonisht shteteve që na kanë njohur dhe me të cilin nuk kemi raporte bilaterale, nuk mund të ulemi e të diskutojmë me ta për lirin e Nehat Thaçit pa ndihmën dhe pa intervenimin dhe involvimin e Bashkimit Evropian.

Pra, në qoftë se ne sot e pezullojmë dialogun me Serbinë nuk ka më mënyrë që të lirohet zoti Thaçi vetëm nëpërmjet diskutimeve bilaterale Kosovë - Serbi, vetëm që mund ta zgjasë arrestin e tij. E vetmja mënyrë që kjo çështje të zgjidhet është nëpërmjet Bashkimit Evropian.

Pezullimi i dialogut, në njëfarë mënyre, e pezullon edhe raportin tonë me Bashkimin Evropian. Kjo është dëshmuar më herët, sa herë që është kërkuar diçka e tillë. Po flas për çështje të tilla politike, unë nuk po flas për procesin e integritetit në përgjithësi, kjo është dëshmuar.

E dyta, ky Kuvend duhet të ketë kërkesa konkrete, jo vetëm mesazhe politike në raport me Qeverinë e Kosovës, për shkak se në vitin 2013 Kuvendi ka ratifikuar marrëveshjen Kosovë - Serbi me planin e zbatimit dhe pika 2 e planit të zbatimit thotë: "Të dyja palët", jo vetëm Kosova pra, "Të dyja palët duhet ta miratojnë Ligjin për amnisti". Kosova e ka miratuar atë ligj në vitin

2013, Serbia nuk e ka miratuar kurrë dhe kjo kryesisht është bërë me qëllim, që aktakuza të tilla të cilat janë akoma aktive në Serbi të shuhen dhe që qytetarët e Kosovës e në veçanti ata që edhe sot janë të involvuar në jetën publike të mos kenë probleme, qoftë ta vizitojnë Serbinë, qoftë që nëpërmjet shteteve të tjera të marrin pjesë në iniciativa rajonale.

Çështja që e përmendi zoti Dedaj, rreth juridiksionit universal, është jashtëzakonisht e rëndësishme, sepse jemi shteti i vetëm në rajon, që s’kemi marrë vendim se a ja njohim juridiksionin universal Serbisë apo jo. Serbia sot mendon që pavarësisht a është kryer gjoja një krim në Kroaci apo në Kosovë, apo diku tjetër, ata kanë të drejtë t’i arrestojnë njerëzit. Ata madje, as nga Kombet e Bashkuara nuk janë konsideruar dhe nuk janë njohur si shtet vazhdues i ish-Jugosllavisë, që do të mund të kërkonin një të drejtë të tillë. Pra, nuk e kanë dhe kjo patjetër duhet të përmendet. Në qoftë se, s’e bëjmë sot në këtë rezolutë, ne duhet të diskutojmë për këtë çështje së bashku me pikën 2 të planit të zbatimit të marrëveshjes së vitit 2013, i cili, siç e thash, kërkon që edhe Serbia të miratojë Ligjin për amnisti.

Pra, ne duhet t’i kërkojmë këto gjëra nga Qeveria e Kosovës, që janë tepër specifike dhe Qeveria bashkë me BE-në të punojnë në këtë drejtim. Po ashtu, në vazhden e njëjtë të argumentimit se nuk mund të bëhen kërkesa vetëm ndaj institucionit, është edhe kërkesa që i është bërë Interpolit. Unë mendoj që aty me një fjalë të vogël mund të rregullohet kjo punë, sepse para se të vendosë Interpoli për anëtarësimin tonë, ne duhet të kërkojmë nga Qeveria që të aplikojë.

Jo, Ministria e Brendshme thotë: “kemi aplikuar”, Ministria e Jashtme thotë: “akoma nuk është bërë aplikimi”, pra le të sqarohet përfundimisht. Le të sqarohet... nuk e di unë a flasin në mes vete a konsultohen, mirëpo në qoftë se ka shkuar aplikacioni deri më tash do ta dinim. Nuk është e qartë në qoftë se aplikacioni është dërguar apo jo, por pa aplikuar nuk mund të vendos Interpoli për këtë çështje.

Edhe një gjë, besoj se shumica e dini, mirëpo deri vonë shumë prej këtyre aktakuzave kanë qenë të pezulluara edhe në Serbi, tash janë riaktivizuar. Duhet me e ditë pse është bërë kjo çështje dhe absolutisht, duhet të diskutohet. Mirëpo, në qoftë se nuk e diskutojmë në Bruksel unë nuk e di ku tjetër mund ta bëjmë këtë punë. Nuk po flasin këtu për raporte, as me Slloveninë, as me Kroacinë, as me Malin e Zi e as me shtetet e tjera të rajonit, me të cilat kemi raporte të mira bilaterale dhe mund të ulemi në bisedime dhe të gjejmë zgjidhje për çështje si kjo. Po flasin për Serbinë, prandaj involvimi i BE-së është tepër i rëndësishëm dhe unë, për momentin, nuk shoh mënyrë tjetër që ata të jenë të involvuar, se sa nëpërmjet procesit që deri tani është konsideruar si dialog i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

KRYETARI: Ndërkohë, ka shumë kërkesa që të harmonizohet teksti, në qoftë se dëshironi edhe një herë. Diskutimet nuk do të ndalen, do të shkojnë të gjitha deri në fund. Albin Kurti e ka fjalën, të bëhet gati Fatmir Xhelili.

ALBIN KURTI: Qytetarë të Republikës e deputetë të Kuvendit,

Ne në masë të konsiderueshme jemi bashkë, sa i përket kësaj rezolute, e cila do të dilte në mënyrë të logjikshme nga diskutimet e mbrëmshme, prandaj në këtë aspekt ne pajtohemi me deputetin Daut Haradinaj, me deputetin Haxhi Shala, me deputeten Flora Brovina, po ashtu edhe deputeti Shaip Muja e pat kërkesë ndërprerjen e bisedimeve si një mekanizëm për rritjen e kostos Serbisë. Dallimi ishte sepse ai në mënyrë interesante preferonte që drejtorin e Policisë, Nehat Thaçin, ta konsiderojmë disi si të pagjetur, si të rrëmbyer e të pagjetur, me ç'rast duhet të zbardhet fati i tij, ndërkohë që ne më tepër e kemi konsideruar si peng apo rob lufte, që nuk është dallim substancial.

Pra, çështja është a duhet të ndërprerja e bisedimeve apo jo? Ne jemi të bindur që për të pasur kosto Serbia është e domosdoshme që të përfshihet kjo edhe si një rrjedhë logjike e diskutimeve të mbrëmshme. Le të mos harrojmë, që Bashkimi Evropian ndërhyr kur ne jemi serioz. Nëse ne i lutemi Bashkimit Evropian, Bashkimi Evropian neve na kategorizon në seriozitetin tonë, ata duhet të shohin që ne jemi sovranë e të pavarur, që ne jemi seriozë e të sigurtë, që ne jemi këmbëngulës, në mënyrë që të përfshihemi. Përdërisa, ne e lusim Brukselin dhe e kufizojmë angazhimin tonë në lutje tona, ata konstatojnë joseriozitetin tonë. Dhe, askush nuk po thotë që ta anashkalojmë Bashkimin Evropian, çështja është se si Bashkimi Evropian të mos na anashkalojë neve.

Nuk është duke e anashkaluar askush Bashkimin Evropian, Bashkimi Evropian është duke na anashkaluar ne. Dhe, që të mos na neglizhojë, që të mos na anashkalojë neve, ne duhet të tregohemi seriozë si Kuvend i Republikës së Kosovës, pra edhe Kuvend, edhe i Republikës, edhe i Kosovës. Reciprociteti, ndërprerja e bisedimeve, kushtëzimet ndaj Serbisë, rritja e kostos për Serbinë është seriozitet.

Më tutje, unë po ashtu pajtohem edhe me deputetin Dedaj, i cili tha që duhet ta ndjekim shembullin e Kroacisë. Pajtohem plotësisht. Kroacia po e kushtëzon Serbinë dhe duke e kushtëzuar Serbinë ajo ka arritur aty ku është, edhe anëtare në NATO, edhe anëtare në Bashkimin Evropian. Pra, kjo është rruga e duhur. Nuk kalon rruga për në Bruksel kah Beogradi. Ata që mendojnë, se rruga për në Bruksel kalon nëpër Beograd nuk po e kuptojnë që është rrugë qorre. Nuk na çon në Bruksel ajo rrugë. Të tillë e ka rrugën Sarajeva dhe, ju po e shini se në çfarë gjendje është Bosnja. Aty e kurthon për çdo gjë të rëndësishme Republika Serbe me të drejtën e vetos.

Le të mos e ndjekim atë rrugë! Le ta ndjekim rrugën e Kroacisë e jo rrugën e Bosnjës! Rrugën e kushtëzimit e jo rrugën e koncesioneve drejt të drejtës së vetos së entiteteve brenda nesh!

Pra, Serbia duhet të ketë kosto. Çfarë kosto ne mund t'i shkaktojmë Serbisë? Është tregu 400 milionë euro, që e ka në Kosovë zyrtarisht, jozyrtarisht është dyfishi i kësaj. Kjo është një kosto,

që e kemi në raport me Serbinë dhe kostoja tjetër është ndërprerja e bisedimeve. Ne leva të tjera s'kemi, në këtë aspekt po e përdorim këtë levë, ndërprerjen e bisedimeve. Është minimumi, që mund ta bëjmë, në mënyrë që ta dëshmojmë veten sadopak të dinjitetshëm, me integritet e seriozë.

Dhe krejt në fund, në Serbi kohëve të fundit ka ndodhur homogjenizimi i brendshëm, kjo është shumë e ngjashme si në vitet e '80-a. Homogjenizimi i brendshëm në Serbi historikisht ka prodhuar hegjemoni të jashtme. Këto janë të lidhura. Sa më shumë që homogjenizohet Serbia brenda aq më hegjemone bëhet jashtë. Kjo po shihet në Bosnje, në Mal të Zi, po shihet në Maqedoni e qe besa, po shihet edhe në Kosovë. Në vitet e '80-a ka pasur proces të homogjenizimit të brendshëm në Serbi dhe pasuan luftërat në Jugosllavi, se hegjemonia e jashtme. Në një aso faze jemi sërish, Serbia përbrenda po homogjenizohet. Para dhjetë vjetësh nuk ta kish arrestuar drejtorin e Policisë, sot ta arreston, sepse është rritur homogjenizimi i brendshëm.

Edhe mbrëmë e kam thënë, 85% të Parlamentit në Serbi, ose janë çetnikë, ose rrotull çetnikëve. Kështu nuk ka qenë as në kohë të Milosheviqit dhe është një frymë e këtillë në Serbi, ajo që ta bën të natyrshme, për Serbinë, arrestimin e zotit Thaçi. Prandaj, unë po e lexoj edhe një herë propozimin tonë për rezolutën e Kuvendit.

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon lirim të menjëhershëm të drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Kosovës në Mitrovicë, zotëri Nehat Thaçi.

2. Të ndërpritet dialogu me Serbinë deri në lirim të drejtorit Nehat Thaçi dhe deri në zhvlerësimin e të gjitha akuzave e aktakuzave ndaj ushtarëve të UÇK-së, në prokurorinë e Serbisë.

Dy pika këto, më se të mjaftueshme. Nëse, dëshironi të shtojmë, por nuk mund të mungojmë, sepse gjithçka më pak se kaq është aspak. Më shumë se kaq është e pranueshme, por më pak, është e papranueshme. Deputeti Zemaj mbrëmë e tha që rezolutat nuk janë të obligueshme. Pse kaq shumë ne po i frikësohemi fjalës “ndërprerje” ose “pezullim”? Ç’është kjo frikë në Parlamentin e Republikës? Pse? Kujt po përpiqemi t’i pëlqejmë ne kështu? Kujt po i frikësohemi? A dëshirojmë ta shpëtojmë zotin Nehat Thaçi apo duam të shpëtojmë diçka tjetër, veten tonë, ndonjë ministër, ndonjë kryeministër...?

A jemi mbledhur për zotin Nehat Thaçi apo jemi mbledhur për diçka tjetër? Nëse, jemi mbledhur për diçka tjetër, mbajmë seancë tjetër me pika të tjera të rendit të ditës, por këtu jemi mbledhur për zotin Nehat Thaçi. Shënjestra jonë, objektivi jonë prej natës së mbrëmshme prej natës së mbrëmshme deri më sot ka ndryshuar, tjetër objektivi kemi sot, tjetër objektivi kemi pasur

mbrëmë. Mbrëmë e kemi pasur në epiqendër zotin Nehat Thaçi, sot nuk po e kemi. Ky është problemi. Le ta kthejmë në epiqendër zotin Nehat Thaçi! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fatmir Xhelili e ka fjalën. Ndërkohë, ka kërkuar replikë Shaip Muja, replikë një minutë.

SHAIP MUJA: Unë desha, kur thash se as nuk kam bërë një propozim për ndonjë nivel për shfrytëzim politik. Mua më vjen mirë, që u konsolidua edhe “Vetëvendosja” me dy pikë, se në takim ishte pa pikë. Mirëpo, në preambulë ku unë shkruaj them kësisoj, se po dëgjoj edhe disa... “a po mbrohet institucioni apo individ”, unë po mbroj institucionin, në institucion ka qenë ai individ.

Thuhet: “Bazuar në rrethanat e krijuara pas arrestimit të eprorit të lartë të Policisë së Republikës së Kosovës, kolonel Nehat Thaçi, institucionet e Kosovës janë sfiduar seriozisht dhe, një situatë të tillë vështirë mund ta pranojmë dhe të jemi të qetë para një dileme - a të vazhdojmë tutje me klimën e bashkëpunimit dhe raportet e fqinjësisë me Republikën e Serbisë.

Bazuar në këtë situatë obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës me një notë diplomatike t’i drejtohet Bashkimit Evropian me përmbajtjet si vijon:...”

Ndërsa, çështja se a është detyruese, a mund ta detyrojë Bashkimi Evropian, po mund ta detyrojë Bashkimi Evropian Serbinë, sepse duke qenë Serbia duke qenë shteti më kriminel me statistika, i ka dhënë favore shumë më shumë për interesa që i dimë, që janë publike, edhe liberalizimin e vizave, edhe shumë lëshime të tjera, edhe afirmime të tjera. Prandaj, ne nuk jemi statistikisht të barazueshëm as kuantitativisht me krimet që bëhen në Serbi, ndërsa neve Bashkimi Evropian neve na kufizon. Unë po them, e përsëris edhe një herë, durimi mund tu humb njerëzve duke pritur pafundësisht, se ne nuk mund të shkojmë përjetësisht e të jemi shembull për krejt Botën.

Ne e kemi pasur, ne nuk e kemi humbur hapin vetë, gjithmonë na e kanë humbur të tjetër, por edhe diplomatikisht duhet të jemi pak më të aftë. Jo ndërprerjen e bisedimeve, po pezullimin. Pezullimi nuk nënkupton ndërprerjen. Thuhet: “po pres këto dy javë, kur t’i vërtetoj faktet unë nëpërmjet zyrës së Bashkimit Evropian”...

Institucioni i Republikës së Kosovës u burgos atje. Në fund të fundit ai është një oficer, që ndoshta ka bërë gabim që privatisht, por institucioni i Kosovës është arrestuar dhe në politikat tjera mund të interpretohet edhe ndryshe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Fatmir Xhelili e ka fjalën. Unë po shkoj në bazë të radhitjes, ndoshta edhe partitë s’ma shihni për të madhe, ndërkohë bëhet gati Shukri Buja. I kemi edhe katër të tjerë.

FATMIR XHELILI: Përshëndetje, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kuvendi i Kosovës ka ingerenca dhe mekanizëm të vetëm për të marrë veprime adekuate në drejtim të lirimit të zotit Thaçi, Qeverinë e Kosovës.

Të gjitha diskutimet që po dalin këtu po shkojnë në drejtime të tjera dhe po lehet një përshtypje, kinse Qeveria e Kosovës nuk është angazhuar për lirimin e zotit Thaçi. Dëshmitarë janë anëtarët e Komisionit për Integritet Evropian në Bruksel, ku në kuluare dhe në pjesë të bisedës zyrtare veç ata ishin të njoftuar me rastin dhe thanë se janë duke i marrë veprimet adekuate në këtë drejtim.

Çdoherë po e kemi gojën plotë drejtësi dhe mostentim të influencave politike, ndërkaq kjo çështje është pak më shumë se vetëm veprim politik, sepse ka konotacione politiko-juridike që është vështirë me i nda se në cilin drejtim ka vepruar Serbia. Ndoshta, angazhimi i Qeverisë në drejtim të mekanizmave të Bashkimit Evropian duhet të jetë i vetmi veprimi, që përmes Bashkimit Evropian të ndikohet te Serbia për tu marrë me këtë çështje.

Kemi pasur edhe raste tjera të mëhershme, kur janë arrestuar figura politike të rëndësishme të shtetit tonë nëpër shtete tjera dhe gjithherë janë marrë veprime përmes mekanizmave evropiane dhe mekanizmave ndërkombëtare dhe, Kuvendi ynë nuk është thirru për t'u trajtuar tema apo raste të tilla. Ndoshta, mund të keqkuptohem prej shumëkujt, por u lutem deputetëve që tjetër herë të jenë shumë të kujdesshëm kur të ngrenë probleme dhe tematika të tilla apo të ngjashme në Kuvendin e Kosovës, se me vetë këtë diskutim dhe në këtë mënyrë, disi po e ulim edhe nivelin e Kuvendit dhe po e detyrojmë shtetin tonë të dalë në pozita të palakmueshme, kur dihet se objektivi kryesor i shtetit tonë është drejtimi i integriteteve evropiane dhe janë në vazhdimësi bisedimet me Serbinë dhe me Bashkimin Evropian, të cilin e kemi partner në këto procese, që bashkërisht të mund të reflektojmë pozitivitetet dhe energji pozitive, sinjale për bashkëfqinjësi, për të mos qenë gjenerator i të këqijave na rajon e tjerë.

Pezullimi i bisedimeve me Serbinë nuk e di kujt i konvenon në këtë kohë, i konvenon Kosovës më shumë apo Serbisë. Të gjithë ata që po insistojnë për pezullimin e bisedimeve me Serbinë dhe ndërprerjen e bisedimeve me të, le të mendojnë mirë dhe le të analizojnë se kush përfiton prej ndërprerjes së këtyre bisedimeve.

Në qoftë se, ne politikat tona dhe të shtetit tonë i orientojmë në drejtim të asaj se sa po homogjenizohet Serbia apo cilat veprime po i merr Serbia në drejtim të homogjenizimit, unë besoj që kemi përcaktuese politikat tona dhe objektivat tona dhe drejtimet politike dhe zhvillimin e Kosovës në drejtim edhe në ekonomik, po edhe në drejtim të proceseve integruuese, nuk e bazojmë në politikat e Serbisë dhe në reflektimin e politikave të Serbisë në rajon, që kohëve të fundit ka tendencë për të qenë destabilizuese në rajon, qysh me veprimet, me përkrahjen e

Republikës Sërpska në Bosnjë, qysh me veprimet në drejtim të Kosovës, po edhe rasti Thaçi ndoshta është një prej atyre rasteve që ka tendencë një reagim të tillë apo të ngjashëm, çfarë po insistojnë disa deputetë për të marrë.

Unë propozoj, që me rekomandim apo rezolutë të autorizohet Qeveria jonë, që të ndërmarrë të gjithë ata hapa dhe veprime adekuate në drejtim të lirimit të zotit Thaçi dhe besoj se Qeveria jonë ka edhe mekanizëm, ka edhe mundësi që t'i sensibilizojë faktorët ndërkombëtarë relevantë, të cilët kanë mundësi të ushtrojnë ndikim te Serbia, për t'u liruar zoti Thaçi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shukri Buja, ndërkohë bëhet gati Time Kadrijaj.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kjo rezolutë u mendua nga dje se do të harmonizohet dhe do të dilte me konsensus të plotë, por ja që nuk na ndodhi, për shkak të dallimeve konceptuale që kemi.

Gjithsesi, pika e parë e rezolutës duhet të jetë propozim i zotit Hamiti, deputetit të Partisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndërsa duhet ta kuptojmë se rasti i Thaçit është rast politik, është akuzë politike, është arrestim politik dhe është arrestuar drejtori i Drejtorisë së Policisë së Kosovës. Kuvendi duhet ta dimë, se ne ky rast nuk është, as i pari, nuk është as i fundit, prandaj duhet me rezolutë t'i dalim zot ndërprerjes së këtyre akteve që po ndodhin ndaj qytetarëve të Kosovës dhe të merremi njëherë e mirë dhe ta shfrytëzojmë këtë rast për t'i ndërprerjen e të gjitha rasteve që mund të na ndodhin, sepse nuk mund të merremi veç e veç me secilin.

Prandaj, është më se e domosdoshme që ne të ndërmarrim një masë për të tërhequr vërejtjen.

Pra, pika që po propozohet për pezullimin e bisedimeve duhet të përfshihet. Pezullimi nuk është kiamet, pezullimi është për një periudhë të caktuar kohore, derisa të arrihet një qëllim dhe qëllimi këtu po propozohet shumë i qartë, që të lirohet zoti Thaçi, për çfarë edhe jemi tubuar këtu dhe pezullimi të ndodhë edhe për shkak të ndjekjeve dhe akuzave politike, që po ndodhin në vazhdimësi nga Serbia.

Ndërsa, pika e parë e propozuar në rezolutë është paksa e pakuptueshme, sepse i kërkohet Bashkimit Evropian që të përdorë mekanizma detyrues. Ne mund të kërkojmë nga Bashkimi Evropian, që të përdorë apo të kërkojë nga Qeveria e Serbisë që ta lirojë Thaçin, gjë që do të ishte e drejtë, por jo mekanizma detyrues, sepse ne s'mund ta detyrojmë Bashkimin Evropian.

Pra, duhet të ndryshohet dhe të jetë: “Bashkimi Evropian si ndërmjetës dhe garantues i dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë, përmes mekanizmave të saj, të kërkojë nga Qeveria e Serbisë lirin e drejtorit të Drejtorisë, zotit Nehat Thaçi”.

Pika dy, duhet të hiqet fare nga rezoluta, sepse është pikë vërtet e pakuptimtë t’i kufizojmë institucionet për tu angazhuar që të lirohet një qytetar i Kosovës dhe komunikimin ta bëjmë vetëm me një zyrë, kur ka mundësi si shtet të komunikojmë edhe përmes mekanizmave tjerë.

Te pika tre, siç është propozuar, po ashtu është e pakuptimtë kur flasim dhe arsyetohet ndërprerja e dialogut. Këtu duhet të përfshihet pezullimi i bisedimeve dhe të jetë e qartë: “Qeveria e Republikës t’ia bëjë me dije Bashkimit Evropian, se veprimet e tilla të Serbisë në raport me institucionet dhe qytetarët e Kosovës po i rrezikojnë thellë marrëdhëniet Kosovë - Serbi”. Të hiqet kjo pjesa e dialogut në mes dy vendeve, duke mbetur pjesa tjetër, duke na detyruar të hyjmë në reciprocitet.

Reciprociteti është krejt diçka tjetër nga ndërprerja e dialogut apo pezullimit. Institucionet tona të drejtësisë nuk kanë ndërmarrë asnjë hap në këtë drejtim, nuk kanë ngritur akuza, për ç’gjë kanë mjaft shumë fakte, për qytetarë të Kosovës të komunitetit serb, që jetojnë në Serbi dhe kanë bërë krime në Kosovë dhe do të mund të përfshihej si pjesë në politika të reciprocitetit dhe pjesa, pika 5 të hiqet fare, ndërsa 4-shi të ndryshojë.

4. Misioni i EULEX-të thuhet, “të deklarohet për rastin e zotit Thaçi, njëherësh kërkojmë angazhim të drejtpërdrejtë si mision me kompetenca të veçanta”.

Duhet të dimë se misioni i EULEX-it sigurisht është i angazhuar në rastin Thaçi, por për çka është i angazhuar?

Ne duhet ta qartësojmë si deputetë me rezolutë: “Të deklarohet për zotin Thaçi dhe të angazhohet për lirin e tij, sepse e ka një mision me kompetenca të veçanta”.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadrijaj e ka fjalën, ndërkohë të bëhet gati Nuredin Ibishi.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Po shohim se gati të gjithë janë për harmonizim të kësaj rezolute. Ndryshimi që po kërkojmë është përfshirja e pikës që e propozoi profesori Sabri Hamiti dhe një pikë tjetër që është pezullimi i bisedimeve deri në lirin e Nehat Thaçit. Unë kisha kërkuar që të bëhet një pauzë dhe të gjithë përfaqësuesit e partive politike të ulen për ta harmonizuar këtë rezolutë dhe të shkojmë në votim.

Për ndryshe, debati mund të zgjasë në pafundësi dhe pa rezultat!

KRYETARI: Nuredin Ibishi e ka fjalën. Dhe, diskutuesi i fundit është Ismajl Kurteshi. Nëse s'kemi qëndrime të tjera, shkojmë në votimin e rezolutave, por dilni dhe lexoni propozimet.

NUREDIN IBISHI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Unë së pari shpreh indinjatën për arrestimin e zotit Thaçi nga autoritetet serbe. Çështja tjetër është Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe FSK që menjëherë ka mbajtur mbledhje ka paraqitur disa konkluzione, me të cilat thirren autoritetet dhe resorët e ministrive të caktuara të Qeverisë së Kosovës të marrin masa për lirim të zotit Thaçi.

Gjithashtu, të them se edhe dje desha ta marr fjalën, por në bisedime e sipër u shterën ato çka desha të them dhe thashë të mos ju ngarkoj, u tërhoqa, por sido që të jetë, e përgëzoj edhe zotin Kelmendi dhe 45 deputetët e tjerë që nisën iniciativën, por edhe tjerët që kontribuan për arritjen përafërsisht të asaj çka sot edhe ky grup i punës artikuloi në këto 6 pika, por edhe grupi tjetër që doli me disa variante tash së fundi, zoti Kurti me 2 po dhe deputetët e tjerë të pavarur që kanë edhe qëndrime të tjera.

Por, sido që të jetë, mendoj se në pikën 4, kur flitet për reciprocitet nënkuptohet edhe aspekti që u përfol edhe nga zoti Deda dhe nga zonja Osmani, parimi i reciprocitetit në parimin e juridiksionit territorial. Ajo është esenciale në këtë çështje, sepse autoritetet serbe vijnë sikur në territorin e vet në Republikën e Kosovës, që i kanë në aktet më të larta, duke filluar prej Kushtetutës e ligjeve, por edhe në aspektin e organogramave të tjera, i kanë të gjitha organet kompetente në territorin e Kosovës dhe shumë pak është bërë në aspektin e përdorimit të reciprocitetit që nënkupton edhe zbatimin e masave në gjithë territorin e Kosovës ndaj autoriteteve serbe që shkelin juridiksionin territorial, po edhe në aspektin e kryerjes së veprave penale në vendin e caktuar ose konkretisht që ka të bëjë me zotin Thaçi.

Pra, Serbia i merr ingerencat e autoriteteve qoftë policore, gjyqësore dhe të tjera të Kosovës dhe mendoj që në këtë pikë ndoshta duhet të përfshihet edhe një shtesë, nëse është e mundur – parimi i juridiksionit territorial, që nënkupton se në të ardhmen në këto baza të përdoret reciprociteti. Pra, kisha dashur që sa më parë të bëhet leximi i tyre dhe me vota të deklarohemi se kush është për miratimin e caktuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në ndërkohë kisha lutur deputetët të kthehen në sallë, dhe tash është diskutuesi i fundit, Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Meqë sot jemi tubuar këtu ta nxjerrim një rezolutë, mendoj që kjo duhet të jetë rezolutë e Kuvendit, me të cilën pajtohen pozita dhe opozita, përndryshe vërtet nuk do të kishte kuptim.

Unë propozoj që, edhe pse po duket e pamundur, edhe një herë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, bashkë me iniciuesin, të takohen, t'u japim kohë të mjaftueshme që të konsultohen edhe me shefat e tyre, nëse ka nevojë, dhe të bëjmë përpjekjen e fundit që të dalim me një rezolutë dhe jo këtu të mbivotohemi e të votojmë për dy-tri rezoluta. Ky është propozimi im, që konsideroj se duhet ta keni parasysh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kurteshi! Fadil Demaku ndërkohë e ka kërkuar fjalën, le ta marrë. Unë do ta bëj propozimin tuaj, të deklarohen grupet parlamentare dhe në bazë të deklaramit të tyre, shkojmë në votim, nëse nuk ka në parim pajtueshmëri. Pra, do ta kemi edhe nga unë propozimin që e bëtë edhe ju, pastaj vendosni ju.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryetar,

Të nderuar deputetë,

Natyrisht se u diskutua shumë gjatë rreth kësaj çështje dhe unë nuk dua të komentoj diskutimet e kolegëve deputetë, por çështja kryesore ishte te bisedimet. Unë do të jap mendimin tim sa i përket çështjes së bisedimeve që po i diskutojmë.

Jam i bindur se pala serbe, me dëshirë nuk do të kishte filluar bisedime me përfaqësuesit e Republikës së Kosovës kurrë, e as nuk do t'i kishte vazhduar dhe as në njëqind vjetët e ardhshme s'do të kishin biseduar me ne, por çështja e bisedimeve është çështje që kalon dëshirat dhe vullnetin, me këtë rast edhe të palës serbe, ndërsa edhe ne duhet të jemi të kujdesshëm, sepse ndërmjetësues të këtyre bisedimeve është Bashkimi Evropian dhe ne po synojmë çdo ditë që rruga jonë të jetë për Bashkimin Evropian.

KRYETARI: Faleminderit për kontributin, ndoshta u zgjat, por s'kishte tjetër zgjidhje.

Deputeti Ismajl Kurteshi e pati një propozim dhe unë do ta vë në votim, për hir të korrektësisë. Pra, a doni të shkojmë në votim dhe të keni parasysh, i kemi tri projektrezoluta: Lëvizja "Vetëvendosje" e ka një; Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka një, të cilën e ka të nënshkruar, dhe gjendet te unë.

(Ndërrhyrje)

Ok! Do të deklaroheni dhe unë do t'ju pyes tash, veçanërisht përfaqësuesit e Aleancës. Ju lutem e keni sjellë me nënshkrim. A e doni këtë, apo jeni me atë të Lëvizjes "Vetëvendosje"?

Do ta lexojnë këtë dhe kush e do fjalën?

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, a jeni për propozimin e Ismajl Kurtshit, apo të futemi drejt në votim?

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Ne kemi pasur një takim dhe morëm qëndrim dhe për t'u takuar dhe bashkë ta harmonizojmë, dhe fatkeqësisht kjo nuk ndodhi. Të tri tekstet që janë tash, janë në frymën e kërkesës për lirin e zotit Thaçi. Ka dallime më shumë se sa për temën, ka çështje shumë konceptuale rreth dialogut ose kërkesa për ndërprerjen e dialogut.

Edhe një herë dua të përsëris, javën që kaloi i kemi pasur dy interpelanca, s'ka qenë asnjë kërkesë e "Vetëvendosjes" për t'i harmonizuar qëndrimet për të dalë me deklarata të përbashkëta rreth atyre interpelancave që kanë të bëjnë me kodin telefonik dhe me gjendjen në veri.

Pra, do të ishte mirë që sa herë kemi tema të tilla, të kërkohet që të jemi bashkë për t'i harmonizuar.

Fatkeqësisht sot nuk kemi arritur këtë dhe është mirë të qitet në votim dhe cila të marrë vota më shumë të miratohet. Që të tri kërkesat janë në frymën për lirin e zotit Thaçi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Qëndrimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Urdhëro, i nderuar kryetar!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk dëshiroj të zgjas, e thashë qëndrimin. Ne kërkojmë të shkohet në votim teksti i rezolutës, me ato shtesat që i bëri zoti Zemaj dhe të harmonizuar me dy grupet e tjera parlamentare – PDK-në dhe minoritetet. Faleminderit!

KRYETARI: Lëvizja "Vetëvendosje"! Kush e do fjalën? Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Propozimet tona si pika janë tash duke u koordinuar edhe me atë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe të Nismës për Kosovën dhe besoj se kjo do të prodhojë një rezolutë të përbashkët të së paku tri subjekteve opozitare, bashkë, me sa dëgjova, edhe me propozuesin, meqë janë pika të njëjta. Prandaj, mendoj se, nëse ka dakordancë, por po më duket që s'ka, ka rëndësi që t'i jepet edhe një shans që ta bëjmë një rezolutë të përbashkët të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e nëse jo, atëherë do t'i kemi dy rezoluta, të cilat do të votohen.

KRYETARI: Faleminderit! Para se t'ia jap fjalën Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, do të doja të di a është ky qëndrim tash, për të hequr dorë prej kësaj. Deklarohuni! Fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Do të thotë, jashtë e kemi përfaqësuesin, zotin Ali Berisha, që është duke e harmonizuar rezolutën.

KRYETARI: Faleminderit! Për “Nismën”, zonja Bytyqi, urdhëroni!

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Duke ditur se është një diskutim shumë i rëndësishëm dhe kemi kaluar bukur kohë të gjatë duke diskutuar, edhe ne e kemi përfaqësuesin që është duke punuar në harmonizimin e një rezolute, mendoj se është mirë të kemi një pauzë për t'i harmonizuar qëndrimet tona për këtë pikë kaq të rëndësishme.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Mufera Shinik-Serbica!

MÛFERA ŞINIK: Faleminderit, kryetar!

Grupi ynë, nuk është grup i minoriteteve, por e ka emrin Grupi “6+”. Shkojmë në votim! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Beqiri e do fjalën edhe një herë dhe jemi në përfundim.

ISMET BEQIRI: Zonja kolege, kërkoj ndjesë, nuk e kam bërë me qëllim, domethënë të harmonizuar me tri grupe parlamentare: LDK, PDK dhe “6+”.

KRYETARI: Atëherë, sipas të gjitha gjasave, për fat të keq, do të shkojmë me dy rezoluta. A është gati edhe Lëvizja “Vetëvendosje”, grupi i opozitës.

Unë do t'i paraqes dy propozime të rezolutave në votim. Do të thërras paraprakisht përfaqësuesit e pozitës dhe opozitës, në bazë të përpilimeve të projektrezolutave dhe t'i lexojnë ato dhe kisha kërkuar, të nderuar kolegë deputetë, po shihet se as deputetët nuk e kanë të njëjtin qëndrim.

Pra, të votojmë për dy projektrezolutat të gjithë. Për ndryshe, nëse nuk votohet, atëherë do të jetë vërtet e dëmshme. Nuk është korrekte.

Pra, të votojmë të gjithë. Për këtë edhe aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese na obligon dhe do të votojmë në mënyrë elektronike.

Zoti Armend Zemaj e lexon projektrezolutën e parë, të cilën e vë në votim menjëherë, e pastaj e vë në votim edhe projektrezolutën e dytë dhe cila të marrë më shumë vota, konsiderohet e aprovuar.

(Ndërhyrje)

Le të lexohen të dyja, por votimi duhet të jetë i ndryshëm, i ndarë. Pra, le të lexohen dy projektrezolutat. Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Tashmë i dëgjuam edhe diskutimet e deputetëve, pavarësisht përfundimit të djeshëm të debatit dhe besoj se kjo i ka kontribuar edhe përmirësimit të dukshëm, në disa pika, edhe me atë që u diskutua që Projektrezoluta e cila do të paraqitet të jetë më e kompletuar dhe më e pranueshme për shumicën parlamentare.

Edhe një herë po them, nuk insistojmë që të pajtohen të gjithë, por besoj se interesi i përgjithshëm dhe serioziteti ndaj çështjes në fjalë është i domosdoshëm ta kemi një koherencë të tillë.

Ne po ashtu pranuam si propozim pikën e parë nga deputeti Sabri Hamiti e zonja Brovina për çështje të Rregullores së punës dhe për çështjen e emërimit apo fuqisë që e ka rezoluta, ne mund t'i përvishemi punës dhe ta ndryshojmë Rregulloren e punës, e në të ardhmen mund të dakordohemi se çfarë definicioni mund t'i japim.

Unë po ashtu ia shpërndava edhe zotit Ali Berisha dhe zotit Shala një të tillë, nuk e takova Dritonin, si anëtar i Komisionit me të cilin kemi punuar paradite, por sido që të jetë, unë po e lexoj projektrezolutën, në emër të tri grupeve parlamentare.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 40 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më 11 dhe 12 tetor 2016, pas debatit parlamentar lidhur me arrestimin e zotit Nehat Thaçi, njëherësh epror i Policisë së Republikës së Kosovës, nga ana e autoriteteve të Serbisë, nxori këtë:

REZOLUTË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon lirimin e menjëhershëm të zotit Nehat Thaçi, epror i Policisë së Republikës së Kosovës.
2. BE, si ndërmjetësuese dhe garantuese e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, përmes mekanizmave të saj detyruet të ndërhyjë te Qeveria e Serbisë që të lirohet eprori, zoti Nehat Thaçi.
3. Çdo komunikim i Qeverisë së Republikës së Kosovës për rastin e arrestimit të zotit Nehat Thaçi, deri në lirimin e tij, të bëhet vetëm përmes zyrës së Mogerinit, si Përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Evropian.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës t'i bëjë me dije BE-së se veprimet e tilla të Serbisë në raport me institucionet dhe qytetarët e Kosovës po e rrezikojnë thellë përmirësimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe dialogun mes dy vendeve, duke na detyruar në reciprocitet.
5. Misioni i EULEX-it të deklarohet për rastin e zotit Thaçi dhe njëherësh kërkojmë angazhim të drejtpërdrejtë si mision me kompetenca të veçanta.
6. Kërkojmë nga Interpoli që Policia e Kosovës të bëhet pjesë e kësaj organizate, njëherësh insistojmë që fletë arrestet politike të shpallura nga Serbia të largohen nga sistemi i tyre ligjor.

Prishtinë, më 12. 10. 2016

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Zemaj! Kjo është një projektrezolutë, tani ndërkohë kemi edhe një projektrezolutë, e cila do të lexohet, e harmonizuar, për të cilën paraqitësi i projektrezolutës do të na tregojë. Kërkoj mirëkuptim, jemi në fazën e fundit të finalizimit të projektrezolutës. Urdhëroni!

Ndërkohë, propozuesi i seancës, deputeti Gëzim Kelmendi, do ta lexojë një projektrezolutë të re. Urdhëro, zoti Kelmendi!

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar! Njëherësh falënderoj të gjithë për bashkëpunimin.

Si propozues i seancës, duke e parë frymën se s'kaloi debati, do të thotë kemi dy rezoluta në këtë rast. Njëra rezolutë është nga ana ime dhe i grupeve parlamentare të Lëvizjes "Vetëvendosje", Aleanca e Nisma dhe tjetra është nga grupet parlamentare LDK, PDK dhe "6+".

Duke pasur parasysh faktin, i nderuar kryetar, që isha propozues i këtij debati parlamentar, kërkoj që e para rezolutë, pra jona, të hidhet në votim.

KRYETARI: Të lutem, e lexon të dytën. Donikë, na e shpjego Rregulloren si të përfundojë Gëzimi dhe unë do t'ju bind çfarë thotë Rregullorja. Sot e kemi lexuar të parën të Armend Zemajt.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

Pra, projektrezoluta jonë i përmban pesë rekomandime, si vijon:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon lirimin e menjëhershëm të zyrtarit të lartë të Policisë së Kosovës, drejtorit rajonal për rajonin e Mitrovicës, Nehat Thaçi.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës pezullimin e bisedimeve me Serbinë deri në lirimin e Thaçit dhe pezullimin e të gjitha fleta arresteve dhe aktakuzave të ngritura për ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
3. Bashkimi Evropian, si ndërmjetësues dhe garantues i dialogut të deritashëm në mes të Kosovës dhe Serbisë, përmes mekanizmave të saj, të ndërhyjë te Qeveria e Serbisë që të lirohet Thaçi.
4. EULEX-i të deklarohet për rastin Thaçi, njëherësh kërkojmë angazhim të drejtpërdrejtë si mision me kompetenca të veçanta, dhe
5. Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës të ndërmarrë të gjitha veprimet në raport me Bashkimin Evropian dhe Interpolin që Policia e Kosovës të bëhet pjesë e Interpolit, njëherësh kërkojmë që fletë arrestet politike nga gjykatat e Serbisë të largohen nga sistemi i tyre.

KRYETARI: Faleminderit! Në bazë të Rregullores së Kuvendit, propozuesi gjithmonë flet i fundit.

Tash do të shkojmë në votimin e dy projektrezolutave. Nëse ka mundësi, të kemi vëmendjen tuaj, a do të votoni për të dy projektrezolutat apo jo. Në rregull!

A keni disponim që mëditjet e sotme t'i dërgohen familjes së zotit Nehat Thaçi. Si të doni, ju mund të vendosni.

A jeni për këtë propozim? Shumica po thotë po.

A ka ndokush që s'është për këtë propozim? Jo!

Pra, të gjitha mëditjet prej 120 deputetëve, me vendimin e seancës i kalojnë...

Atëherë, po e vë edhe propozimin për ndarjen e mëditjeve të sotme dhe lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Faleminderit! Nuk kalon ky propozim.

(Ndërhyrje)

Më falni, propozimi për mëditje nuk kaloi. Ishin vetëm 38 deputetë dhe nuk kaloi.

Shkojmë në votimin tjetër. E para rezolutë votohet nga propozuesi.

Tash votohet projektrezoluta e lexuar nga propozuesi i seancës, të cilën e ka lexuar Gëzim Kelmendi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Pra, e votojmë Projektrezolutën e Gëzim Kelmendit, me 3 grupet parlamentare të opozitës, votojmë tash:

Kanë votuar 75 deputetë. Për janë 19, kundër 38 dhe 18 abstenime.
Lus regjinë, përkatësisht administratën, ta paraqesë këtë rezultat.

Tash do të votojmë Projektrezolutën e lexuar nga zotëri Armend Zemaj, e përkrahur nga 3 grupet parlamentare.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Kanë votuar 72 deputetë. 51 janë për, 13 kundër dhe 8 abstenime.

Atëherë konstatoj se kalon Rezoluta e deputetit Armend Zemaj, e votuar nga shumica e deputetëve nga Kuvendi i Republikës. Me këtë i mbyll punimet e seancës plenare. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*